

inTeGra

**UNË...
...DUATË
DËGJOHEM!**

Dhjetë rrëfime të dhembshme të luftës së vitit 1998 -1999 në Kosovë

Prishtinë, 2009

UNË DUA TË DËGJOHEM!

Botues:

INTEGRA

Adresa: Rruga Rrustem Statovci, Objekti 2,
Kati 3, Numër. 3, Prishtinë, Republika e Kosovës

T: +381 38 246 717

E: info@ngo-integra.org

W: www.ngo-integra.org

Për botuesin:

Kushtrim Koliqi – Drejtor Ekzekutiv

Kordinator:

Korab Krasniqi

Ekipi i Projektit:

Brikena Kasniqi

Arianot Gjonbalaj

Faik Kurtishi

Shkëlqim Krasniqi

Lektura:

Monika Jana – Duzhmani

Ballina dhe pregaditja e librit:

Ylli Zymberi

Përmbledhje

1	Agron Mehmeti	12
2	Rexhep Muhaxheri	22
3	Mimoza Halimi	30
4	Hazir Berisha	42
5	R. K.	58
6	Xh. V.	90
7	Adrian Mehmeti	108
8	Nexhipe Berisha	132
9	A. S.	154
10	Sadije Ramadani	174

Parathënie

Libri 'Unë dua të dëgjohem' është klithma e të mbijetuarve të luftës së fundit në Kosovë, e thirrjeve të viktimave të masakruar, të dhunuara, të përndjekur, të dëbuar me dhunë nga trojet e veta etnike, si dhe të atyre që janë ende të zhdukur, që s'u gjinden kund as eshtrat.

Libri 'Unë dua të dëgjohem' duhet të ushtojë si kambanë në veshët e politikëbërësve dhe përgjegjësve si të institucioneve ashtu edhe agjensioneve nëpër ministritë përkatëse të drejtësisë, të punëve të brendshme, të punës dhe mirëqenies sociale, të arsimit dhe shëndetësisë, duke mos anashkaluar as autoritetet vendore, për përmirësim të pozitës së të mbijetuarve dhe familjarëve të viktimave të luftës së Kosovës. Ky libër, kjo thirrje e tyre, kërkon që atyre t'u mundësohet një asistencë e nevojshme, kurse të rënëve për liri t'u rikthehet dinjiteti.

A.M tregon përvojën e hidhur që kombi shqiptar në përgjithësi dhe populli i Kosovës në veçanti ka kaluar me shekuj për të fituar lirinë e shumëpritur. 'Kombi ynë shqiptar gjithmonë ka qenë i shtypur nga regjime të ndryshme, së fundi shumë i shtypur nga Serbia. Më kujtohen vitet 1990 kur na përzunë me dhunë nga bankat shkollorë policia e Jugosllavisë, për të vazhduar me mësimë nëpër objekte, shtëpi private nga viti 1990 deri më 1997'. Ky libër përshkruan

dëshmitë tmerruese të të mbijetuarve nga lufta e fundit në Kosovë, dëshmi të cilat më vete përmbajnë, veç dhimbjes dhe tmerreve të cilat i përjetoj popullata e Kosovës, edhe mesazhin se shoqëria në ndërtim e Kosovës do duhej të respektojë viktimat e luftës, dhe tu mundësoje integrim të dinjitetshëm në shoqëri.

I mbijetuari nga Qyshku H.B konfirmon se edhe dhjetë vjet pas mbarimit të luftës, ai ende mundohet ta lë prapa vetës të kaluarën e hidhur, e të shikojë përpara. Megjithatë, ngarkesa e përditshme për të siguruar ekzistencën, si dhe vuajtjet të cilat i kanë lënë vragë në shpirt dhe në trup, nuk e lënë të qetë:

***“...Shpesh mundohem ta mbylli atë
kapitull të jetës sime dhe të mos i kujtoj më,
por ato janë ngjarje që nuk harrohen kurrë”.***

Asistenca sociale që i ka takuar si i mbijetuar i një masakre makabër, është jo vetëm e pamjaftueshme, por edhe e padenjë. Ajo është fyese për të, e për flijimin e tij.

I mbijetuari XH.V nga fshati Qirëz kujton me përpikërinë më të madhe ngjarjen kur i rrethuan fshatarët, i rrahën, e i vranë, duke ia vranë në fund edhe djalin 13 vjeç, eshtrat e të cilit u desh t'i kërkonte për gjashtë vjet rresht para se t'i gjente. Ai rikujton fjalët e ushtarëve serbë tek e kërcënonin:

“Juve shqiptarëve do t’ju vrasim prej 2 vjeç e përpjetë. Meshkujt do t’i vrasim, do t’i grijmë, kurse vajzat dhe nusët tuaja, do t’i martojmë me serbë, për të lindur serbë të rinj. Kam parë dukë i mbytur dhe dukë i rrahur me dru para meje. Kam parë duke prerë me thika dhe nuk kam dëgjuar as të bërtitura”

I hidhëruar, ai kujton se si i është dashur ta mbledhë vetën e të shfaqë vetëmohim të pashoq, për t'i kërkuar dhe gjetur, më në fund, eshtrat e djalit të vet.

Të mbijetuarit ndjejnë dhembje e vrer, por edhe shpresë për një kthim të nderit dhe të dinjitetit të viktimave. Ata përshkruajnë përvojat e veta dhe mbijetesën nëpër periudha të ndryshme të luftës në Kosovë. Ata përshkruajnë edhe se çfarë presin nga institucionet e Kosovës.

Mënyrat e persekutimit ishin të ndryshme në një periudhë gati dhjetë vjeçare. Ato ndryshonin formë konform situatave dhe vendit se ku gjendeshin civilët pa dallim moshe dhe gjinie.

Qëllimi, megjithatë ishte një, të traumatizohet psiqikisht popullata shumicë, të dërmohej fizikisht, e te shporrej me dhunë nga trojet e te parëve. Përndjekja e nxënësve nëpër shkolla të mesme dhe në universitet, helmimet masive, keqtrajtimi i fëmijëve me sfida psikofizike, i pleqve dhe i grave shtatzëna, terrori në popullatën civile, masakra e Reçakut, janë gjuha në të cilin folin të mbijetuarit.

Viktima pa sy, me kapakun e kokës të hequr, më zorë të hequra, me gjoks të çarë dhe sy të hequr, kufomave të djegura, madje edhe të plagosur ende të gjallë e të djegur si në masakrën e fshatit Qyshk, familjarë të kapitur gjatë dëbimit masiv për në Shqipëri e në Maqedoni, janë germat e kësaj gjuhe. Këto janë krime që i kanë përjetuar gjithë popullata e Kosovës, e që kërkojnë vëmendje më të madhe nga të gjithë, por në veçanti nga institucionet relevante.

Kjo edhe për faktin se Kosova dhe gjithë regjioni i dalë nga disa luftëra do të duhej që në mënyrë të mirëfilltë të përqafojë të drejtën tranzitore. E drejtë kjo e cila do ta reformonte sistemin gjyqësor dhe të sigurisë në Kosovë, do të kërkonte riparimet e dëmeve të luftës, por dhe kthimin e dinjitetit të viktimave, përmes asistencave sociale e ndërtimit të përkujtimeve kolektive për viktimat e rëna.

Përkundër diskursit zyrtar, që promovon pajtimin në kurriz të mbamendjes, lexuesi këtu do të vërejë që plagët kulluese të shoqërisë janë ende të pashëruara. Shumë të intervistuar jetojnë ende në një ambient socio-kulturor ku gjuha e urrejtjes por edhe frustrimet janë ende valide. Përvojat tmerruese nëpër të cilat kanë kaluar bashkëbiseduesit dhe të mbijetuarit e formojnë ambientin kontekstual të kësaj gjuhe.

Pas një gjykimi të gjatë dhe të thellë, ne kemi vendosur se nuk është e arsyeshme të censurohen përshkrimet dhe përjetimet e këtij frustracioni, ngase këto dëshmi ofrojnë një informacion real për të kaluarën. Këtë herë, fjalët e të mbijetuarve lë të kumbojnë pa ndërhyrje në veshët e kompetentëve, të cilët do duhej të ndihmonin në gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për një satisfacion financiar dhe moral të të gjithë të rënëve dhe të mbijetuarve. E mbijetuara S.R nga masakra e Reçakut na ka rrëfyer se si u zhduk bashkëvendësja Sahide, varri i së cilës është i çelur dhe pret eshtrat e saj të prehën. Ajo apelon që institucionet të bëjnë më shumë në këtë aspekt.

Rrëfimi i të mbijetuarve na përkujton jo vetëm se institucionet vendore janë zotuar se do t'u përgjigjen kërkesave të viktimave, por edhe kanë një sërë ligjesh përpara që t'i rishikojnë nëse duan vërtet ta përmirësojnë pozitën e viktimave dhe familjarëve të tyre. Edhe rezoluta 40/34 e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara mbi parimet bazë të drejtësisë për viktimat

e krimit dhe të keqpërdorimit të pozitës është bazuar në filozofinë që viktimat duhet të pranohen në mënyrë adekuate, e të trajtohen me respekt dhe dinjitet. Por këta qytetarë të Kosovës, që kanë humbur për të - për ne! - më të shtrenjtit e vet, ndjehen të stigmatizuar, nga skamja në të cilën jetojnë, e nga mungesa e drejtësisë dhe pranimi të vuajtjes së tyre.

Shteti duhet t'u mundësojë këtyre qytetarëve qasje më të lehtë në mekanizmat gjyqësorë, e ta shpejtojë adresimin e dhimbjeve dhe humbjeve që kanë pësuar ata gjatë luftës në Kosovë.

Institucionet e Kosovës dhe shoqëria civile në veçanti duhet të bëjnë shumë më tepër që shoqëria kosovare ta stopojë stigmatizimin e viktimave dhe të familjarëve të tyre, ose të mbajë përgjegjësi nëse nuk veprojnë.

Drugën drejt një të ardhme më të mirë nuk e gjejmë duke i mbyllur sytë para të vërtetave të pakëndshme, por duke i parë ato në sy, e duke i trajtuar drejt dhe me respekt.

Nora Ahmetaj

1

Bisedë me

Agron Mehmetin

Nga fshati Reçak

Kombi ynë shqiptar gjithmonë ka qenë i shtypur nga regjime të ndryshme, së fundi shumë i shtypur nga Serbia. Më kujtohen vitet 1990 kur na përzunë me dhunë nga bankat shkollore policia e Jugosllavisë, për të vazhduar me mësim nëpër objekte, shtëpi private nga viti 1990 deri më 1997. Gjithnjë po vinin kohra dhe situata ma të rënda për shqiptarët, më kujtohet 1 tetori i vitit 1997, demonstratat e Unionit Studentor në Prishtinë, aty u pa se çfarë force përdorën policia serbe ndaj demonstruesve.

Ngjarjet që na tronditën ndodhën më 28 shkurt 1998. Masakra e Likoshanit dhe e Çirezit, për të vazhduar me qëndresën e familjes së Shaban Jasharit, gjegjësisht të udhëhequra nga komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari nga fshati Prekaz i Skënderajt. Atëherë ne kuptuam që Serbia po mundohej të shfaroste kombin shqiptar pa i kursyer as gra, as pleq madje as fëmijë.

Në qytetin tonë, Shtime, ne mendonim se me protesta paqësore do t'i përkrahim qytetarët e Drenicës, kështu që vazhduam protesta paqësore plot 55 ditë duke filluar nga ora 12.00 për të vazhduar deri në orën 13.00. Shumë nga protestuesit u keqtrajtuam psiqikisht dhe u rrahën fizikisht nga policia e Serbisë.

Kur filloi të keqësohet situata në komunën tuaj?

Më 14 qershor 1998 në pisha të Shtimes u pozicionuan 55 automjete të makinerisë së rendë jugosllave dhe 2 postbloqe të policisë, kështu që katër herë bllokuan dhe sulmuan grykën e Carralevës. Shumë shtëpi të Carralevës dhe Belincit u granatuan. Të shtëna sporadike ka pasur nëpër shumicën e fshatrave të komunës së Shtimes, gati gjatë gjithë kohës.

Më 25 korrik herët në mëngjes diku kah ora 03.00 filloi të granatohet fshati Zborcë dhe fshatrat përreth, policia u vendos edhe në podin e gështejve në Shtime, dhe neve në Reçak na u rrezikua jeta shumë dhe shumë familje u zhvendosën nga fshati. Unë i mora anëtarët e familjes sime dhe të mixhës dhe morëm rrugën drejt fshatit Petrovë për të vazhduar sa më larg, për në fshatin Topillë. Më kujtohet shumë mirë kur duke ecur në fshatin Petrovë, policia ka shtëne pa rreshtur në traktorin tonë, por vetëm Zoti na ka shpëtuar.

I lashë familjen atje, ndërsa unë u ktheva në shtëpi për të qëndruar deri më 15 janar bashkë me axhën Bajram. Pas 2 javë qëndrimi në Topillë, familja pa u provuar me luftë më përpara, u kthyen në shtëpi. Të shtëna ka pasur gjithherë.

Më 23 gusht 1998 në orën 12.00 u rrethua i gjithë fshati Reçak, u pozicionuan shumë tanke dhe topa dhe filloi granatimi, shumë njerëz afërsisht 150-170 vetë u strehuan në bodrumin e shtëpisë së Shkuri Hajrizit. Kah ora 14.00-15.00 hynë në atë bodrum policia e Serbisë dhe pas dhunës psikike që na bënë, arrestuan Shukri dhe Bali Hajrizain. Pas bastisjes dhe plaçkitjes së shtëpive, shumë shtëpi u dogjën nga forcat serbe. I kemi emrat dhe fotot e atyre që ju dogjën shtëpitë.

Cdo gjë u shkatërrua në fshatin tonë, si dhe rryma elektrike. E pamë që Serbia po e ndjek politikën e tokës së djegur. Asnjë familje nuk mbeti në Reçak përveçse nga një ose dy anëtarë për t'u kujdesur për emrin e familjes së tyre.

Pas marrëveshjes së ambasadorit Richard Holbrooke me Millosheviçin u instalua misioni i OSCE-së.

Familjet e Reçakut u kthyen nëpër pronat e veta dhe mendonim se do të mbroheshim nga OSCE-ja.

Më kujtohet 9 janari i vitit 1999, ishte dimër dhe acar i madh, kur prapë shumë forca serbe u ripozicionuan tek pishat e Shtimes dhe e vërejtëm që situata nuk ishte e mirë.

Kur hynë forcat serbe në fshatin tuaj?

Më 15 janar 1999 nga shumë forca, mund të them 4000-5000 trupa, u rrethua i tërë fshati. Në orën 06.45 u dëgjua një krismë e llojit të mortajës, pastaj të shtëna me breshëri (refall) nga mitralozi. Mua më thirri axha im, i cili tha se është rrezik. Ne ishim mësuar me krisma çdo ditë dhe fillimisht nuk m'u duk shumë rrezik. Kur u bë ora 7.00 filloi të granatohej fshati me një intensitet shumë të fortë, por kishte edhe breshëri plumbash të gulinovit dhe snajperista serbë. Nga frika u bashkuam të gjithë në shtëpinë e Idriz Hajrizit.

Ishim afërsisht 20 vetë. Axha im, Bajrami, me vajzën e vetë, Hanumshahen dhe djemtë, Vehbiun dhe Elhamiun, bashkë me familjen e Smajl, Kadridhe dhe Hajriz Hajrizit. Në orën 10.30 erdhi tek ne Hasan Bilalli, i cili na tregoi se u futën policia në fshat. Ne për të gjetur një vend më të sigurt filluam të ecim dhe arritëm në trekëndëshin e rrugëve të lagjeve Emini Beqa dhe Syla. Atëherë kanë filluar të shtëna me breshëri dhe tani mund ta krahasoj vetëm me ndonjë shi të madh, ashtu vinin plumbat. Fillimisht u qëllua Elhamiu, atëherë ishte vetëm 9 vjeç, dhe u plagos në këmbën e djathtë. Hanumshahja bërtiti me zë të lartë duke thënë, o bac e plagosën Elhaminë, dhe duke u afruar baci Bajram u qëllua në kokë. Në atë moment u qëllua edhe Hanumshahja në gjoks. Tani kur po e bëj

këtë deklaratë po rrënoqthem sepse unë nuk isha më larg se 1 metër nga këta dhe nuk kishte më keq se t'i shihje njerëzit duke u vrarë para vetes. Pastaj Arben Hajrizi ka kërcyer në një prockë që kalon uji dhe ku është çezmja e fshatit. Në atë vend më nuk na zënë plumbat. Duke kërcyer u plagosën edhe Makfirete Hajrizi, Florie Hajrizi dhe Hasan Bilalli. Ne e morëm zvarrë Elhamiun, ndërsa baci Bajram mbeti në vend.

Hanumshahja me ndihmën tonë eci nja 10 metra dhe ajo vdiq haj haj subhanllah.

Ne të tjerët, së bashku me dy të plagosur u strehuam në një objekt përcjellës të kuzhinës, thënë më thjeshtë, me një flanik të Hajriz Hajrizit. Granatimet dhe krismat nuk u ndalën deri në orën 16.00. Policia filloi të na kërkojë nëpër shtëpi. Ne i dëgjuam duke folur, por fati jonë se ata nuk menduan se në atë flanik ka njerëz. Në orën 16.00 filloi t'i bjerë terri tokës dhe u ndalën krismat. Unë dola bashkë me Smajl Hajrizin, Avni Beqen, Nuredin Beqen, Muhamet Shaqirin dhe e mora kufomën e Bajramit dhe e vendosa në shtëpinë e Ekrem Hajrizit. Hanumshahen e vendosëm në odën e shtëpisë së vetë. Unë kujtova se u vra Zenel Beqa, Rizahi me djalin, Halim Beqen 12 vjeç dhe Ajet Brahimi dhe me disa të tjerë kemi marrë të plagosurit Zymri, Fetihe Beqen, Hasan Bilallin, Makfirete Hajrizin dhe Elhami Mehmetin. Më kujtohet se i pari nga pjesëtarët e misionit të OSCE-së që hyri në Reçak ishte Leon Peper.

Kur i treguam se çfarë ka ndodhur, ai i mori të plagosurit, se më shumë rëndësi i dha të plagosurve mbasi ai tha se të vrarë ka ende, nuk janë veç këta këtu, por ka më shumë.

Atë natë hulumtuam se kush është vrarë. E gjetëm Nazmi Imerin dhe mësuam që e kishin vrarë edhe Sahide Netushin, por që trupin e saj të vrarë e kishte marrë policia me vete.

Më 16 janar bashkë me Aziz Beqirin dhe Xhemajl Beqirin e dërguam një listë me emrat e të vrarëve dhe të plagosurve në fshatin Luzhakë. Rreth orës katër të mëngjesit u takova me inxhen Salë dhe ajo ma tregoi rrëfimin e saj të tmerrshëm. Ne e dinim që janë vrarë 14 vetë, ndërsa për 30 të tjerë mendonim se janë arrestuar nga policia.

Edhe një vëzhguesit e OSCE-së na njoftuan se nuk ka asnjë të arrestuar, na lanë të kuptojmë se janë diku afër.

Më 16 janar vërtetë kuptuam se kishte ndodhur një masakër. Reçakun e mbuluan një numër i madh i gazetarëve, ndër të parët ishin Sylejman Kllokoqi, kameraman dhe Hazir Reka, fotoreporter. Në mesin e shumë vëzhguesve erdhi edhe ambasadori William Walker. Atë ditë ka qenë tmerr i madh: njerëz të vrarë, me koka të këputura, zemra dhe organe tjera të hequra nga trupi. Më kujtohet kur Walker-i tha se kurrë më parë nuk e kam parë këtë që po e shoh sot këtu në Reçak. Është krim kundër njerëzimit, përfshirë të gjitha grupmoshat: që nga nxënësi 12 vjeçar, mësuesi

dhe sekretari i shkollës e deri tek plaku afër 100 vjeçar. Për 42 civilë të vrarë ekzistojnë edhe fotot.

Përmes ambasadorit Walker edhe bota e qytetëruar e kuptoi se çfarë po bënte Serbia me popullsisë e pafajshme.

Mbrëmja e 16 janarit kaloi në heshtje, ndërsa ne ishim të pikëlluar dhe të trazuar në shpirt.

Ne menduam se pas fotografimit të tyre nga ana e OSCE-së dhe gazetarëve tani mund t'i varrosnim, por pastaj të afërmit tanë u çuan në xhaminë e fshatit. Serbia pasi që bëri krim u mundua ta fshehë atë duke përdorur forcë të paparë ndonjëherë. Vëzhguesit e OSCE-së e panë rrezikun dhe na tërhoqën vërejtjen se është shumë rrezik se ushtria dhe policia serbe duan t'i marrin me forcë kufomat.

Pasi u larguan vëzhguesit filloi një luftë e ashpër ndërmjet forcave serbe dhe njërive të UÇK-së. Komplet zona operative e Nerodimës dhe njësia vëzhguese "Diversanto", bënë luftë shumë të hatashme, e cila është e njohur si lufta për kufoma, ku pas tri ditë luftimesh forcat serbe arritën t'i marrin kufomat.

Kufomat e 42 civilëve i mbajtën në morgun e spitalit të Prishtinës, gjoja për t'ja bërë obduksionin dhe i mbajtën aty deri më 10 shkurt. Disa herë i kanë thirrur familjarët që t'i marrin kufomat në mënyrë individuale, por ata nuk pranuan assesi. Më 10 shkurt 1999, në mënyrë të organizuar i morëm kufomat dhe prapë i vendosëm në xhaminë e fshatit.

Më 11 shkurt është bërë varrimi, ku kanë marrë pjesë qindra mijë qytetarë të Kosovës, si dhe ambasadori William Walker.

Varrimi u bë me rite fetare të besimit islam, pasi që të gjitha viktimat ishin të besimit islam.

Për mua 15 janari ishte një tronditje e madhe. Pastaj unë hyra në shërbim të drejtorisë civile të UÇK-së, të zonës operative të Nerodimës. Nga kjo kohë deri në çlirimin e Kosovës kam parë shumë ngjarje të dhimbshme: kolona me refugjatë, si dhe fshatra të tërë të shkatërruar.

Më 12 qershor 1999, falë Zotit, gjakut të dëshmorëve, luftës së UÇK-së, ndihmës së Amerikës dhe NATO-s , Kosova u çlirua. Pas luftës filloi një jetë e re me plot vuajtje dhe mërzi. Unë kam marrë pjesë në zhvarrimin e Halim Shaqirit dhe Hasan Beqirit, si dhe të moshuarit 99 vjeçar, Abdyl Sejdiut. Më 30 gusht 1999, u bë rivarrimi i këtyre 3 kufomave në kompleksin e varrezave në Reçak.

Kjo nuk është intervista e parë që po bëj. I kam dhënë edhe 2 deklarata tribunalit të Hagës në Maj-Qershor 2002 dhe kam dëshmuar në Hagë kundër Sllobodan Millosheviçit.

Për fund, mendoj se Serbia duhet të na kërkojë falje publike, t'i kthejë të zhdukurit tanë dhe të kompensojë dëmet e luftës.

Dhashtë Zoti që më kurrë mos të përsëritet lufta, mos të përsëritet masakra e Reçakut. Lavdi të gjithë atyre që dhanë jetën për liri!

1**UNË DUA TË DËGJOHEM!**

2

Bisedë me

Rexhep Muhaxherin

Nga fshati Dremjak

...që në vitin 1995 policia serbe më ka marrë në biseda informative dhe unë jam detyruar të emigroj në Gjermani ku dhe kam qëndruar rreth dy vjet, pastaj jam kthyer.

Mundimi dhe problemet nuk kanë filluar vetëm kohën e fundit, por tek unë kanë qenë të pranishme shumë më herët, qysh nga grevat e minatorëve unë jam solidarizuar jo me krejt kolegët, por me një pjesë të kolegëve dhe e kemi bojkotuar mësimin dhe nuk mund të zhvillohej mësimi.

Kanë pasuar edhe probleme të tjera, si mbyllja e shkollave. Unë para policisë serbe e kam hapur shkollën në Dremjak (fshat në Ferizaj) vetëm për mos ta ndalur mësimin. Sigurisht se të gjitha këto kanë ndikuar në përfundimin tim deri tani.

Kur hynë forcat serbe në fshatin tuaj?

Më 16 prill 1999 ka dalë gruaja ime bashkë me Sanijen, do të thotë gruaja ime, Emin Muhaxheri dhe Sanije Muhaxheri, kah ora 11 kanë shkuar në Ferizaj për të vërtetuar se a i kanë prindërit aty apo jo dhe që nga ai moment më nuk janë kthyer dhe nuk kemi asnjë informatë lidhur me to. Ato gjatë kohës së luftës kanë punuar vazhdimisht, kanë pasur një udhëtim shumë të pazakonshëm, se ditën është dashur të gatuajë për ushtarë ndërsa natën ta kalojnë në Mollopolc (fshat në Shtime), do të thotë që në mbrëmje i kemi zgjuar, ndërsa në mëngjes i kemi sjellë këtu. Haxhi Zena, baba i Salihut, ka shkuar në qytet, është interesuar për ato gra dhe është takuar me një kryekriminel të Nerodimes, punëtor i sigurimit, Nebojsa Gjorgjeviç dhe ai i ka premtuar se le të dorëzohen djemtë se gratë do t'i lëshojnë.

Katër herë ka pasur takim me të dhe neve na është dashur t'i lëshojmë shtëpitë për shkak të luftimeve dhe na ka humbur kontakti me të.

Pas arrestimit të bashkëshortes suaj ku keni qëndruar?

Edhe një javë kemi qëndruar në fshat, pastaj unë së bashku me tre fëmijët dhe nënën plakë kemi shkuar në Mollopolcë. Kanë kaluar muaj deri sa jemi kthyer pas përfundimit të krejt atyre ofensivave që kanë ndodhur. Në Mollopolcë kemi qëndruar në familjen e Azem Salihajt. Gjatë qëndrimit tonë në Mollopolcë herë kemi ndenjur në shtëpi e herë në tenda të improvizuara, të cilat kanë qenë në male, gjithmonë kur ka pasur sulme të ndryshme ne kemi shkuar në tentat tona në male dhe pasi është qetësuar situata jemi kthyer në shtëpi.

Gjatë ofensivës së fundit me urdhër të UÇK-së ne kemi shkuar në fshatin Rancë (fshat në Shtime) dhe kemi qëndruar një ditë. Vetëm që ajo natë në Rancë ka qenë me të vërtetë një tmerr i madh, pasi që nuk kemi pasur as ku të flemë as çfarë të hamë.

Të nesërmen jemi kthyer prapë në Mollopolcë dhe aty e kemi gjetur një njeri totalisht të masakruar, e kemi gjetur në stallë të lopëve, i prerë me thikë dhe çfarë ka qenë më e rëndë se ai person ka qenë i sëmurë psiqikisht dhe e kemi varrosur ashtu si kemi mundur, pasi që nuk kemi mundur as t'ia bëjmë ritualin si duhet, mbasi kufoma ka qenë e masakruar.

Ndërsa familja ime, nëna me tre fëmijët dhe vëllau kanë shkuar në Muhofc (fshat në Ferizaj) te një mik i yni, ndërsa unë kam qëndruar dhe kohë pas kohe kam shkuar që t'i vizitoj, gjithmonë kam shkuar natën për ta vizituar familjen time.

Si e keni siguruar ushqimin?

Eh, ka qenë interesant, por fatmirësisht e kena pasë miellin në shtëpi dhe në traktor të vëllait e kemi ngarkuar edhe e kemi çuar drejt e në Mollopolcë. Gjatë kohës që kemi qëndruar në Dremjak e kemi pasë një fond që e kemi bashkuar me vllazninë dhe jemi gjindur ashtu si kemi mundur.

Në vitin 1998 unë jam burgosur për dy vepra penale, siç thuhet, terrorizëm dhe vepra penale në vazhdim ku më kanë dërguar në burgun e Gjilanit dhe kam qëndruar për 4 muaj.

Gjatë qëndrimit tim në burgun e Gjilanit kam përjetuar tortura dhe keqtrajtme të mëdha fizike dhe psikike. Falë Zotit dhe familjes sime që kanë paguar me qindra marka për lirim tim më është organizuar gjykimi në Prishtinë ku jam shpallur i pafajshëm.

Çfarë ka ndodhur pas luftës?

Pas luftës kanë ardhur dy policë shqiptarë dhe dy turq dhe i kemi dhënë një intervistë dhe pastaj kanë ardhur ata të Kryqit të Kuq dhe ja kanë marrë mostrat e gjakut fëmijëve të mi.

Pas përfundimit të luftës kanë filluar kërkimet, disa shqiptarë në bashkëpunim me serb kanë kërkuar pare, gjoja se ato janë gjallë. Ne i kemi çuar paret bashkë me kushëririn tim Salihin, bile ka qenë edhe një i Ferizajit, më duket i Mirosalës, në mos gabohem dhe ka rënë në kontakt me një avokate dhe kanë thënë që ato janë gjallë. Unë kam biseduar personalisht me të në telefon se kam dashur ta njoh më mirë dhe ajo më ka treguar detaje për familjen time, që unë i kam tre fëmijë dhe e ka caktuar një shumë prej 5.000 markash dhe ne kemi shkuar në Merdare dhe ja kemi dhënë paret dhe ajo është paraqitur në emër të një avokateje dhe na ka dhënë shpresa të mëdhaja se do t'i kthejnë gjallë. Një kohë të gjatë nuk është lajmëruar në telefon dhe pas një kohe ka ardhur një thirrje telefonike te kushëriri Salih, se gjoja duhet t'i sjellim edhe nga 25.000 marka dhe të shkojmë në Gostivar. Kemi shkuar të dy në Gostivar me Salihun, me nga 25.000 marka secili dhe jemi kthyer të zhgënjyer se sigurisht qëllimi i tyre i vetëm ka qenë që t'i marrin ato para.

Aty jemi takuar me një shqiptarë, i cila ka biseduar me ta në telefon dhe i kanë thënë se nuk ka siguri për t'i dërguar në Maqedoni, vetëm nëse doni të vini në Hungari apo në vende të tjera. Ne jemi kthyer në shtëpi dhe prej asaj dite nuk kemi asnjë telefonatë prej tyre apo ndonjë lajm tjetër.

Sa kanë ndikuar këto ngjarje në punën tuaj si mësimdhënës?

Të them të drejtën, përkundër vështirësive dhe përkundër krahurave që kemi kaluar, kur kam filluar punën me nxënës e kam ndier veten shumë mirë, i kam lënë mënjane të gjitha ato peripeci dhe vështirësi.

A keni marrë ndonjë beneficion nga institucionet?

Deri tani absolutisht asnjë stimulim nuk e kemi marrë, sado i vogël qoftë. Para dy muajsh më ka informuar sigurimi social se të takon një beneficion për të zhdukurit dhe kam kompletuar dokumentacionin e fëmijëve dhe tani e tutje e gëzoj një pension prej 130 euro.

2**UNË DUA TË DËGJOHEM!**

3

Bisedë me

Mimoza Halimin

Refugjate në Maqedoni

Si keni jetuar ju dhe familja juaj gjatë viteve '98 -'99?

Në atë kohë unë isha 12 vjeçe, në fshatin tim ku jetoja unë (Kuk, Opojë), në korrik të vitit '98 filloi që të tensionohej situata vazhdimisht. Kishte shtim të forcave serbe dhe ne ishim shumicën e kohës të izoluar, thujse nuk dilnim fare nga shtëpia. Diçka që më ka mbetur mua në kujtesë, është një rast që në një fshat afër fshatit tim u bë një dasmë, mirëpo forcat serbe nuk lejoi që shqiptarët të mblidheshin bashkë, apo të festonin diçka. Po atë ditë forcat serbe filluan të bastisnin tërë fshatin dhe meshkujt e asaj shtëpie janë fshehur diku, për shkak se ishin të përndjekur vazhdimisht nga ta. Pasi që u largua policia serbe nga shtëpia e tyre, meshkujt e asaj shtëpie dolën, por njërin prej tyre e hetuan dhe e vranë. Krejt kjo më kujtohet se dikush ka mbetur i vranë aty dhe nuk di më shumë për detajet. Po që nga ajo kohë, nga ky rast d.m.th, meshkujt e asaj ane, të rinjtë e asaj ane janë larguar, kanë shkuar për Shqipëri apo Maqedoni, apo në ndonjë vend tjetër në përfundim, për shkak se kishin frikë të rrinin aty, se mos po ju ndodhë diçka edhe më e keqe. Aty mbetën vetëm kryefamiljarët, për një mbështetje më të madhe për gratë dhe fëmijët. Çdo familje e asaj ane, që nga ajo ditë që ka ndodhë ky rast ishin të tmerruar e në çdo çast pritnin më të keqen.

Edhe në familjen time askush nuk dilte nga shtëpia, vetëm kur kishin ndonjë punë ose kur ne fëmijët shkonim në shkollë. Rrugës kur shkonim në shkollë dhe brenda oborrit të shkollës kishte ushtarë serb.

Kishim frikë nga ta dhe mënyra se si ata na shikonin ishte e tmerrshme. Kjo ngjallte një frikë të madhe tek fëmijët e shkollës dhe si pasojë e kësaj ne asnjëherë nuk i kemi mbajtur orët e mësimit me orar të plotë, por gjithmonë me orar të shkurtuar. Përveç se ne nxënësit ishim të shqetësuar, edhe mësuesit e shkollës sonë ishin nën presion të vazhdueshëm, sepse ka ndodhur shumë herë që policia serbe të hynte në shkollën tonë, pa kurrfarë paralajmërimi dhe i merrte në pyetje të gjithë arsimtarët, sepse ata donin të dinin se mos po punohej diçka kundër regjimit serb ose mos po organizohej aty ndonjë lëvizje separatiste. Në atë kohë, mbaj mend se në familjen time, por edhe në çdo familje tjetër, nuk flitej për gjë tjetër përveçse çka po ndodhte në Kosovë. Çdo ditë e më tepër dëgjonim për mizoritë që policia dhe ushtria serbe bënte ndaj popullit shqiptar, keqtrajtonin, vritnin njerëz, arrestonin, bënë gjithçka me ta. Në televizor nuk shihje gjë tjetër përveç lajmeve dhe raportimeve rreth këtyre ngjarjeve dhe për mua si fëmijë, në atë kohë, kjo ishte e tmerrshme dhe shumë shqetësuese.

Vazhdimisht, familja ime ishim të shqetësuar për babain dhe axhën tim, se babai im ishte mjek, ndërsa axha ishte teknik medicinal dhe ata punonin në një fshat afër fshatit tim. Babai im më herët kishte punuar

në Prizren, por në fillim të viteve '90, atë e kanë larguar nga puna dhe është detyruar të ushtrojë profesionin e tij privat, për shkak se duhej të siguronte mjete për jetesë. Duke marrë parasysh se ushtria serbe, policia serbe dhe regjimi serb gjithmonë i kanë ndjekur njerëzit intelektual, të shkolluar dhe ata që punonin në një ambulancë aty afër fshatit tim gjithmonë ishin nën mbikqyrjen e tyre, se çka po bëjnë, si po punojnë dhe ne ishim të shqetësuar se a po kthehen, si po kthehen dhe çfarë do të ndodhë me ta.

A ka ndodhur ndonjëherë që policia ose ushtria serbe ta kërcënojnë familjen tuaj ose ta bastisin shtëpinë tuaj?

Po ka ndodhur disa herë që të na kërcënojnë, por një rast më i veçantë ka qenë një ditë kur fshati ynë u mbush me policë dhe ushtarë serb. Babait tim i kishte thënë dikush se në fshat po shtohet gjithnjë e më shumë numri i tyre. Atëherë babai tha se ne duhej të largoheshim prej shtëpisë. Ne u nisëm për të shkuar tek shtëpia e hallës. Ajo e kishte shtëpinë në krye të fshatit, afër bjeshkëve dhe e kishim më lehtë të vazhdonim rrugën për të ikur në Maqedoni.

Por fshati ishte plot me policë dhe ne nuk kishim guxim të vazhdonim rrugën, që të shkonim deri atje, atëherë ne u futëm në një mulli, që ishte afër lumit të fshatit tonë e nuk binte shumë në sy dhe qëndruam aty të ngujuar për disa orë. Policia kishte hyrë në shtëpinë tonë dhe kishte shkatërruar gjithçka, librat i kishin shkyer nëpër tokë, mobiljet dhe dritaret i kishin thyer dhe e kishin kthyer të gjithë shtëpinë përmbys.

Pas disa orëve, kur policia ishte larguar paksa nga fshati, edhe pse kishin bastisur shumë shtëpi në fshat, ne u larguam prej mullirit dhe shkua tek shtëpia e hallës, por gjithmonë na përcillte frika se mos po e kërkonte policia babain tim prapë. Pasi shkua tek halla, babai im merr guximin dhe shkon me djaln e hallës tek shtëpia jonë, për të parë se në çfarë gjendje ishte ajo. Kur shkoi babai në shtëpi, e pa se çfarë është bërë aty, na tregoi neve dhe i mori disa ilaçe e disa gjëra që na duheshin dhe nuk jemi kthyer më për disa muaj rresht në shtëpi, nuk kemi pasur guxim të shkojmë. Gjatë atyre muajve endeshim herë tek shtëpia e dajve të mi, herë tek shtëpia e hallës, por nuk kishim guxim të ktheheshim në shtëpi, sepse babai im ishte në shënjestër të policisë serbe.

**Si e keni përjetuar
shpërnguljen masive të
popullit shqiptar nga shtëpitë e tyre?
A ka qenë edhe
familja juaj një ndër ato?**

Po, 31 marsi i vitit '99 ishte afati i fundit për banorët e Opojës që t'i lëshonin shtëpitë e tyre, ishte ultimatum i tyre që ia kishte dhënë ushtria dhe policia serbe për t'i lëshuar shtëpitë. Shumica e fshatrave të Opojës, pothuajse të gjitha, filluan t'i lëshonin shtëpitë e tyre atë ditë dhe u nisën për në Shqipëri, Maqedoni apo edhe diku tjetër, përveç fshatit tim dhe një fshati aty afër që thirret me emrin Bresanë, për shkak se disa bashkëpunëtorë, d.m.th, ata ishin disa fshatarë që bashkëpunonin me regjimin, policinë dhe ushtrinë serbe, të cilët na ngujuan neve, të dy fshatrat me arsyetimin se nuk keni pse të shkoni, jeni të sigurt këtu, na garantuan se nuk do të ndodhë asgjë dhe nuk keni arsye pse të bëni panik. Edhe pse shumë fshatarë ngulnin këmbë që ta lëshonin fshatin sepse nuk ndiheshin të sigurtë përballë një ushtrie të tërë dhe në shumë fshatra përreth ushtria serbe kishte filluar t'i prishte dhe t'i digjte shtëpitë, ne kemi qëndruar në fshat edhe një javë rresht. Spiunët apo bashkëpunëtorët e regjimit serb ngulnin këmbë se nuk kemi arsye pse ta lëshojmë fshatin, por familja ime për një javë rresht ka dashur të shkojë në Maqedoni, kah bjeshkët e Sharrit,

për shkak se babai im ishte i kërkuar nga policia serbe dhe nuk guxonim ta kalonim kufirin për në Shqipëri.

Mirëpopërpjekjettonaishintëpasuksesshme.Gjatëkëtyre ditëve ne kemi bërë përpjekje të ecim në këmbë kah bjeshkët e Sharrit, të kalojmë kufirin dhe të shkojmë në Maqedoni. Edhe pse në mesin tonë kishte pleq dhe fëmijë shumë të vegjël, nuk kishim zgjidhje tjetër, edhe pse ishte shumë e vështirë të ecnim më këmbë, ne duhej t'ia bënim disi për të mbijetuar. Kemi tentuar disa ditë rresht për ta kaluar kufirin. Në ditën e parë, të gjithë bëmë përpjekje për ta kaluar kufirin që në orët e hershme të mëngjesit deri nga ora 5 apo 6 pasdite.Kemi ecur në këmbë disa kilometra nëpër bjeshkë dhe kur na kishte mbetur shumë pak për të arritur deri te kufiri i Maqedonisë, na doli ushtria serbe në mes të rrugës, na zuri rrugën dhe na mori në shënjestër. Pushkët i kishin të drejtuara kah ne dhe ne nuk guxonim të bënim lëvizje as në drejtim të kufirit e as në drejtim të fshatit. Kështu që ushtria serbe na detyroi që të kthehemi përsëri në fshat. Edhe ditën e dytë bëmë të njëjtat përpjekje, por prapë ushtria serbe na e ndërpreu rrugën, nuk na lejuan që të vazhdojmë më tutje. Çdo ditë e më tepër rezervat tona ushqimore po harxhoheshin dhe prindërit tanë e kishin shumë të vështirë dhe brengoseshin shumë se si do t'ia bënin që t'i ushqenin fëmijët e tyre. Edhe ditën e tretë vazhduam me të njëjtën përpjekje që ta kalojmë kufirin, por situata ishte e njëjtë. Përpjekjet tona ishin prapë pa sukses. Paramendo të ecësh bjeshkëve për tri ditë rresht në këmbë, kur moti ishte

i ftohtë, i lagësht, me një fjalë katastrofë dhe ne ishim vazhdimisht të frikësuar, nga momenti në moment prisnim që ushtria serbe do të gjuante mbi ne. Kjo ishte e tmerrshme. Tani kur po i kujtoj ato momente, po më rrëqethet trupi. Unë isha një fëmijë 12 vjeçar në atë kohë dhe një rrugë aq e gjatë, për mua ishte një keqtrajtim i madh. Prej lodhjes dhe qëndrimit të gjatë në këmbë, këmbët filluan të më fryhen, të më mavijosen, dikur m'u gërvishtën, m'u çanë dhe filluan të më gjakonin.

Kisha dhimbje të tmerrshme. Mbaj mend që i thashë babait tim: "Pse nuk shkojmë edhe ne t'i bashkangjitemi kolonës për të shkuar në Shqipëri". Ai m'u drejtua e më tha: "Nëse do që unë të jem me ty, atëherë ne duhet të bëjmë përpjekje që të dalim disi nëpërmjet bjeshkëve, fshehurazi dhe në këtë mënyrë të dalim në Maqedoni. Sa për Shqipërinë, mua po më kërkon policia, ushtria serbe dhe jeta ime është në rrezik. Më mirë është ta vazhdoj rrugën për Maqedoni ndërmjet bjeshkëve, fshehurazi. Edhe pse pas ditës së tretë, ishim të lodhur e të rraskapitur, vazhdimisht kemi ecur rrugëve për të dalur në Maqedoni se nuk kishim zgjidhje tjetër përveç asaj, kështu që disa anëtarë të familjes, vendosën t'i bashkangjiten kolonës për të shkuar në Shqipëri, kurse babai dhe axha im nuk kishin zgjidhje tjetër. Mënyra e vetme ishte të shkonin në Maqedoni dhe më 4 Prill, me sa më kujtohet mua, ora 3 e mëngjesit, iu lutëm t'i bashkangjiteshim dikujt që ishte prej një

fshati afër fshatit tonë, që thirrej Bresanë, meqënëse ai e njihte terrenin mirë prej andej. Kështu që ai pranoi dhe ne shkuam atje dhe u mblodhëm në një shtëpi, nuk e di, nuk më kujtohet e kujt ka qenë ajo. Aty u mblodhëm të gjithë dhe vazhduam rrugën prej orës 4 të mëngjesit. Bjeshkëve ishte ftohtë, binte borë, terreni nuk ishte edhe aq i përshtatshëm, por na ndihmuan disa fshatarë që ishin pak më të rinjë, se axha im e ka pasë një vajzë të vogël, pesë javëshe, e ne nuk guxonim as ta shikonim a është gjallë apo ka vdekur.

Nuk e di si ka mundur të mbijetojë se ka qenë e izoluar, e kemi pasë futur në një torbë dhe e kemi pasë mbështjellë me qese. Prej orës 4 të mëngjesit deri në orën 5-6 pasdite, nuk e di sa ka qenë ora e saktë, kemi mbërritur në disa fshatra kufitare të Maqedonisë, në Veshallë më duket se thirret, atje na kanë pritur fshatarët dhe Caritasi zviceran na ka dhënë tesha, sepse ishim bërë qull, ishim lagur. Ata na dhanë bukë të hamë dhe na vendosën në disa shtëpi.

Pse atë fëmijën e vogël pesë javëshe e kishit izoluar në torbë?

Për shkak se ishte shumë e vogël dhe kushtet ishin shumë të këqija. Ajo ishte mënyra e vetme për ta shpëtuar dhe për ta mbajtur pak më nxehtë. Nuk mund ta mbanim në dorë se ka qenë shumë ftohtë.

Në anën tjetër, prindërit e mi ishin shumë të brengosur për prindërit e tyre se ata kishin vendosur t'i bashkangjiteshin kolonës, për të shkuar në Shqipëri. Ata ishin shumë të moshuar dhe nuk mund ta përballonin rrugën në këmbë, kështu që ne nuk kishim lajme për ta, a e kanë kaluar kufirin, a janë gjallë apo ku ndodhen.

Na e përshkruani qëndrimin tuaj si refugjatë në Maqedoni?

Ne fillimisht kemi qëndruar për dy ditë në fshatin Veshallë, ku na ka strehuar një familje e atij fshati dhe kemi qenë 20 vetë në një dhomë.

Sa ditë keni qëndruar aty?

Dy ditë. Prej aty kemi shkuar në Kërçovë, në një qytet afër Tetovës dhe na ka strehuar një familje e atij qyteti. Aty kemi ndenjur tre muaj, ka qenë mirë, por normalisht që mërziteshim për situatën në Kosovë. Pas dy-tri javësh kemi marrë vesh për anëtarët e tjerë të familjes, që kanë kaluar kufirin shëndosh e mirë.

Kufirin për Shqipëri?

Po për Shqipëri. Ne fëmijëve na regjistruan nëpër shkolla, sepse mendonin se lufta do të zgjaste me vite të tëra dhe patjetër që duhej ta vazhdonim shkollën ose ta ndërprejmë fare. Unë personalisht nuk kam dashur të shkoj në shkollë sepse jam ndier shumë e diskriminuar, e fyer, e ofenduar prej shoqërisë aty. Ishte një rreth krejt ndryshe dhe unë ndihesha keq me mënyrën se si më parashtronin pyetje mësuesit dhe nxënësit. Nuk kishin fare konsideratë se a je refugjatë dhe se çfarë ke kaluar apo çfarë ke përjetuar.

Pas sa kohësh qëndrimi si refugjatë në Maqedoni jeni kthyer në vendin dhe fshatin tuaj?

Ne kemi qëndruar gjithsej tre muaj në Maqedoni. Gjatë kësaj kohe ishim shumë të shqetësuar dhe të mërzitur, ndoshta unë personalisht jo edhe aq, por prindërit e mi po. Ata ishin shumë të shqetësuar, fjalë pak, të mërzitur për atë që ndodhte në Kosovë, sepse me atë që dëgjonin në televizor, në lajmet që shihnim, në Kosovë po bëhej gjithçka. Unë atëherë isha fëmijë 12 vjeçar dhe nuk arrija ta kuptoja rëndësinë e situatës. Kur i shihnim të mërzitur prindërit, atëherë mërziteshim edhe ne

Po kur u kthyet në fshatin dhe shtëpinë tuaj, si e gjetët gjendjen atje?

Të gjitha shtëpitë e fshatit kanë qenë të shkatërruara, por jo shumë të djegura, vetëm ndonjë tek-tuk. Dyert dhe dritaret ishin të thyera, orenditë dhe mobiljet të shkatërruara, teshat ishin krejt të prishura, por kryesorja ishte që ne arritëm të mbijetonim.

4

Bisedë me

Hazir Berishën

I mbijetuar në masakrën e Qyshkut

Z. Berisha një prezantim i shkurtër i juaji ju lutem?

Fillimisht dua t'ju falenderoj juve si organizatë që keni gjetur kohë të vini dhe t'i bashkoheni vuajtjeve që kemi përjetuar si popull. Përndryshe, unë jam Hazir Berisha, i lindur në fshatin Qyshk të Pejës. Jam i martuar dhe jetoj me bashkëshorten dhe tre fëmijë: dy vajza dhe një djalë.

Z. Berisha a mund të na tregoni përgjithësisht se si ka qenë jeta juaj dhe e familjes suaj gjatë viteve të 90-ta?

Gjatë viteve të 90-ta ka qenë një jetë ashtu të them mesatare, as e mirë dhe as shumë e dobët. Kam qenë punëtor në fabrikën e këpucëve, kam punuar aty prej vitit 1986 dhe kam pasur një jetë mesatare. Pastaj gradualisht ka ardhur duke u keqësuar gjendja edhe me pune edhe me situatë dhe gradualisht ka filluar edhe rënia e gjendjes ekonomike, jo vetëm në familjen time, por në përgjithësi te familjet shqiptare. Me kalimin e kohës filluan edhe ato dallimet, largimet aty - këtu nga puna. Ky dallim u vërejt edhe në fabrikën tonë, kur filluan t'i largonin disa nga puna.

Përse i largonin nga puna?

Sipas tyre e vetmja arsye ka qenë se ne i kemi kundërshtuar ligjet e Serbisë, por arsyeja e vërtetë ka qenë se ne ishim shqiptarë, asgjë tjetër më tepër. Aty kishte edhe punëtorë serb dhe të kombësive të tjera, që i kundërshtonin edhe më shumë, por për ta nuk kishte pengesa.

Deri kur kenivazhduar të punoni?

Nëse nuk gaboj, deri në vitin 1996. Nuk kemi pasur çfarë të punonim më. I kanë mbajtur vetëm punëtorët që i konsideronin më të përshtatshëm për të punuar me ta dhe ata të cilët kanë pranuar të punojnë pa të ardhura, sepse atyre ju jepnin në mënyra të tjera. Kishin mbetur punëtorë kryesisht të kombësisë serbe, pastaj romë, ashkali dhe aty-këtu ndonjë mysliman. Shqiptarët kanë qenë një numër shumë i vogël.

Pasi jeni larguar nga puna, si keni arritur ta siguronit ekzistencën ju dhe familja juaj?

Jeta ka ardhur duke u vështirësuar. Kemi punuar punë private, për të mbijetuar. Kemi punuar punë krahu, mjeshtri, thjesht jemi marrë me çdo punë që ka qenë e lejueshme, vetëm për të mbijetuar.

T'i kthehemi pak luftës në Kosovë. Ku keni qenë ju në atë periudhë?

Kur ka filluar lufta në Kosovë unë kam qenë në fshatin Qyshk. Ka filluar në 1997 në Drenicë dhe pastaj në vitin 1998 është shpërndarë edhe nëpër trevat e Dukagjinit. Kështu edhe neve këtu në Dukagjin na përfshiu e njëjta krizë dhe filluam të përballeshim me luftën që na e imponoi vetë Serbia. Deshi apo s'deshi, populli është dashur t'i përgjigjej ftesës për rezistencë, sepse ne faktikisht po e mbronim vendin tonë, shtëpitë tona dhe nuk kishim nga të shkonim tjetër përtej shtëpive tona.

Ju personalisht a i jeni përgjigjur ftesës për rezistencë?

Edhe unë kam qenë pjesë e projektit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe pse nuk kam marrë pjesë nëpër beteja. Kam ndihmuar në furnizimin me ushqim, me ilaçe dhe me gjëra të tjera, që kanë qenë të nevojshme për atë periudhë. Po ashtu kam ndihmuar në strehimin e shumë familjeve duke i dërguar në vende më të sigurta për një periudhë kohore prej një, dy apo tre ditësh. Pra, edhe unë në një formë kam qenë pjesë e atij projekti.

A mund të na tregoni më detajisht se si ka qenë ajo periudhë, si keni arritur t'i ndihmoni. Nga cilat vende vinin të zhvendosurit dhe ku i strehoni?

Të zhvendosurit vinin kryesisht nga zonat e luftës në Rrafsh të Dukagjinit. Disa i strehoni aty në fshatin tonë, disa i dërgoni në fshatrat ku ata kërkonin dhe disa të tjerë i orientoni nga fshati Radavc sepse ata kishin si qëllim të kalonin në territorin e Malit të Zi, përkatësisht në Rozhaj. Në tetorin e vitit 1998 situata u keqësua edhe më shumë dhe kjo rezultoi me një fluks më të madh të refugjatëve. Edhe ata, sikur të tjerët, i strehoni nëpër familjet tona apo nëpër familjet e të afërmeve tanë, të cilët kishin mundësi për t'i mbajtur. Ndonëse në kushte mjaft të vështira qëllimi ishte t'i ndihmoni ta kalonin atë dimër nën strehë dhe të mbijetonin disi me ato halle që i kishin. Shumica nga ata ishin në gjendje të traumatizuar, kishin të vrarë nga familjet e tyre dhe ishin në gjendje shumë të keqe.

Si arrinit të furnizoheshit me ushqim dhe ilaçe, nga i merrnit ato në atë periudhë?

Fatmirësisht shtëpia ime ka qenë shumë pranë qytetit. Zakonisht udhëtoja në këmbë apo herë pas here edhe me një biçikletë, por me veturë assesi. Kisha njerëz të njohur nëpër barnatore private dhe shumicën e ilaçeve i merrja me paret e mija, por nganjëherë edhe me paret e shoqërisë. Ato ilaçe i dërgoja në fshat dhe pastaj nga aty i shpërndanim nëpër zonat e tjera ku kishte nevojë. Nga frika se mos po më ndalnin në ndonjë patrullë policore, ilaçet i maskoja me gjëra të tjera ushqimore dhe ashtu i dërgoja në zonat e tjera. Mbase fakti që unë kam lëvizur shpesh nëpër fshat ka ndikuar për të mirë sepse për ta kam qenë fytyrë e njohur dhe nuk kanë dyshuar se mund të merrem me punë të tilla.

Gjatë asaj periudhe a keni jetuar në familjen tuaj apo jashtë shtëpisë suaj dhe a ishit në shënjestër të serbëve në atë kohë?

Kam jetuar me familjen time të gjerë. Kam pasur kërcënime shumë herë, por pavarësisht nga ato unë kam vendosur që të mos e lëshoj vendin. Kam lëvizur nëpër zonat rreth fshatit tim në periudhë prej 3 ditësh apo maksimumi një javë dhe përsëri jam kthyer në shtëpi.

**Z. Hazir, ne e dimë se Qyshku ka
përjetuar një masakër të tmerrshme
dhe ju ditën kritike keni qenë në fshat.
A mund të na tregoni
si është zhvilluar e gjithë ngjarja?**

Po. Me fillimin e bombardimeve të NATO-së, në vitin 1999, u keqësua gjendja jo vetëm në fshatin tonë, por në gjithë territorin e Kosovës. Më nuk shtrohej pyetja se kush është, çfarë moshe ka. Apo a është pjesëtar i UÇK-së apo jo. Mjaftonte që ti të ishe shqiptar dhe ti duhej të vriteshe apo të burgoseshe.

Duke qenë se fshati ynë është shumë pranë qytetit dhe shumë pranë magjistrales Prishtinë-Pejë, forcat serbe kalonin andej gati çdo gjysmë ore. Madje disa herë kanë hyrë edhe në fshat, kanë djegur nga dy a tri shtëpi dhe janë tërhequr. Nëse nuk gaboj, rreth 15-20 prillit, nuk më kujtohet data e saktë, kanë ardhur policë dhe ushtarë serb nga pjesa e epërme e fshatit duke djegur shtëpi dhe duke shtënë me armë. U krijua një lloj paniku dhe fshatarët filluan të iknin.

Disa u orientuan në drejtim të fshatit Nabergjan, disa në drejtim të fshatrave të tjera dhe disa vendosën të qëndronin në shtëpitë tona. Nuk donim ta lëshonim vendin tonë, pavarësisht kërcënimeve dhe pasojave që mund t'i mbartnim. Mbase i dogjën disa shtëpi ata erdhën tek ne duke kërkuar që t'i dorëzonim armët dhe duke na keqtrajtuar fizikisht dhe psikikisht.

Na thonin keni kërkuar NATO-n dhe na shanin në

baza kombëtare etj. Në të njëjtën kohë ata vijonin me plaçkitjen e shtëpive. Unë i kam parë kur e kanë marrë veturën e Sylë Gashit, të cilin ne e thërrisnim Muharrem, nga lagjja e Hasan Beqë-ve, aty ku sot qëndron përmendorja e të vrarëve. Vlera e asaj veture në atë periudhë ishte rreth 20 000 marka. Pastaj i mblodhën 5-6 pleq dhe në bisedë e sipër i thanë se kur të vimë herën tjetër duam të na i dorëzoni armët, përndryshe do ju vrasim të gjithëve.

Që nga ajo ditë serbët kanë ardhur edhe disa herë të tjera, plaçkitnin shtëpitë afër rrugës dhe tërhiqeshin. Po ashtu i kanë bërë disa vrasje. Kanë marrë civilë nga fshatrat përreth dhe i kanë sjellë e i kanë ekzekutuar në një shtëpi afër rrugës në fshatin tonë. Pasi i kemi dëgjuar krismat kemi shkuar në vendin e ngjarjes dhe i kemi gjetur 4 kufoma, nuk i kam njohur me emra, por e di që kanë qenë të fshatrave përreth.

Çfarë keni bërë me ato kufoma që i keni gjetur në atë shtëpi?

Qëllimi ynë ka qenë t'i tërhiqim ato kufoma dhe kemi tentuar dy apo tre herë ta bënim një gjë të tillë, por kjo ishte e pamundur sepse ato gjatë gjithë kohës ishin nën vëzhgimin e tyre. Pas dy apo tre ditësh kanë ardhur dhe i kanë tërhequr kufomat, disa persona me mantel të bardhë, të cilët ishin nën përcjelljen e policisë dhe të ushtrisë dhe nuk e di se ku i kanë dërguar. Para datës 13 maj i kanë zhvendosur edhe banorët nga fshati "Katund i ri" dhe i kanë dërguar në drejtim të Gjakovës, për t'i shpënë në Shqipëri. Përsëri pas dy ditësh i kanë kthyer në Katund të ri dhe nuk i kanë lënë të kalojnë në Shqipëri.

Më 13 maj, diku rreth orës 6 të mbrëmjes, e kanë sjellur një burrë dhe një grua të moshës mbi 60 vjeçare, me mbiemrin Sharapolli, të cilët i kishin marrë nga banesat dhe i kanë ekzekutuar para shitores së Sali Cekut. Kur i kemi dëgjuar krismat kemi dalë dhe i kemi parë të vrarë, por nuk kemi guxuar t'i tërheqim në ato momente. I kemi lënë me qëllim që t'i tërhiqim të nesërmen në mëngjes, por të nesërmen në mëngjes kanë hyrë një numër shumë i madh i ushtrisë dhe i policisë në fshatin tonë, shumë më i madh se herën e parë. Kanë filluar të gjuajnë dhe të varin, thjesht nuk kanë pasur mëshirë ndaj askujt, qëllimi ka qenë të pastrohet terreni. Unë kur i kam dëgjuar krismat e para e kam kuptuar se situata ka ndryshuar dhe

është dukshëm më keq se herëve tjera. Fshatarët që ishin në fillim të fshatit kanë filluar të tërhiqen dhe të vijnë në drejtimin tonë. Unë në shtëpinë time kisha shumë të strehuar, afro 50-60 vetë. Kam hyrë dhe ju kam thënë se gjendja është përkeqësuar, përgatituni se nuk e dimë se çfarë do të bëhet, por mos u frikësoni, sepse atë që e ka shkruar Zoti do të bëhet. Pastaj unë kam dalë aty pranë rrugës dhe e kam shikuar gjendjen dhe kam parë se ata kanë hyrë në “pastrim të terrenit” sepse në çdo 5-6 metra, qëndronte nga një ushtar, të cilët vazhdimisht qëllonin me armë. Jam kthyer në shtëpi dhe i kam treguar disa fqinjëve aty afër dhe disa të rinjve të moshës 15-16 vjeçare, të cilët ishin të strehuar në fshatin tonë dhe pastaj janë larguar nga fshati.

Unë jam kthyer në familje dhe i kam treguar se unë do të qëndroj në shtëpi, pavarësisht çmimit me të cilin duhet ta paguajë këtë qëndrim. Megjithatë me insistimin e familjes kam pranuar që të largohemi pak nga shtëpitë, por shumë pak. Ndërkohë ne jemi rrethuar nga të gjitha anët. Ka qenë një numër shumë i madh i policëve dhe ushtarëve, si me makina ashtu edhe këmbësori dhe të cilët kanë filluar të vrasin dhe të djegin shtëpi.

Në shtëpinë e Brahim Dervishit, Brahim Dervish Gashit, e kanë ekzekutuar në praninë e familjes, Brahim Gashin, Metë Shalën dhe Rasim Ramën. Pastaj kanë ardhur më poshtë në drejtim të lagjes së Çekëve. Aty e kanë vrarë Hasan Çekun dhe Kadri Çekun.

Për Brahimin dhe dy të tjerët e kam kuptuar menjëherë se i kanë vrarë sepse ka ardhur djali i Brahimit dhe më ka treguar se ja kanë vrarë babën, kurse për Hasanin dhe Kadrinë e kam kuptuar më vonë. Në lagjen e Mushkolajve i kanë vrarë Haki Gashin dhe Selim Gashin. Atëherë kanë ardhur dhe na kanë rrethuar neve në lagjen e Hasan Beqëve. Aty ka pasur civilë nga të gjitha anët, ka pasur me mbiemër Çeku, pastaj Vokshian, me mbiemër Lushi, Këlmend, Gash. Ka pasur edhe të tjerë të strehuar, të moshave të ndryshme dhe aty ka filluar ajo ofensiva më e dhimbshme. Na kanë tubuar nga të gjitha anët me gra, burra dhe fëmijë, krejt sa ishim dhe na thanë të dilnim në rrugën kryesore, ku është tani përmendorja.

Na urdhëruan që të ndahemi burrat në njëren anë, kurse gratë dhe fëmijët në anën tjetër. Pastaj filluan të qëllonin me armë para këmbëve tona. Ishte një çmim që duhej ta paguanim dhe nuk kishim rrugëdalje tjetër. Pasi që na ndanë, filluan të na plaçkitnin për herën e parë. Kanë kërkuar nga të gjithë ne që çdo dokument dhe të gjitha të hollat që i kishim t'i nxirrnim përpara duke na kërcënuar se atij që do t'i gjindeshin të holla apo dokumente të padorëzuara do ta ekzekutonin para familjes dhe do ta ekzekutonin kryq në shtyllën elektrike që ishte aty pranë.

Të frikësuar nga ky kërcënim të gjithë kanë filluar t'i hedhin në tokë ato gjërat që i kishin nëpër xhepa, me cigare, me shkrepsa, çdo gjë që kishin. Më kujtohet se njëri nga ushtarët teksa po i kontrollonte

paketat e cigareve i gjeti në njëren nga to 500 marka dhe ka ardhur e na ka dhënë nga një cigare gjoja në shenjë respekti, pastaj i mori ato para dhe i futi në xhep fshehurazi nga ata të tjerët. Pastaj ka ardhur komandanti i tyre, të cilit i kanë treguar se ja këto janë ato që i kanë dorëzuar këta dhe ai i ka urdhëruar dy djem të rinj të moshës rreth 12 vjeçare që t'i mbledhin ato sende që ne i kishim gjuajtur. Tek po vazhdonin kërcënimet, komandanti e kapi një fëmijë për flokësh, i vendosi thikën në fyt dhe ju drejtua grave dhe vajzave që ishin aty të ndara në grup, se nëse nuk e dorëzoni arin dhe krejt çka keni me vlerë, do t'jua presim fëmijët dhe do t'ju djegim të gjithëve.

Nga frika e madhe, ato të gjitha i kanë gjuajtur gjërat me vlerë. Pastaj ata i kanë marrë ato gjërat me vlerë, kurse ato që nuk i janë dashur i kanë djegur. Pastaj kanë filluar t'i ndajnë në grupe. Gratë dhe fëmijët i kanë dërguar në dy oborre në lagjen e Hasan Beqëve. Nga ne burrat i kanë ndarë disa pleq të moshës mbi 75 vjeçare, kurse ne të tjerëve na kanë detyruar të hymë në një rrugë të lagjes aty dhe të mbështetemi për një mur, një pjesë tjetër e kanë futur në një oborr aty afër dhe pastaj kanë filluar keqtrajtimet, kryesisht psiqike.

Më kujtohet se familjet tona i kanë shpënë në një oborr, ku shtëpia ishte duke u djegur dhe nga flaka e madhe është këputur një tel i rrymës, i cili ka rënë poshtë dhe aty është krijuar një panik i madh në mesin e tyre.

Ndërkohë kanë ardhur tek ne dhe po i kërkonin disa emra, por pavarësisht se a ishin apo jo ata kishin vendosur që ta bënin atë të veten. E kanë marrë grupin e parë prej 12 apo 13 vetësh, nuk më kujtohet numri i saktë, dhe i kanë dërguar në drejtim të varrezave aty në shtëpinë e Muharrem Gashit. Unë i kam përcjellur me sy se nga po shkojnë, nuk më ka interesuar se çka po ndodh në mesin tonë, por i kam shikuar se nga po i dërgojnë ata. Kisha dëgjuar më parë në lajme, në radio dhe në televizor, se burrat po i ndajnë nga gratë dhe se burrat po i vrasin e gratë po i keqtrajtojnë. Kur e përjetova edhe vetë një gjë të tillë u binda se ata mund të kenë bërë edhe më keq se tek ne.

Teksa po i shikoja se ku po i dërgojnë e kam parë komandantin duke i sinjalizuar me duar se ata duhet të ekzekutohen. Grupi ka qenë nën përcjelljen e 6-7 ushtarëve dhe pas një periudhe prej afro 5 minutash, sepse ata duhet të ecnin në një largësi prej 200-300 metrash, i kam dëgjuar krismat e armëve. Kanë qenë krisma në një ambient të mbyllur dhe ishin tri breshëri të shtënash të gjata, të cilat mund të kenë zgjatur nga një ose një minutë e gjysmë. Pas pak janë dëgjuar edhe nja dy apo tri krisma dhe pas një periudhe prej 5 apo 10 minutash janë kthyer (ushtarët) dhe kanë thënë “u kry kjo punë”. Kam shikuar shtëpinë dhe e kam parë se është duke u djegur dhe e kam kuptuar se ata kanë qëndruar aty deri sa ka filluar të digjet shtëpia. Pastaj kanë filluar me sharje dhe fyerje, keni dashur NATO-n, ku e keni NATO-n, ku e keni Amerikën etj.

Kanë ardhur dhe e kanë kërkuar Çaush Lushin në grupin tonë sepse ai e kishte një veturë, të cilën nuk kishin arritur ta ndiznin pa kod. Çaushi ishte me djalë dhe kërkoi që ta merrte edhe djalin me vete nga frika që ta linte aty vetëm, por ata i thanë se djali duhet të rrijë këtu duke ju drejtuar në mënyrë ironike një ushtarit aty me fjalët “pazi na njega”, ndërsa ky ja ktheu me fjalët “hajt se unë e kryj këtë punë”. Pasi kanë shkuar ata, pas një periudhe prej 10-15 minutash, kanë ardhur te secili nga ne dhe na kanë kërkuar që t'i dorëzonim orët e dorës. Ato që ishin me vlerë i futnin nëpër xhepa, kurse ato që ishin pa vlerë i digjnin.

Aty e kam kuptuar se ata donin t'i zhduknin edhe gjurmët tona që të mos mund të identifikoheshim nëpërmjet orëve. Udhëheqësi i tyre ka urdhëruar që të na ndajnë në dy grupe dhe i ka thënë ushtarëve se këta duhet t'i dërgoni në këtë drejtim, kurse ata pak më poshtë. Grupin tonë, i cili përbëhej prej rreth 12 vetësh, na kanë çuar në drejtim të varrezave, por jo kah shtëpia e Muharremit, por në drejtimin e kundërt.

Aty ishte shtëpia e Sahit (Mehmet) Gashit, e cila tani nuk ekziston sepse e kanë hequr. Një shtëpi e vogël njëkatëshe, ndërsa ne ishim nën përcjelljen e 6-7 ushtarëve, të cilët më kujtohet se kishin në duar automatik dhe pushkë-mitraloz. Unë kam qenë i fundit në kolonë dhe në largësi prej 2-3 metrash kisha një ushtarë që në dorë po mbante një pushkë-mitraloz. Ata na kërcënonin se nëse dikush tenton që ta bëjë qoftë edhe më të voglin eksces, krejt familjen do t'ia

djegim këtu, para syve tuaj, kështu që ne vendosëm të mos ndërmerrnim asgjë. Të mos harroj se para se të na dërgonin atje, ata i kanë detyruar të gjitha pengjet që kishin vetura të shkonin dhe t'i sillnin veturat e tyre duke i kërcënuar se nëse nuk i sillni veturat për 10-15 minuta, do t'jua ekzekutojmë familjet. Pra, familjet ishin gjithnjë shkak i vetëm që ne na pengonte të merrnim edhe më të voglin veprim. Gjatë rrugës teksa po na dërgonin, ata diskutonin me njëri-tjetrin se a t'i vendosim në këtë shtëpi apo në atë tjetrën dhe më kujtohet teksa njëri nga ata tha jo këtu, sepse këtu i vjen era.

Aty e kam kuptuar se do të kalonim edhe më keq se sa e kisha menduar. Pastaj kemi shkuar dhe kemi hyrë në shtëpi. Kur kemi hyrë në korridor, njëri nga ushtarët e ka hapur derën e njëres dhomë dhe ka shikuar se mos është dikush brenda. Na urdhëruan me shumë gjakftohtësi që të hymë në atë dhomë dhe na thanë që të ulemi. Isha shumë gjakftohtë në ato momente, kam hyrë i fundit dhe nuk jam frikësuar aspak, kam menduar se Zoti e ka shkruar që të vdes në atë mënyrë dhe për këtë vend, prandaj nuk jam frikësuar aspak. Kur kam hyrë brenda jam vendosur në drejtim të derës.

Në anën e djathtë kanë qenë të ulur gjithë të tjerët, kurse në anën e majtë kam pasur vetëm një të ulur "cuc". Pastaj kanë hyrë brenda katër nga ata. Një në anën e majtë të derës, një në anën e djathtë dhe dy kanë qëndruar te dera dhe kanë filluar të gjuajnë

me pushkë-mitraloz. E kam parë se si nxirrnin flakë mitralozat në ato momente. Plumbat e parë kanë ardhur në drejtimin tim, por Zoti nuk e ka shkruar që të vdes dhe nuk më ka qëlluar asnjëri nga ata. Afërsisht tre breshëri të shtënash kanë ardhur në drejtim të trupave tanë. Kanë filluar te unë dhe kanë shkuar në qoshen tjetër, është kthyer tek unë dhe pastaj përsëri ka shkuar në qoshen tjetër, dhe përsëri është kthyer tek unë dhe asnjë plumb nuk më ka prekur mua. Arianin e kam pasë në anën e majtë, ndërsa në anën e djathtë e kam pasë edhe një njeri tjetër dhe që të dy janë rrëzuar.

Unë me sy gjysmë të mbyllur, ashtu e kam shikuar ngjarjen. Njëri nga ata ka hyrë në brendësi të dhomës sepse deri në ato momente po qëndronin vetëm pranë derës, e ka marrë një batanije, e ka vënë në qoshen e dhomës dhe e ka djegur. Pastaj varësisht se si dikënd e kishin kapur plumbat, dikush kishte mbetur i vdekur në vend e dikush jo, dhe kanë filluar pastaj jo nga dera, por nga brendësia e dhomës që të gjuajnë me breshëri të tjerë në drejtimin tonë. Plumbi i parë më ka goditur në këmbën e majtë, kurse nga të shtënat e dyta afërsisht 20 plumba më kanë depërtuar nëpër pantolla nga gjuri dhe poshtë.

Tri plagë tepër të rënda i kam marrë në këmbë. Janë ndërprerë të shtënat dhe kam dëgjuar vetëm erën e tymit. Ndërkohë dikush ka lëshuar një lloj psherëtime dhe për t'u siguruar se të gjithë janë të vdekur kanë filluar të qëllojnë me revole me vetëm

nga një plumb në secilin prej nesh. Unë duke e parë se ende isha në gjendje ta kontrolloja veten dhe lëvizjet e mija, vendosa që sapo të më afrohej t'i rrëmbeja revolen dhe të vetëmbrohesha. Ashtu kështu isha i vdekur.

Por dy apo tre persona para se të arrinte tek unë, nuk e di nëse atij i është harxhuar karikatori apo i është bërë boll, veç e di se i ka ndërprerë të shtënat dhe pastaj ka dalë nga dhoma. Pasi që kanë dalë ata nga dhoma kam filluar të mendoj se çfarë të veproj në vazhdim. Jam ngritur pak dhe kam shikuar se mos është dikush tjetër i gjallë. E kam prekur Arianin, që ishte në anën e majtë dhe e kam parë se është i vdekur, sikurse edhe personi tjetër në anën e djathtë. Kam tentuar të ngrihem në këmbë dhe ta ndalë batanijen, e cila po digjej në qoshe të dhomës, por në mënyrë instinktive më ka ardhur në mend që të shikoj nga dritarja se mos dikush është pranë, thjesht të di a janë ende këndeje apo kanë shkuar.

Kur kam shikuar nga dritarja kam parë 5-6 ushtarë dhe policë, të cilët po diskutonin se si të vepronin më tutje. Kam qenë në një distancë shumë të vogël me ta, na ndanin vetëm xhamat, por Zoti nuk ka dashur që të më vërenin. E kam parë se njëri është ndarë nga ata dhe i kam dëgjuar hapat tek po hynte në korridor, por nuk ka hyrë fare në dhomë. E ka futur vetëm dorën e djathtë të tijën dhe e ka gjuajtur një bocë me një lloj gazi, afërsisht sa një shishe e birrës. Ishte shumë e tmerrshme, mbase sekondat janë tepër të gjatë, dhe

unë jam gjendur në një situatë që nuk kam ditur a jam në shtëpi apo jam në tokë. Nuk kam parë asgjë, dhoma është mbushur me tym të zi dhe u bë terr fare. Ai tym filloi të më bllokonte frymëmarrjen, pastaj filloi të më ngrihej temperatura sepse filloi të më digjte trupi nga zjarri.

Nuk kam bërtitur dhe nuk kam lëshuar asnjë zë, njëherë kam hapur gojën që të bërtas, por nuk kam bërtitur. Zoti më ka ndihmuar dhe sot nuk arrij ta besoj se si kam mundur të qëndroj në atë gjendje. Në këtë gjendje nuk kam mundur të qëndroj më dhe kam vendosur të ngrihem dhe të dal jashtë, duke thënë se më mirë të vritem me plumb, se sa të digjesha i gjallë në dhomë.

Kur jam ngritur në këmbë e di që këmba e majtë më ka mbajtur, kurse këmba e djathtë ishte këputur dhe vetëm tërhiqej zvarrë. Jam ngritur dhe me ndihmën e një shporeti të druve, që e kisha aty në anën e djathtë e kam qitë hapin tjetër dhe jam mbajtur për derë. Kur kam dalë në korridor, kam filluar të kthjellohem pak, kam filluar të shoh sepse deri aty nuk shikoja asgjë, më ishte bllokuar frymëmarrja, kishte filluar të më humbiste vetëdija nga flaka dhe na gazi që e kishin gjuajtur brenda. Kur kam dalë në korridor, vetëm me këmbën e majtë kam arritur të eci deri në një metër e gjysëm, ku ishte dhoma tjetër. Sapo e kam hapur derën e asaj dhome dhe jam kthyer që ta mbylli e kam parë se si po dilte tym i verdhë nga dhoma ku kisha qenë. Ishte e tmerrshme, as benzina nuk digjej sikur ai gaz.

Kam parë se nuk kam mundësi të kthehem prapa dhe jam afruar pranë dritares. Nga aty i kam parë veturat e ushtrisë dhe të policisë, diku rreth 30 metra larg. Ajo dritarja ku unë isha, aty ku ishin numri më i madh i policëve dhe ushtarëve u mbulua nga një garazh i veturës aty pranë. Kurse grupi i parë i policëve dhe ushtarëve ishin të habitur sepse ata nuk e mendonin se dikush mund të ketë shpëtuar në atë shtëpi.

E kam hapur dritaren, ka qenë dy kapakëshe, e kam marrë këmbën e djathtë me dy duar dhe e kam vendosur në dritare sepse ka qenë e këputur, pastaj jam afruar dhe me trup jam hedhur nga dritarja në një lartësi prej një apo një metër e gjysëm. Nga vendi ku kam rënë deri në qoshe të shtëpisë ka qenë një distancë afër tre apo katër metra dhe e kam marrë këmbën e djathtë e kam vendosur mbi këmbën e majtë dhe jam tërhequr ashtu në pozitën ulur. Kur kam dalur në qoshen e shtëpisë, pra 3 metra nga dritarja ku isha, ka rënë kulmi i shtëpisë, e cila ishte duke u djegur.

Kam qëndruar aty për afro pesë apo gjashtë orë. Isha tepër i lodhur, kisha humbur gjak dhe po vazhdoja të humbisja. Duke ju falenderuar Zotit që po arrija t'i bëja ballë asaj situatë i kam dhënë vetes ndihmën e parë. Ndërkohë kam dëgjuar një zhurmë të fëmijëve, e cila ka zgjatur afro dy minuta dhe kam menduar se po i dhunojnë gratë në praninë e fëmijëve ose po i djegin të gjalla diku. Por nuk ka qenë asnjëra nga ato. Qesja që ishte mbi traktorët, të cilët ne i kishim bërë gati për t'u shpërngulur, kishte filluar të digjej dhe

fëmijët nga frika kishin bërtitur. Ndërkohë i kam dëgjuar tre të shtëna me breshëri, të cilat vinin nga ana e majtë e imja dhe më vonë e kam kuptuar se nga ato të shtëna ishte vrarë Çaush Lushi. E kishin ekzekutuar brenda në një ËC. Aty është gjetur i vrarë pas dy ditësh. Pas vrasjes së Çaushit më nuk kemi dëgjuar të shtëna, ata i kanë marrë veturat, kamionët dhe automjetet me të cilat ishin dhe janë tërhequr në drejtim të qytetit të Pejës.

Unë kam qëndruar i vetëm për një periudhë prej afro pesë apo gjashtë orësh. Pasi i kam dhënë ndihmën vetes, e kam lidhur këmbën e djathtë me një rryp të pantollave, me disa drunj dhe me një xhemper, kurse këmbën e majtë jam munduar ta lidhë me një thupër dhe s'kam mundur, por e kam marrë një gurë dhe e kam vendosur në plagën ku kisha gjakderdhje më të madhe, për ta ndaluar. Ndërkohë në rrugë e kam parë një serb të fshatit me emrin Vidoja, ishte vetë i treti.

Ata kishin të veshur uniformën e ushtrisë serbe dhe mbanin nga një flamur serb në dorë. Fillimisht kam menduar se janë kthyer përsëri ushtria, por pastaj e kam parë se është Vidoja me Vasën dhe një tjetër. Ata kanë shkuar deri te varrezat, më shumë nuk kam mundur t'i shoh se nga kanë shkuar. Kam filluar të tërhiqem nga pozita ku isha dhe një distancë prej 70-100 metrash e kam përshkuar për një periudhë prej një ore. Isha tejet i lodhur dhe kisha humbur tepër gjak. Pasi kam dalë në një livadh kam dëgjuar disa fëmijë duke luajtur, aty e kam kuptuar se familjet

kishin mbetur aty, sepse kisha frikë se mos i kanë dërguar në Shqipëri, në Serbi apo Zoti e di se ku. Nga aty kam filluar t'i thërras në emër disa kushërinj. Një grua e moshuar e një bashkëfshatarit tim, me emrin Gjejlani, ka dalur dhe e ka dëgjuar zërin tim, por dy apo tre herë ka dalur dhe është kthyer mbrapa. Pastaj unë e kam ngritur dorën dhe kam thirrur. Atëherë ajo më ka parë dhe ka ardhur aty pranë meje, por ishte e tmerruar nga gjendja në të cilën ndodhesha unë.

Më ka pyetur se çfarë të bëj, i kam thënë se nuk ke çfarë të më ndihmosh, vetëm se duhet ta thërrasësh dikënd tjetër dhe të më ndihmoni të tërhiqem. Tek po bisedoja me të e kam parë një karrocë të vogël aty në bahçe dhe i kam thënë që ta sjellë atë karrocë deri aty ku isha unë, nëse mundet dhe unë pastaj ngadalë do të hidhesha në të.

Gjejlani ka shkuar dhe e ka sjellë atë karrocë dhe unë i kam thënë, tani ti vetëm mbaje se unë do të hipi vetë në të. E ka mbajtur karrocën, gjersa unë kam hipur në të, por ajo pastaj nuk ka patur forcë ta ngrejë sepse goma e karrocës ishte e shfryrë. I kam thënë shko thirre dikënd nëse është dikush dhe ndihmomëni të tërhiqem, por kini kujdes mos po ju sheh dikush. Ndërkohë i kam parë edhe një herë ata tre serbët, të cilët nga varrezat kanë hyrë në thellësi të fshatit për të shikuar nëse i kishte mbijetuar ndokush ekzekutimit. Gjejlani ka shkuar dhe e ka thirrur një kunatë dhe kanë ardhur të dyja bashkë, më kanë tërhequr dhe më kanë dërguar në oborrin e shtëpisë së tyre.

Aty kanë filluar të më bënin pyetje për familjarët e tyre. Duke parë se në mesin e tyre kishte pleq, plaka, fëmijë, ishte një gjendje paniku dhe unë vendosa që të mos ju tregoja se të gjithë ishin të vdekur dhe i kam thënë se nuk di asgjë njëherë. Unë jam plagosur dhe ata nuk i kam parë më. Aty kam filluar përsëri t'i jap ndihmë vetes, kam kërkuar nga ata nëse dikush ka djathë të pakryposur dhe një vajzë nga lagjia e Hasan Beqëve ka thënë se më duket se ne kemi. Ka shkuar dhe ma ka sjellur djathin dhe disa pelena të papërdorura.

Në oborrin e asaj shtëpie kam qëndruar rreth 2 orë. Ndërkohë ka ardhur Pleurat Halilaj, i cili ishte nxënës i vitit të tretë të shkollës së mesme të mjekësisë, së bashku me Lola Alijajn dhe ata më kanë ndihmuar për t'i lidhur plagët.

Kur e kam lidhur këmbën e djathtë, jam qetësuar paksa, por kisha humbur tepër gjak dhe isha në gjendje të vështirë, saqë disa bashkëfshatarë që vinin të më bënin pyetje për të afërmit e tyre, i dëgjoja tek pëshpërisnin me fjalët: “mos e pyesni më se është duke dashur të japë shpirt”. Pastaj ka ardhur familja ime dhe më kanë parë në atë gjendje. I kam thënë se mos krijoni panik, unë nuk kam asgjë dhe se kjo është luftë.

Ata nuk kanë forcë të përballen me ushtri dhe vinë e hakmerren në civilë. Ato çaste kemi dëgjuar krisma të tjera që vinin nga drejtimi ku unë kisha qenë i vendosur. I kam kërkuar që të më largojnë nga aty se çfarëdo që të më ndodhë nuk doja të më ndodhte

para familjes sime. Më kanë larguar rreth 200-300 metra nga shtëpia, në një livadh shumë pranë rrugës së fshatit. I kam thënë mua më lini këtu dhe çfarëdo që të ndodhë tek ju, për mua mos u merakosni. Kanë filluar t'i largojnë nga shtëpitë e tyre dhe pastaj përsëri i kanë kthyer në shtëpi dhe i kanë thënë se nuk bën të largoheni.

Pas rreth 3 orësh, aty kah ora 6 apo 7 kanë ardhur disa bashkëfshatarë që të me tërheqin dhe kam kërkuar nga ata të më dërgojnë në shtëpinë time. Nga ajo ditë, pra ka qenë data 14 maj 1999, ditë e premte e deri në ardhjen e forcave të NATO-s, unë kam qëndruar në fshat. Natën, nga ora 8 deri në orën 5 të mëngjesit, e bëja në shtëpi, kurse ditën, në fund të livadhit tim. Në një periudhë prej afro gjashtë javësh kam mbijetuar në atë gjendje të vështirë, pa mjek, pa ilaçe, pa asgjë, përveç ndihmës që merrja nga bashkëfshatarët, për të cilën gjë unë i jam shumë mirënjohës. Dua ta veçoj këtu gruan e "Shaban Gashit", e cila më ka sjellur një shishe me jod dhe një qese të madhe me fasha. Jodi më ka ndihmuar shumë që të mos më prishen plagët.

Po ashtu Halil Komoni, një mjek i rrethit aty m'i ka sjellur disa ilaçe. Thjeshtë më kanë ndihmuar të gjithë me aq sa kanë pasur mundësi, por më së shumti më kanë ndihmuar, kuptohet përveç familjes sime, Pleurat Halili dhe Hole Aliaj, të cilëve unë i jam mirënjohës për tërë jetën. Kjo është afërsisht 70% nga rrëfimi im, sigurisht për ta treguar çdo detaj do duheshin orë të tëra.

A keni humbur dikënd nga familja në atë masakër?

Nga familja ime e ngushtë, falë Zotit nuk kam humbur askënd, por gjithsesi kam humbur shumë të afërm të tjerë, me të cilët unë jam rritur dhe i kam konsideruar si pjesë të familjes sime. Dua të them se unë sot e kam shumë të vështirë dhe se asnjëherë nuk do të kaloja me dëshirë nëpër ato vende ku kanë ndodhur ato ngjarje sepse ende i kam të freskëta ato kujtime të hidhura. Ka qenë e pabesueshme ajo që ka ndodhur, por ka qenë e vërtetë.

Çfarë ka ndodhur me ato kufoma?

Ato kufoma janë djegur të gjitha. Në shtëpinë e Muharrem Gashit janë djegur kufomat afro 80% të trupit, ndërsa në një tjetër shtëpi, e cila ka qenë ende e pandërtuar mirë, janë djegur kufomat në afro 50%, pra jo të tërat dhe ato kufoma kanë mundur të identifikohen. Kurse në shtëpinë ku kam qenë unë, kufomat janë identifikuar vetëm në bazë të unazave të kurrizit apo teshave të cilat i kanë zënë përfundi dhe në mungesë të ajrit, ato nuk janë djegur.

Z. Berisha a mund të na tregoni se si i kujtoni ju sot ato ngjarje, nëntë vite pas?

Si ngjarje të cilat nuk do t'i harroj kurrë. Kam dhënë shumë intervista për shumë gazeta, për shumë organizata dhe shpesh mundohem ta mbylli atë kapitull të jetës sime dhe të mos i kujtoj më, por ato janë ngjarje që nuk harrohen kurrë.

Si jetoni ju dhe familja juaj sot afro nëntë vite pas luftës?

Sa i përket jetës sime, dua të them se nga ana ekonomike jam në gjendje shumë të vështirë. Jetoj me bashkëshorten time, dy vajzat dhe një djalë. I vetmi burim i të ardhurave është një pension invalidor, në shumën prej 70 eurosh. Por duhet të jetohet dhe në shpresojmë në ditë më të mira...

4**UNË DUA TË DËGJOHEM!**

5

Bisedë me

R.K.

Ish - ushtar i UÇK-së dhe refugjat me familje në Shqipëri

Na tregoni përjetimet tuaja gjatë lëvizjeve ose ngjarjeve në prag të luftës në Kosovë?

Paraprakisht unë do doja t'i përmendja në mënyrë kronologjike disa pika, ndoshta themelore që i kanë prirë luftës dhe fillimit të luftës. Faktikisht, pas vitit '90, një periudhë pak më e shkurtër kohore para luftës dhe mbas largimit të punëtorëve në vitet '90, shumica e intelektualëve, mos të them të gjithë, e kanë ditur se me serbin duhet të ndahemi vetëm përmes grykës së pushkës. Këtë e kanë kuptuar më thellësisht shumica e intelektualëve, sidomos të burgosurit politik.

Kjo ndodhi, në vitin '97 paraqitet publikisht në skenë si Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kështu që në këtë drejtim edhe ne me disa shokë kemi dashur që të kyçemi në këtë organizatë çlirimtare dhe kemi marrë iniciativën, së bashku me Ibrahim Gashin dhe Sabri Krasniqin, që të kyçemi përmes disa burimeve që i kisha në shtabin lokal të Prizrenit. Atëherë shtabi ka qenë i vendosur në Jeshkovë.

Kemi marrë iniciativën në një mbremje, po më duket ka qenë data 30 maj dhe bashkë me veturën e Sabri Krasniqit, kemi shkuar në fshatin Billush. Kemi shkuar në shtabin lokal të Prizrenit, i cili ka qenë i vendosur në Jeshkovë. Aty jemi takuar me ish-komandantin e ndjerë, komandant Petrit Kodra, Remzi Ademaj përndyshe, dhe i kemi vënë kontaktet e para. Kemi biseduar përafërsisht një orë për të gjitha

lëvizjet e ardhshme dhe se me çfarë do të merremi. Pastaj në konsultime me Remzi Ademajn, kemi marrë përsipër që të formohet edhe këtu në komunën tonë të Sharrit, Dragashit, dhjetëshja e parë, njerëzit kontaktues, të cilët do të udhëheqin njerëz, të cilët do të shkojnë në Shqipëri, për çështje të armatimit dhe furnizimit me material ushtarak.

Pasi i kemi gjetur njerëzit, 10 kontaktues me kolegë me njerëz të besueshëm, atëherë na ka ardhur informacioni se një grup i madh duhet të shkojë në Shqipëri për armatim. Ka qenë e paraparë që të shkojnë 20 deri në 30 vetë prej dy regjioneve të komunës sonë, d.m.th, regjioni Brezne, Buqe, Pllavë dhe regjioni nga Opoja. Rreth 60 vetë dhe një grup i madh kanë ardhë prej rrethinës së Prizrenit e më gjerë, Drenicë e Dukagjin dhe secili prej nesh ka pasur për obligim t'i marrë tre pushkë me vete dhe municion.

Dy pushkë do t'i çonim në shtab dhe me nga një do të furnizoheshim ne. Erdhi informacioni se duhet të nisemi, data e saktë nuk më kujtohet, por më duket se ka qenë 15 qershori. Në mbrëmje kanë filluar njerëzit të vijnë dhe është dashur të nisemi në orën 10:30. Përmbi fshat ka qenë tubimi, siç i themi ne te vendi i ashtuquajtur "Ara e Nezirit". Gjatë grumbullimit të shokëve, disa grupe na kanë humbur duke ardhur prej poshtë, kështu që kemi qenë të detyruar që së bashku me shokët e tjerë t'i kërkojmë. Dikush e ka marrë vesh gabimisht, ka shkuar në fshatin Buqe (afër), gjoja se është në Brezne, e ka humbur rrugën

dhe atë natë ka dështuar plani. Të nesërmen i kemi konsoliduar rradhët, jemi grumbulluar komplet dhe kemi vazhduar në të njejtën kohë, në orën 10:30 jemi nisur për Shqipëri. Rrugës e sipër, përmbi fshatin Buqe ka qenë kolona diku mbi 200 njerëz, në shpat janë shkrepur disa raketa ndriçuese nga stacioni ushtarak, që ka qenë i vendosur te pishat, vendi i ashtuquajtur Dubrava dhe aty jemi vërejtur me siguri pjesa më e madhe e kolonës. Gjithnjë kemi diskutuar me shokë se a ka pasur tradhti apo spiunazh.

Sipas mendimit tim, absolutisht jo, nuk besoj se ka pasur ndonjë tradhëti. Faktikisht ushtria serbe e ka përcjellë në vazhdimësi terrenin, kanë qenë në dijeni se nga kjo pjesë ka lëvizje, njerëzit shkojnë për furnizime me armë, kështu që me siguri na kanë hetuar dhe kanë lajmëruar atje te pjesëtarët e kararubës serbe se ka lëvizje.

Dhe çfarë ndodhi? Kur arritëm te brezi kufitar e bëmë një pauzë. Ka qenë pauzë ndoshta jo e organizuar mirë bash te rrypi kufitar, te piramida 13. Në momentin kur e përfunduam pauzën janë dëgjuar shkrepjet e para të armëve nga ana e ushtrisë serbe. Atëherë është krijuar një panik ndërmjet shokëve dhe ka pasur edhe prej njerëzve tanë që kanë shkrepur, kanë gjuajtur me armë dhe jemi zmbropsur, grupe-grupe kur kemi arritur te vendi që i themi “Rrasët e Krypëve”. Aty ishte një hapësirë shumë e madhe, rrafshirë dhe kemi menduar se do ketë edhe të vvarë, të plagosur. Në realitet ka pasë të lënduar gjatë

përpjekjeve për t'u zbrapsur, për t'u ikur plumbave dhe kështu që tërë natën jemi ndarë nëpër grupe të vogla dhe jemi grumbulluar këtu në fshatin Brezne. I kemi sistemuar njerëzit nëpër shtëpi të ndryshme, ku kemi pasur besim.

Kur ka zbardhur drita, tërë ditën i kemi marrë grupe-grupe, si kanë qenë të ardhur i kemi dërguar nëpër vise të ndryshme të Prizrenit dhe ky plan ka dështuar. Ndërkohë kemi pasur iniciativë të deportojmë prapë, mirëpo pa sukses dhe kufiri u përforcua. Më 1 shtator, filloi invazioni apo sulmi ushtarak në Vvri, konkretisht në shtabin lokal të Prizrenit dhe kjo zgjati dy-tre ditë.

Me sa më kujtohet, aty shpartallohet përfundimisht shtabi lokal i Vrrinit dhe ndërprehet lidhja, faktikisht edhe kufiri bllokohet dhe pason pastaj viti '99. Pason largimi i popullsisë apo eksodi i gjithë trevave të Kosovës për në Shqipëri. E kemi përjetuar edhe ne këtë gjë, por me disa ndryshime. Më 31 janar të vitit 99, në orët e mbrëmjes, vjen urdhëri se duhet t'i lëshojmë edhe ne të gjitha vendbanimet, shtëpitë dhe të nisemi për në Shqipëri. Ne këtu me disa shokë kemi dashur të rrimë, mirëpo në momentin kur filloi të lëshohej fshati, atëherë në bisedë me shokët është dashur që edhe ne t'i bashkoheshim kolonës sepse do t'i përtërinim lidhjet në Shqipëri.

Me datën 17 prill u mblohdhëm së bashku me shokë dhe u kyçëm në rradhët e UÇK-së në qendrën stërvitore në Elshan. Harrova t'i përmendë disa fakte që kanë ndodhur para se të ndodhte eksodi, para largimit nga Kosova për në Shqipëri. Realisht kemi pasur edhe dy-tri ultimatumë nga policia serbe dhe ushtria që të largohet fshati dhe e tërë treva e Opojës dhe Sharrit. Ata nuk janë përfshirë, por ka qenë një propagandë e njerëzve që kanë qenë në strukturat e policisë.

Edhe pse ka ndodhur ultimatumi, juve nuk do t'ju ndodhë diçka e keqe, -ishin disa nga fjalët e tyre. Do të rrini përkundër të gjitha masave, jemi këtu bashkarisht e nuk do keni probleme, e kështu fjalë boshe. Vlen të përmendet një fakt, se me datën 20 mars më duket, ka pasur tërë natën të shtëna, kanë ardhur nga reparti ushtarak te pishat, vendi i ashtuquajtur Dubrava, me pretekst se grupe-grupe kanë dalur prej kufirit, prej Shqipërisë dhe njerëzit kanë qenë në alarm, në panik, do të thotë kanë qenë strehuar, dikush në katet e përdhësës, dikush në bodrum.

Kjo ka vazhduar deri në orët e hershme të mëngjesit. Ka pasur të shtëna sporadike, me armë të arsenalit të rëndë dhe të nesërmen nuk kemi mundur të marrim informata se a ka pasur luftime, a ka pasur të vrarë, a ka pasur të plagosur apo diçka tjetër.

A ka pasur të plagosur në fshat?

Jo nuk ka pasur të plagosur. Pastaj pasoi ajo beteja e një grupi, (se harrova ta them), i cili u stacionua në fshatin Buqe. Ka qenë një grup me rreth 50 vetë dhe kanë qenë të vendosur te disa shtëpi, buzë malit të fshatit Buqe.

A ka qenë ky grup i UÇK -së?

Po grup i UÇK-së. Çfarë ka ndodhur aty? U hetua se kishte pjesëtarë të UÇK-së në ato familje, nga policia serbe, me tradhëti apo pa tradhëti, nuk mund ta them dhe filloi beteja, e cila zgjati disa orë. Aty u vra një kapedan i policisë serbe, u vra në lule të ballit dhe u plagosën 4-5 vetë, pjesëtarë të UÇK-së, por ka pasur të plagosur edhe në rradhët e ushtrisë serbe. Ajo ka ndodhur, dikush thotë me tradhëti, dikush thotë e kanë pasur situatën nën vëzhgim.

Ka qenë interesant se disa pjesëtarë kanë qenë të humbur, të cilët faktikisht do t'i gjejmë më vonë edhe të vdekur duke menduar se kanë humbur ose janë strehuar diku. Rasti është për Nexhat Fanaj, për të cilin kemi hulumtuar plot 5 ditë, me rrëfimin e një bashkëluftëtari, se ai ka qenë i plagosur dhe e ka lënë shoku i vet përmbi liqen. Ai na ka specifikuar se nëpërmjet disa vizatimeve, i ka thënë unë jam i plagosur rëndë, ti shko e kërko ndihmë e mua do

të më gjesh këtu. Ai me ato sakrifica mbinjerëzore, prej atij vendit, ku e ka lënë ky shoku i vet i luftës, ka depërtuar shumë dhe pas 4-5 ditësh gjindet te vendi i ashtuquajtur “Lugu i Gjeraqinave”, siç e quajmë ne, aty ku e ka edhe sot përmendoren.

Pra, ka udhëtuar në një distancë prej 2-3 kilometrash duke bërë përpjekje dhe aty e ka gjetur vdekjen. Çfarë të theksoj tjetër? Pastaj kemi shkuar për në Shqipëri. Prej Shqipërisë së bashku me ata shokët që kemi qenë vazhdimisht në kontakt dhe me disa të tjerë i jemi bashkuar rradhëve të UÇK-së. Në realitet më herët ka qenë plani për t’u aktivizuar në Kalimash për disa ditë, më duket 10 ditë më herët. Mirëpo morëm informata se Kalimashi ishte i sulmuar me predha prej serbëve dhe konsiderohej si repart ushtarak jo i sigurt, kështu që më 17 prill, bashkë me shokët jemi bashkuar në repartin ushtarak në Elshan.

**Po gjatë rrugës për
në Shqipëri me çfarë automjeti
keni udhëtuar ju, familja, krejt fshati?
Si keni shkuar deri në Shqipëri?
A keni hasur në
vështirësi gjatë udhëtimit?**

Po, plot vështirësi. Një pjesë e familjes ka udhëtuar me një traktor të një mikut, ndërsa familja ime e ngushtë, merre me mend kanë udhëtuar me Lladën e vëllait, veturën e tipit Llada, ku kanë qenë të vendosur 11 vetë. Unë kam udhëtuar me traktor. Jemi nisur në orët e mbrëmjes 7:30, më kujtohet shumë mirë. Ka qenë një mot shumë i keq, mot me vranësira, një kohë shumë e keqe dhe jemi bllokuar andej nga Zhuri, kah fshati Shkozë. Kolona nuk ka lëvizur plot 10-12 orë. Të nesërmen, në orët e mesdites, në orën 11-12 ka filluar të lëvizë kolona pjesë-pjesë deri në kufi. Gjatë kolonës ka pasur keqtrajtime sa të duash, nga ana e policisë serbe dhe forcave ushtarake serbe.

Çfarë ka ndodhur? Në momente të caktuara ata janë ndalur tek filan familje dhe kanë lypur pare, zakonisht me kërcënime se do ta zbresim anëtarin e familjes, do ta marrim me vete e lloj-lloj provokimesh. Njerëzit janë detyruar të japin pare, dikush i ka dhënë 200, dikush 500 marka, për të shpëtuar nga kjo.

Rrugës për në Shqipëri, a keni parë edhe njerëz të tjerë, nga pjesë të tjera të Kosovës që kanë qenë viktime të atij eksodi?

Po, ka pasur plot njerëz nga treva të ndryshme të Kosovës, nga Rrafshi i Dukagjinit, Drenicës. Kanë qenë kryesisht anëtarë të familjeve të ndryshme, kryesisht gra dhe fëmijë të vegjël. Më kujtohet një rast, ka qenë një grua me 4 apo 5 fëmijë, e zbehtë në fytyrë.

Ka qenë më duket dita e dytë e Bajramit dhe tregonte se ka qenë 4-5 ditë pa hëngër e pa pirë, në mal dhe dalloheshin fytyrat e zverdhura të tyre. I kemi ndihmuar me çka kishim, biskota dhe gjëra ushqimore. Kanë qenë plot familje që kanë ardhur nga treva të ndryshme, jemi bashkuar me një kolonë për në Shqipëri. Në kufi, kanë qenë policët të cilët kontrollonin. Dikujt ia merrnin dokumentat dhe ia shkynin, dikujt ia gjuanin në shportë, vetëm sa e kalonim pjesën tjetër të kufirit. Aty mbasi e kemi kaluar kufirin, ushtria e Shqipërisë ka qenë në gjendje gatishmërie. Erdhën taksistat e tyre, me furgona, me vetura dhe e kanë ndihmuar popullin shumë. Prej aty, do të thotë prej kufirit në pjesën e Shqipërisë, i kanë marrë njerëzit grupe-grupe, dikush me kamion, dikush me furgon, dikush me mjetet e veta dhe kanë depërtuar deri në Kukës. Kur kemi mbërritur në Kukës, një pjesë e madhe e popullit, edhe unë me familjen time, jemi

vendosur në sallën e sportit të një shkolle fillore në Kukës dhe aty kemi kaluar natën. Të nesërmen dikush është sistemuar, kanë ardhur familjarë të Shqipërisë për t'i strehuar. Pjesa më e madhe e tyre kanë qenë në gatishmëri. Dikush ka pasur të njohur, dikush ka gjetur banesë ose shtëpi me qera, do të thotë njerëzit janë gjetur sipas momentit dhe kohës, sipas situatës e cila ia ka diktuar rrethanat.

Gjëja më e vështirë për ne që kemi qenë të vendosur në Kukës, ka qenë se a do të mundemi t'ia sigurojmë fëmijëve tanë gjërat elementare. Fëmijët ishin shumë të vegjël, mirëpo me angazhimin e të gjithëve është përmirësuar gjendja dhe atëherë e kemi marrë veten.

Ku jeni strehuar gjatë qëndrimit tuaj në Shqipëri, ju dhe familja juaj?

Për 3-4 ditë kemi qenë të vendosur në vetura, kemi pasur dy vetura. Ne meshkujt kemi fjetur nëpër traktora. Pastaj e kemi takuar Fehim Bashën, nga Kukësi, i cili na ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. E kemi marrë faktikisht punëtorinë e tij. Aty ku ka punuar ai ka pasë një dhomë të pashfrytëzuar. Ai është marrë me servisimin e elektromotorave dhe e kemi marrë atë dhomë, që ka qenë me dimensione, përafërisht si sallë, 7 me 4 metra katror. E kemi betonuar, i kemi vendosur pllaka, e kemi lyer me gëlqere.

Ai e ka vendosur një dritare, derën, në skaj ka qenë WC-ja. Aty kemi qëndruar me familjen afërsisht 3 muaj. Kemi qenë të vendosur 18 anëtarë, bashkë me vëllanë dhe në ato kushte kemi jetuar plot 3 muaj.

Çfarë kushtesh për jetesë keni pasur në atë banesë ku ka jetuar familja juaj?

Po, merrni parasysh çfarë kushtesh mund të jenë në një hapësirë diku 20-30 metra katror me 18-19 anëtarë. Mirëpo në rrethana të luftës kanë qenë kushte të mira, në krahasim me disa të tjerë që kanë pasë kushte edhe më të vështira. Faktikisht kemi pasë ujë, ka qenë një dhomë e mbuluar. Kryesisht kemi fjetë në ato thasët për fjetje, që na i kanë dhënë ndihma italianët dhe kemi qenë të rënditur si në një konzervë, si janë të rënditur peshqtë, në atë formë. Mirëpo kryesisht kemi kaluar mirë.

I falenderohemi këtij zotërisë, Fehmi Basha, i cili është munduar me të gjithë potencialin e vet dhe çfarë ka pasur, na e ka lënë në dispozicion, pa kurrëfarë shpagimi. Dikush, kuptohet, siç e përmenda më herët ka qenë në pozita më të këqija, kanë paguar, kanë qenë të vendosur nëpër pallate dhe e kanë paguar qeranë 100 ose 500 marka në atë kohë. Në krahasim me disa familje, kushtet tona kanë qenë relativisht të mira.

Si jeni furnizuar me gjëra ushqimore?

Ditët e para i kemi blerë ato të domosdoshmet, por pastaj nuk kanë munguar ndihmat. Kemi pasur ndihma prej shoqatave të ndryshme, prej shtetit. Faktikisht populli në përgjithësi, sidomos në Kukës, aty ku ka qenë edhe familja ime, ka qenë i furnizuar me gjërat elementare për jetesë. Normalisht, nuk ka pasur diçka ekstra, por në rrethana të luftës ka qenë mirë, sidomos për fëmijët nuk ka pasur ndonjë problem. Stresi, paniku dhe pasiguria patjetër kanë qenë gjithnjë evidente.

A keni pasur ndonjë anëtar të familjes së gjerë, që ka banuar në kamp të refugjatëve?

Po, e kam pasë motrën me familjen e vet të ngushtë dhe me kunatin, vëllanë, kanë qenë të vendosur në kampin arab. Përpara kanë qenë disa ditë të vendosur në fshatin Shtiq (fshat afër Kukësit).

Me sa më kujtohet për disa ditë, pastaj kanë kaluar në kampin arab. Aty kanë pasë disa gjëra elementare për jetesë, nuk kanë qenë shumë të dobëta, por e kanë pasë problemin e ujit të pijes dhe për pastrim. Për këtë e kanë pasënjësakrificëgoxhatëmadhe, rrethpastrimit, higjienës. Sa kanë qëndruar aty, nuk më kujtohet. Mirëpo përveç asaj ka pasë edhe njerëz të tjerë nepër kampe.

Na tregoni përjetimet tuaja. Si i jeni bashkuar rradhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

Po siç e përmenda më herët, pasi jemi sistemuar në vende të ndryshme në Kukës, atëherë i kemi vënë kontaktet me ata shokët që kemi qenë në kontakt vazhdimisht në Kosovë. Momentet e para të kontaktimeve, faktikisht i kemi bërë rreth xhamisë së Kukësit. Te xhamia e kemi pasë vendtakimin, një xhami e madhe, e cila ka qenë përballë shkollës fillore dhe aty fillimisht jemi regjistruar në disa lista, që kanë qenë lista të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për regjistrim dhe anëtarësim. Kjo ka qenë disa ditë me rradhë dhe në ato lista që kemi qenë të regjistruar nuk kanë marrë pjesë të gjithë.

Një pjesë e tyre, për shkaqe të tyre personale nuk i janë bashkuar rradhëve të Ushtrisë Çlirimtare dhe thashë më herët se ka qenë plani që t'i bashkohemi qendrës stërvitore në Kalimash. Mirëpo atë ditë kur jemi përgatitur për të shkuar, ka ardhur lajmi se ky repart ushtarak ka qenë i sulmuar dhe është shpallur si vend jo i sigurt dhe është transferuar ai regjiment që ka qenë i vendosur aty. Më 17 prill, 10 ditë më vonë, kemi qenë 53 shokë dhe jemi nisur prej Kukësit, prej qendrës ushtarake që ka qenë në Kukës, ku ka qenë i vendosur një lloj shtabi dhe me autobus kemi shkuar për në fshatin Elshan, ku ka qenë reparti ushtarak i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në bisedë me

shokë mua ma kanë dhënë detyrën për të udhëhequr grupin. Kanë qenë momente shumë të vështira, kemi mbërritur diku rreth orës 9 në mbrëmje.

Ka qenë errësirë dhe kemi kontaktuar me njerëz të logjistikës, për vendosje nëpër tenda. Me një shok, Bedri Gashin, i kemi furnizuar shokët me batanije, i kemi shpërndarë nëpër tenda dhe në fund kemi ngelur vetë pa batanije. Ditët e para, ngase ishte mot shumë i keq, mot me shi, pothuajse shumica e shokëve të grupit jemi ftohur, kemi pasur probleme me organet e frymëmarrjes. Aty kemi kontaktuar me komandantin, i cili do të jetë më vonë komandant i brigadës, Bilall Syla, epror i ish-Jugosllavisë, në akademinë ushtarake. Në kontaktet e para e kemi parë që është një njeri profesional dhe njeri shumë i mirë. I kemi konsoliduar rradhët, jemi formuar në disa kompani, ku përfundimisht u formuan dy brigada, po më duket dhe mbas një kohe jemi nisur për të shkuar në qendrën stërvitore të Ferkemit, përmbi Tiranë.

Nuk më kujtohet data, por diku nga fillimi i Majit më duket. Ajo ka qenë qendër stërvitore e kadetëve të Shqipërisë dhe atje kemi qëndruar 2 apo 3 javë, nuk më kujtohet saktësisht. Në realitet aty kanë qenë të vendosura dy brigada, duke marrë parasysh edhe brigadën tonë. Brigada e udhëhequr nga komandanti Bilall Syla dhe një brigadë, regjiment të cilin e kemi gjetur aty. Ndërkohë kanë ardhur njerëz të tjerë, të cilët i ka udhëhequr një komandant, me pseudonimin Armando. Pas një kohe, dy brigada janë shkrirë në

një regjiment, në një brigadë. Ka pasur disa probleme rreth këtij Armandos, nuk e di ai është zhdukur pas disa ditësh nuk e kemi parë aty dhe kështu që komplet njësitë e ushtrisë çlirimtare të shkrira në një brigadë i ka udhëhequr Bilall Syla. Dhe çfarë ka ndodhur pastaj? Brigada ka qenë e përbërë prej tre batalionesh.

Dy batalione, kanë udhëtuar për në Cahan, ka qenë një forcë ndihmëse e njerëzve në vijë të frontit. Ndërsa batalioni ynë, aty kam udhëtuar edhe unë me ta, kemi shkuar në Koshare, d.m.th., ka qenë një shpërndarje nëpër vijën kufitare. Duhet të theksohet në këtë rast se operacioni ynë është quajtur operacioni “Shigjeta”. Faktikisht jemi shpërndarë në dy drejtime, që të ndihmohet pika kufitare, prej Cahanit deri në Koshare, se edhe luftimet, pas intervenimit të Nato-s, janë zhvilluar kryesisht në kufij. Vlen të përmendet se në Koshare, mbi 500 ushtarë janë vrarë, aty ku ka shpërthyer kufiri, ku është marrë ajo pjesë e Koshares dhe serbët janë detyruar të tërhiqen prej Karakollit deri në një fshat, nuk e di, Brovina më duket se është thirrur ai vend.

Faktikisht jemi ndarë. Brigada nuk ka qenë për t’u ndarë, pasi direktivat kanë qenë për të shkuar bashkarisht, mirëpo në momentin kur jemi nisur për në vijë të frontit, ka ardhur informacioni se duhet të intervenohet në Pashtrik, konkretisht në Cahan ka qenë vendtakimi dhe në Koshare. Në Koshare, konkretisht, batalioni i tretë, kam qenë edhe unë me ta, ka qenë si forcë ndihmëse te vendi i ashtuquajtur

“Rrasa e Zogut”. Kanë vepruar dy kompani, po më duket, d.m.th, aty janë zhvilluar luftimet. Kështu që jemi nisur, do të thotë i kemi bërë dy ditë udhëtim, deri në Padesh.

Aty jemi stacionuar dhe i kemi pritur urdhërat e mëtejshëm. Para se të mbërrinim në Padesh, desha të theksoj edhe një udhëtim. Kemi qenë të vendosur në fshatin Sopot, dy ditë edhe aty ka pasur granatime, rreth orës 4-5, por kanë qenë më larg prej nesh, do të thotë ka qenë ai regjioni i Bajram Currit, ku janë gjuajtur disa predha prej artilerisë serbe dhe në momentin kur e kemi hetuar se po ndodhë diçka, atëherë kanë dalë afër 400 vetë të batalionit, e nuk e kemi ditur se çka po ndodhë në momentin e caktuar, se nga po vijnë këto predha. Atëherë është konstatuar prej komandës, se është gjuajtur prej serbëve kah pjesa e Kosovës.

Aty na është bashkangjitur Gëzim Osdreni, me nofkën Murat Plakori. Ka qenë edhe Naim Maloku dhe bashkarisht kemi vazhduar rrugën deri në Padesh. Në Padesh, pas dy ditësh na ka grumbulluar të gjithëve Gëzim Osdreni, i komandës së batalionit, në një vend pak më larg ushtrisë dhe na ka treguar që të nesërmen, nuk e di të nesërmen apo pas dy ditësh, se do të depërtojmë bashkarisht te “Rrasa e Zogut”, batalioni ynë dhe dy-tre kompani që kanë qenë të vendosura nëpër pika, për ta thyer atë pikë e cila ka qenë e pamarrur, sepse Kosharja ka qenë Vrojtore 327. Kanë qenë të marra nga Ushtria Çlirimtare, ka qenë

pika më kritike dhe betejat që janë zhvilluar kanë qenë te “Rrasa e Zogut” dhe ne si përforsim është dashur t’i sulmojmë për të depërtuar brenda te ajo pjesë e Koshares.

Gëzim Osdreni na tha se të gjithë çka kemi pasur minahedhës të kalibrit 82 mm dhe 120 mm nuk duhet t’i marrim me vete se nuk janë efikase, por vetëm minahedhësit 60 mm dhe normal armatimi personal i këmbëtorisë dhe do të sulmojmë. Ato kanë qenë momente të frikës dhe të konsolidimit të rradhëve. Mirëpo kjo ka ndodhur diku më 9-10 qershor. Më 12 qershor u nënshkrua marrëveshja e Kumanovës, e ashtuquajtura marrëveshje tekniko-ushtarake, në mes palës serbe dhe forcave të Nato-s, e zyrtarisht përfundoi lufta.

Zyrtarisht po, por jo edhe praktikisht. Përparësia jonë ka qenë e batalionit, se komandant Gëzim Osdreni na thoshte se do të ketë viktima. Viktima do të ketë gjatë deportimit, por me atë strategji, me atë plan operativ që ne e kemi përpiluar, do të mundohemi që të ketë sa më pak viktima. Kjo nuk ndodhi faktikisht, për të mirën tonë, të ushtrisë dhe thashë më herët, zyrtarisht përfundoi lufta, mirëpo pas nënshkrimit të marrëveshjes ka pasur granatime, do të thotë prej asaj pike forcat serbe janë tërhequr në fshatin Brovinë, ku e kanë pasur të vendosur artilerinë dhe në një moment më 13-14 qershor, i kanë gjuajtur lokalet e shtabit të vendosura në Koshare. Aty pësuan 4 ushtarë.

Njëri pësoi tragjikisht, njëri u lëndua në fytyrë dhe dy të tjerë morën plagë të lehta. Çfarë është për t'u rrëfyer është shumë interesante se gjatë kontakteve me teknikë që kanë qenë në vijën e frontit, tregonin se situata ishte shumë alarmante.. Kur binte granata në ato vende, në ato pika ku kanë qenë të vendosur ushtarët, ka pasur momente kur i ka rënë para këmbëve ushtarit granata, edhe e ka ndarë në një farë forme përgjysme.

Ai ka qenë i gjallë, tregonin e thonin se e shihnim shokun si po jep shpirt dhe nuk ishim në gjendje t'i ndihmonim. Ato momente kanë qenë shumë rrënjëdhënëse dhe pastaj u nënshkrua marrëveshja. Pas dy-tre ditësh e filluam marshin për në Kosovë, e një pjesë e ushtrisë u vendos në Junik. Një pjesë tjetër e ushtrisë, batalioni ynë u vendos në Smolicë, te Reka e Keqe.

Gjatë rrugës për në Kosovë, për në Smolicë kemi parë skena shumë rrënjëdhënëse. Ka pasur bagëti të prera në mënyrë shumë të egër, demolime të shtëpive, sidomos fshati Smolicë nuk ka pasur shtëpi e cila ka qenë e lënë anash nga dëmtimet. Gërmadhat kanë qenë si nëpër ato filmat horror. Kur kemi hyrë ne, ka qenë e vendosur vetëm ushtria, nuk ka pasur civil, kanë qenë ende pa u kthyer.

Nuk kemi guxuar ta përdorim ujin, edhe pse ka pasur pusa të bollshëm, gati secila shtëpi ka pasur pus, mirëpo nga frika se mos janë të helmuar nga forcat serbe nuk kemi guxuar të pijmë ujë.

Dhe çfarë ndodhi pastaj? E gjetëm një burim mbas dy-tre ditësh, në periferi të Smolicës dhe merreni me mend, sa kënaqësi ka qenë me pi ujë pas dy-tre ditësh dhe i kemi mbushur pajisjet për ujë. Kanë qenë skena shumë trishtuese. Atëherë, grupe-grupe i kemi vizituar fshatrat e Smolicës dhe të Rekës së Keqe në përgjithësi, d.m.th., shtëpitë e boshatisura, të demoluara, të thyera, i shihnim ato gjurmë të predhave, plumbave të djegur. Ka qenë një situatë shumë e vështirë për ne. Aty kemi qëndruar dy javë, pastaj jemi shpërndarë, secili nëpër regjionin e vet.

Gjatë kohës sa keni qenë ushtarë i UÇK-së a keni pasur kontakte me familjen tuaj?

Gjatë kohës kur kam qenë pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare, gjersa kemi qenë në qendren stërvitore në Elshan kemi pasur shumë pak vizita, që kur kemi shkuar në qendren stërvitore në Ferkem, në Tiranë edhe deri kur kemi shkuar në vijë të frontit, nuk kemi pasë kurrfarë kontakti, vetëm çfarë kemi dëgjuar prej shokëve ose prej informacioneve të ndryshme që ka pësuar ndonjë shoku ynë që është plagosur. Kështu që me familjen nuk kemi pasur kurrfarë kontakti, deri sa kemi ardhur në shtëpi.

A keni pasur ndonjë anëtar të familjes suaj, që ka qenë pjesëtari UÇK-së dhe ka pësuar ndonjë lëndim?

Po e kam pasë edhe djalin e vëllait, Ardian Krasniqin, i cili është plagosur në Pashtrik. Ka qenë me batalionin e Shemsi Iliazit dhe unë kam dëgjuar që është i plagosur, por nuk e dija konkretisht a është i plagosur, apo ka ndonjë pasojë pak më të rëndë. Kur kemi ardhur, siç e përmenda më herët, prej qendrës stërvitore në Ferkem, jemi nisur për në Koshare. Aty vetëm e kemi bërë një pauzë dhe jemi kthyer në Elshan. Në Elshan ka qenë i vendosur spitali ushtarak.

Një mjek më tregoi se djali i vëllait është plagosur lehtë. Ato kanë qenë momente shumë rrënqethëse se nuk e dija se a ishte i vërtetë informacioni që na vinte, se kur dëgjonim se është plagosur filani ose dikush që e njihja, në realitet ai kishte pësuar vdekjen. Kështu që me atë revoltë nuk kemi pasë kohë të shohim se çfarë është konkretisht dhe kemi vazhduar për Koshare. Ndërkohë unë mora vesh se ai ishte i plagosur në shpatull, i kishte hyrë një copë e granatës, pa rrezik për jetën. Siç thashë më herët, kemi qëndruar në fshatin Smolicë për dy javë dhe atëherë jemi shpërndarë për në shtëpi.

Kur jeni kthyer në shtëpi si e keni gjetur gjendjen?

Kur jemi kthyer në shtëpi, shtëpitë nuk kanë qenë të djegura në fshatin tonë, por ka qenë një pamje trishtuese sepse shtëpitë kanë qenë të demoluara, të plaçkitura, ka qenë një situatë kaotike. Teshat, mobiljet, pajisjet në shtëpi kanë qenë të përziara në njëfarë mënyre, janë dërguar në shkollën fillore, në shkollën e Llapushnikut ose në disa shtëpi. Në fshatin tonë kanë qenë të vendosur ushtria serbe, së paku këtë informacion e kemi pasur. Ushtria dhe policia serbe kanë qëndruar dhe për këtë nuk kanë pasur kohë për ta djegur fshatin, sipas të gjitha gjasave, kështu ka qenë e vërteta.

Mirëpo, me një qëllim të caktuar teshat kanë qenë të përziara në përgjithësi, nëpër shtëpi të ndryshme, ndoshta kanë menduar se pasi të terhiqen policia dhe ushtria serbe do të ndodhë ndonjë kacafytje mes banorëve të fshatit për hir të orendive të ndryshme, paisjeve etj. Po kjo gjë nuk ka ndodhur, me kohën njerëzit janë qetësuar, janë rehabilituar, i kanë rregulluar sa për fillim shtëpitë, duke i hulumtuar sendet e humbura dhe me kohën ka filluar jeta.

6

Bisedë me

Xh.V.

Dëshmitar

...do të thotë ne jemi larguar prej shtëpive disa herë, se kemi pasur rrethime të ashpra prej serbve. Më 28 shkurt të 2008-ës kur është rrethuar Qerezi dhe Likoshani, ju e dini se aty kanë bërë masakra, jemi detyruar të largohemi edhe prej shtëpive, d.m.th., më 5 mars '98 kanë ardhur forca dhe e kanë rrethuar lagjen e Jasharve, Polacin, Prekazin në përgjithësi. Lagjia e Polacit ka qenë e rrethuar dhe është dashur t'i largojnë familjet. Te Jasharët është bërë masakër, kanë vrarë gra dhe fëmijë. Ne jemi detyruar të ikim dhe t'i lëshojmë shtëpitë. Në fillim të marsit të '99-ës kanë ardhur për herë të fundit forcat paramilitare ushtarake: tanke, topa në fabrikën e municionit dhe janë përqendruar dhe kanë nisur t'i gjuajnë Polacin, Prekazin dhe fshatrat përreth.

Ku keni shkuar ju baci Xh.V. ?

Unë me familje, por edhe të gjitha familjet janë detyruar t'i lëshojnë shtëpitë. Ne kemi shkuar në Drenas dhe aty kemi ndenjtur deri në fund të marsit.

A keni pasur ku të rrini?

Nëpër shtëpia private ka pasur shumë të përqendruar, familjarë pothuajse 12 mijë vetëm të jashtëm që kanë qenë jashtë atij fshatit. Ka pasur prej fshatrave Verbovc, Prekaz, Polac, Vranasellë. Unë me familjen kam qëndruar në shtëpi private deri më 30 mars. Më 1 prill '99 jam detyruar të largohem edhe prej aty se erdhën forcat serbe. Ata hinin nëpër shtëpi i merrnin traktorat, veturat dhe çfarë gjenin që nuk ishin të atij vendi, i gënjenin, i vranin.

Grave ja u merrnin arin, burrave paret kështu që u detyrova të largohem edhe nga aty dhe familjen ta çoj në fshatin Verbovc. Aty kam qëndruar deri më 7 prill. Po atë ditë është marrë një ofensivë në fshatin Verbovc dhe i kanë marrë familjarët që ishin gra, pleq, fëmijë dhe i kanë nxjerrë përpara. Ne ishim të fshehur nëpër male. Më kujtohet një rast kur e vranë 75 vjeçarin, Shemsi Regjepin, të fshatit Verbovc.

Në prani të familjarëve?

Po, në prani të familjarëve. Prej asaj ofensive disa shpëtuan dhe disa u vranë. Unë personalisht shpëtova, gratë dhe fëmijët i morën dhe i çuan në shtëpi private edhe aty i mbajtën dy ditë. Pastaj i kthyen dhe i lejuan të shkojnë përsëri në ato shtëpia ku ishin duke ndenjur. Edhe pse ato i kishin djegur, u detyruam të ktheheshim dhe të vendosnim qese nëpër dritare. Në këtë strehim ndenjëm deri më 29 prill.

Si keni mbijetuar baci Xh.V. gjatë kësaj kohe kur keni pasur kushte shumë të vështira dhe vendet jua kanë djegur. Si mbijetuat aty, a ju ndihmoi dikush me ushqim ose me veshmbathje?

Na kanë ndihmuar me veshmbathje dhe ushtria çlirimtare janë interesuar dhe kanë gjetur miell. Ata janë angazhuar t'na ndihmojnë sa kanë pasur mundësi, por kemi pasë problem për ushqime, pije dhe bukë, megjithatë ia kemi dalur mbanë. Kështu që më 29 prill 1999 NATO-ja i ra Feronikelit siç e dimë dhe më 30 prill diku në orën katër të mëngjesit e kishin rrethuar Polacin deri në Qyrez dhe në Drenas. Në Gllabar, Likoshan dhe fshatrat përreth ishin rreth 12 mijë banorë të stacionuar që kishin

ardhur prej fshatrave të tjera. Të gjithë ata mbasi i morën në mëngjes dhe i çuan në Drenas, i qitën në livadh dhe i morën meshkujt. Meshkujt dhe të rinjtë i larguan nga familjarët dhe i çuan në Drenas.

Disa i vranë kurse neve na zunë në male. Rreth orës 1 të ditës na zunë nëpër male, ishim afërsisht 50 vetë. Ishin edhe disa të mitur, fotografitë e të cilëve i kam aty. Ishte edhe djali im, Shyqyriu, po ashtu Betim Prokshi, Bekimi, Shpëtimi, të cilët ishin nën moshën 18 vjeçare. Bekimi dhe Shyqyriu ishin 13 vjeçarë. Ushtria dhe policia serbe na zunë, na morën dhe na çuan në një lëndinë, na zhveshën çfarë kishim veshur dhe na lanë vetëm me xhempera dhe këmisha.

Na rrahën me shkopinj të drurit dhe na i hoqën unazat, paret dhe çfarë kishim. Cigaret na i shkelën dhe na torturuan. Na shanin dhe na thonin ku e kini NATO-n, duke na provokuar vazhdimisht. Na dërguan në një lëndinë tjetër dhe aty e sollën Haki Prokshin. Ai ishte i plagosur në këmbë dhe e sollën të shtrirë, pasi aty na sillnin të shtrirë. Dy metra përtej meje e mbytën me shkopinj të drurit dhe në fund ia dhanë edhe ballit.

E mbytën dhe e lanë aty. Këta të tre i kisha me vete, se sa për vete nuk më vinte edhe aq rëndë, edhe me na djegë e me na ba gjithçka. Atëherë kanë ardhur dy aviona të NATO-s dhe janë sjellur mbi ne. Ata nuk gjuanin. I lutesha Zotit, edhe pse më dhimbseshin shumë të rinjtë, po edhe ata ishin shumë e thoja me vete le të na e lëshojnë një bombë dhe të na djegin të

gjithëve, edhe ata edhe ne. E lidhën Ismet Prokshin për tank me zinxhir. Një epror ushtarak i tyre urdhëroi që tanku të ndizet dhe t'i shkelë të gjithë ata që janë të shtrirë.

Ne ishim të shtrirë dhe eprori tjetër tha jo jo me i shkelë, por ndize tankun dhe ngrije topin përpjetë dhe të na shohin NATO-ja se çfarë po i bëjmë në shqiptarëve. Ato e dinin që kishte shumë civilë, ndoshta edhe për këtë, ngase e dinin se ata nuk gjuajnë, donin të bënin lloj-lloj provokimesh.

Atëherë kanë kaluar avionat dhe Ismet Prokshin e kanë vrazë dhe e kanë qitur mbi tank. Ashtu të lidhur e kanë vendosur mbi tank. Neve na nisën për në Qyrez ashtu të rrahur, të rraskapitur dhe të uritur. Me ne ishte Bajram Rukiqi, i cili e kishte djalin e mitur. Ai ishte i lodhur, i rrahur dhe një epror na thoshte mbajeni për krahu dhe ndihmojeni pak. Na detyronte që ta mbanim për krahu herë njeri dhe herë tjetri, derisa dikur na tha lëshojeni.

E kemi lëshuar dhe na është afruar një kriminel, një ushtarë dhe e ka therë me thikë në dorë. Ne kemi menduar se ai ka vdekur, por ai sot është gjallë. Na nisën në drejtim të Qyrezit me duart e lidhura mbrapa. Djali im ishte përpara dhe më tha se ishte lodhur dhe një epror që ishte mbas nesh, ndoshta e dinte gjuhën shqipe, i tha që t'i ulte duart. Më vonë na tha edhe neve që t'i ulim duart. Rrugës e pashë një shtëpi private, disa gra dhe vajza i kishin marrë dhe përqafoheshin me to, i kishin bërë për vete me dhunë.

Ato janë gjetur në pus, dihet që janë vjerrë dhe kanë përfunduar në pus. Na çuan te ato shtëpitë private ku kishte pasur armatim, mund të them të përsosur, nëpër traktora të fshehur prej NATO-s, të mbuluara me tapeta.

Në qese kishte pasur topa prej atyre që janë me 12 copa. Armatimi më i përsosur ishte nën mbulojën e Ibrahim Ajetit. Aty na ndalën dhe fëmijët thanë se kemi etje, na sollën ujë dhe na dërguan për në xhami të Qyrezit. Grupi i parë ishin rreth 70 vetë dhe po shkonin për në xhami të Qyrezit. Aty ishte një epror ushtarak, komandant i thonin.

Kjo është shtëpia e Zotit, -tha ai dhe asnjë mos t'i kryejë nevojat në xhami. I ndau dy vetë, njëri i Qyrezit dhe tjetri më duket i Vranasellës. Njërit i tha, t'i numërojë sa njerëz vijnë në xhami dhe tjetrit të mbajë ujë. Nuk vonoi shumë dhe aty nga ora 5 në mbrëmje i sollën edhe një grup që e kishin zënë. Numrin e saktë nuk e di, diku rreth 150 vetë sa kemi dëgjuar nga ai që i numëronte. Ishin 210 në xhami, 35 të mitur, prej moshës 18, po ashtu kishte edhe 22 vjeçarë, prapë sipas atij që i numëronte. Kur e sollën grupin e dytë ishin edhe dy djemtë e Agush Qorrit, të cilët i zhveshën në oborr.

Agushi është ndonjë i afërmi yt?

Jo, ai ishte i Drenasit. I sollën dhe i zhveshën vetëm në brekë. I dëgjoja prej xhamisë përjashta që i thonin: uluni, çohuni nëpër llaç dhe i rrihnin. Aty para xhamisë ishte një batak e në këtë batak i kanë detyruar këta të dy të ulen dhe të çohen dhe i rrihnin. Kur erdhën ishin krejt me llaç, i futën brenda dhe jemi munduar dikush t'ia japë një palë trenerka, dikush që i kishte dy palë maica etj.

Atë natë po i njëjti komandant që na kishte thënë, kjo është shtëpia e Zotit, erdhi dhe tha se asnjë nuk bën të dalë përjashta se xhamia është e minuar përreth dhe ai që del do të bjerë në mina. Atëherë i ndërroi fjalët dhe tha këtu kryjini nevojat krejt se nuk është më as për xhami as për kurgja. Unë krejt kohës e kisha mendjen te këta të rinjtë se si t'i shpëtoja. Shikova shtëpitë që ishin përreth xhamisë dhe pashë snajperista. Mendoja si t'i iknim snajperistave se po të dilnim mund të na vrisnin.

Diku nga ora 10 e natës apo 11, se nuk kishim orë, se orët dhe krejt gjërat tjera na i kishin hequr, kanë dalur ushtria që ishin me neve në xhami dhe i lanë aty dy përgjegjës të grupit. Njërit i thanë vetëm ti dil natën me bajt ujë, tjetër kush nuk bën të lëvizë, tjetrit i thanë të numërojë sa vetë janë në xhami. Të rinjtë flinin, unë nuk mund të flija, djali më ka fjetur në prehër. Mbas mesnatës, nuk e di sa ishte ora, i doli gjumi djalit dhe më tha: “babush, a shkojmë”,

po unë duke menduar se i kisha parë snajperistat dhe nga frika se e kanë minuar xhaminë, i thashë jo djali im nuk po ikim se ne jemi rob lufte dhe nuk na bëjnë asgjë.

U mundova pak ta bindur djalin se nuk na bëjnë asgjë. Nuk kishim se ku të shkonim. Natën e gjuanin kulmin e xhamisë, ne rrinim të shtrirë në xhami dhe na binin copat e qeremideve prej kulmit se ajo ishte e djegur, vetëm kulmi kishte mbetur. Kaloi ajo natë ashtu duke gjuajtur tërë natën mbi kulm të xhamisë dhe rreth orës 10, përafërsisht po them, kanë ardhur po e njëjta ushtri dhe rrinin me neve. Një epror ushtarak me pseudonimin Bosanac, i ndau ata 35 të miturit që ishin.

Me ta ishte edhe djali im 13 vjeçar. Aty kishte edhe 22 vjeçarë, por atij i dukeshin të rinj dhe i ndau në skaj të xhamisë. Djalin tim e mbante në prehër dhe ia lëmonte flokët. I donte shumë të rinjtë dhe mendohej t'i fliste djalit. Mirëpo djali tha, po shkoj pak te baba. Erdhi djali te unë dhe e pyeta çfarë po të thotë djali. Ai tha, po mundohet të më thotë diçka, por nuk po e kuptoj. Ai po më thotë, mos e kini problem se ju jeni të rinj dhe ne jemi ushtria e rregullt. Djalin e mësova në gjuhën serbe për ta pyetur se si e kishte emrin dhe mbiemrin. Edhe pse ndoshta do të më vrisnin, më interesonte emri dhe mbiemri i tij. Djali u çua dhe shkoi te ai, në prehërin e tij dhe e pyeti. Vetëm ai e ka ditur që e kam djalë dhe ma bëri me dorë me gisht që nuk ka nevojë dhe nuk e çova më gjatë.

Mirëpo djali mërzitej dhe pas pak kohe më thirri djali. Ai po më thotë, hajde te djali hajde.

Mirë, - i thashë unë. Ne jemi ushtri e rregullt, - tha ai. Ai eprori ushtarak me pseudonimin Bosanac, tha a po i sheh këta të rinjtë, do t'i çojmë nëpër familje. Unë i thashë atij, po këta të rinjtë ruajini, se për ne na çoni ku të doni, nuk isha ngushtë. Juve, tha, ju ka tjetër kush në dorë dhe do t'ju pushkatojnë. Vetëm ruajini këta të rinjtë, se unë shkoj si në dasëm, i thashë.

Pas pak djali, tha jam i uritur. Ai e urdhëroi një ushtarë, që ishte te dritarja e xhamisë, i tha shko në kasetën time dhe merre një krem shtapiq dhe sillja këtyre fëmijëve. Ai ushtari shkoi dhe për pesë minuta ja solli atë krem shtapiq. Ia dha djalit në dorë dhe i tha haje vetë, por djali nuk mund ta hante vetë, se ja u dha të rinjve dhe nuk e di a e pat ndalë pak për vete.

Mirëpo ai e pa që ai krem shtapiq është shumë pak për të, e urdhëroi prapë të njejtin ushtar dhe i tha shko në kasetën time dhe merri krejt çfarë ka aty, biskotat, shkopinjte dhe një paketë cigare.

Atëherë ai shkoi dhe i mori krejt çfarë kishte në kasetën e tij dhe atë paketën e cigares ma gjuajti mua, ndërsa biskotat ja dha atyre fëmijëve. Ato cigaret që m'i gjuajti mua, unë ja dhashë atyre që e pinin duhanin dhe një cigare e ndala për vete. Fëmijëve u tha hajini shpejt biskotat, që kur të vijnë të tjerët mos t'ju shohin duke ngrënë. Edhe ne i pimë cigaret dhe dëgjuam zhurmë, të shtëna me kallasha, mitraloza.

Erdhën ashtu si bisha duke na sharë dhe duke na thënë në gjuhën serbe, ku jeni shqiptar, ku e keni NATO-n, ku e keni Klintonin. Do t'ju presim dhe do t'ju grijmë pa hyrë në xhami. Hynë në xhami dhe na çuan të gjithëve në këmbë. Na nxorën përjashta. Pak para se me na nxjerrë përjashta, këta të miturit ishin zbathur. E shikova një djalë me emrin Shpëtim, i cili shikonte pak si në të djathtë. Po i thotë njëri prej atyre, pse po më shikon dhe i ra një shuplakë.

Por djali i fortë, nuk qau. Pastaj filloi t'i binte me shkelma dhe i tha pse nuk po qan, sa fort po të godas. Edhe pse ai nuk qau, eprori që e kishte djalin tim në prehër, po i thotë boll tha. Mos e prek më. Ai u ndal dhe nuk e preku më. Neve na çuan në këmbë, na vendosën rreth xhamisë dhe na thanë t'i kthejmë duart mbi mur e shpinën nga ata.

Na gjuanin me shkelma, me grushta, me stupca dhe ashtu të mbështetur na urdhëruan të dalim prej xhamisë dhe na rënditën të gjithëve në anën e djathtë të xhamisë. E morën një farë Abidinin me dhunë, ai ishte i Perpovcit, dhe i thanë na trego se kush është ushtarë. Ai ashtu prej dhunës, po edhe ata që ishin ushtarë, krejt civilë ishin, po prej dhunës hajt po thotë ky dhe ky është dhe i merrnin, i rrihnin me dru deri në alivanosje. I kam parë ata që i thoshte janë ushtarë. Ka ardhë edhe tek unë dhe është menduar para meje, deri sa i ka thënë ai a është apo nuk është.

Ai tha jo nuk është. Për fat, djalin e kisha mbrapa dhe ai më kapte për këmbësh. Fati im që nuk më

rrahën deri në alivanosje, e mos me mujtë me lëvizë. Ata i kam parë vetë duke i ngarkuar ka katër vetë, dy për këmbësh dhe dy për duarsh dhe i kanë ngarkuar në kamion ashtu të rrahur. Dy kamionat e parë janë ngarkuar plot dhe kanë shkuar në drejtim të panjohur. Tani dihet se njërin e kanë çuar në Lipjan dhe tjetrin e kanë pushkatuar. Disa prej tyre i kishin çuar në Lipjan dhe disa i kishin mbajtur në Krajkovë, me pre gardhiqe, etj. Neve, grupin e fundit na kanë futur përsëri në xhami. Aty kemi pritur deri rreth orës 3.

I kishin zënë disa magjyp të Tushevcit edhe një shqiptar të Bavcit, 82 vjeçar dhe i sollën në xhami. Ata kishin syze dhe ai Tahir Muçolli e kishte atë pompën e frymëmarrjes me të cilën merrte frymë. I sollën brenda dhe i rrahën. Ia morën atë pompën dhe ja shkelën, i tha unë të jap frymë. Ia morën syzet dhe i thanë ne t'i japim sytë. I rrahën deri sa u kthyen dhe ju thanë atyre magjypve se krejt magjyptë janë me neve dhe ju dy magjiup, tha çfarë doni me shqiptarët dhe ja shau nënën.

Po zotëri, -tha njëri prej magjypve, kemi ardhur t'i marrim disa tessa se edhe ne jemi me juve. I shanin dhe i rrihnin prapë dhe i tha ju e di se ku ju çoj. Pastaj kemi dëgjuar po të njëjtat krisma.

Grupi i fëmijëve ishte po në të njëjtin vend. Ai Bosanaci i rrinte përpara. Hynë brenda dhe e kishin marrë një hu të telit dhe e kishin lidhur telin plot gozhda. Sa kanë hyrë brenda në derë të xhamisë, si me shigjetë e qëlluan një plak në gjoks dhe ai hu

është gjetur në xhami. Ata të tribunalit e kanë gjetur në xhami atë hu. Isha i ulur dhe e kisha thikën e ngulur në këmbën e majtë. Po ndoshta ngaqë isha i ulur, më vinte nxehtë se ishte kapur me pantolla dhe me mish e më kishte nxjerrë gjak dhe ishte bërë kore. Po ndoshta ishte kapë mishi me të dhe nuk më dhimbte më. M'u afrua një kriminel dhe ma solli një fotografi, ku isha unë me dy shokë. Tha a po e njeh këtë, për mua.

Unë nuk iu përgjigja as po as jo. Ai tha ty nuk po të intereson dhe më shau dhe më gjuajti me shkelm hundve. Djali ishte në prehër të atij eprorit, bosanacit.

U mundova ta ndal gjakun që mos të më shohë djali, se më vloi gjaku hundve. E vendosa dorën në hundë dhe u mundova ta ndal gjakun, por nuk munda ta ndal dhe djali u trishtua shumë. I vinte rëndë. E urdhëroi atë ushtarin që e kishte te dritarja, tha hajde merre këtë djalë dhe laja sytë dhe tha ruaju nga ky. Na çuan në këmbë. Mua më dhimbte këmba goxha shumë. Na kanë vënë në dy kamiona të mëdha.

Ne e kapërcyem Vllanasellën, kapërcyem Qyrezin dhe shkuam në atë kryqin që është në Dubroshevc dhe Vllanasellë dhe në Drenas. Deri sa na çuan atje hipnin mbi ne dhe na detyronin të këndonim atë këngën Serbia, kush të ka thënë që nuk është e fortë Serbia.

Ata na hipnin përsipër sikur kuajve dhe ne i kishim duart poshtë këmbëve, nuk mundeshim t'i nxirrnim se ishim shumë. Rrugës po flisnin disa pleq, duke thënë

ishalla na ka Zoti në dorë. Unë i thashë mos flisni se këta po na çojnë me na vra. Mua më thanë pse po flet dhe më ra me grykë të mitralozit në kokë. Tha çfarë po flet shta govorish pizdati materina dhe po më afrohet dhe më thotë, juve shqiptarëve do t'ju vrasim prej 2 vjeç e përpjetë. Meshkujt do t'i vrasim, do t'i grijmë, kurse vajzat dhe nuset tuaja, do t'i martojmë me serb dhe do të lindin serb të rinj. Kam parë duke i mbytur dhe duke i rrahur me dru para meje. Kam parë duke prerë me thika dhe nuk kam dëgjuar as të bërtitura. Kanë kërkuar cigare disa prej atyre në kamion dhe ja u kanë dhënë nga një cigare. Edhe aty e kam hëngër atë pykën, atë litarin që i shtihet kamionit, e dini ju çfarë është. I thoja mos i lypni cigare këtyre se këta po na çojnë me na vra, çfarë po ju duhen cigaret e tyre.

Ai e kanë nxjerrë prap atë litarin dhe më ka rënë në kokë sa ka mujt. Nuk mundesha me i nxjerrë duart dhe me e prekë kokën se a e kam të çarë. Më humbi vetëdija. Ua kanë dhënë cigaret, i kanë nderur dhe i kanë thënë ndizini, hajde ngrehini ma shpejt se shkuam për t'u bërë gaca. Gati në gjysëm të cigares e ka urdhëruar një tjetër dhe i tha merre cigaren dhe fike në atë kokën pa flokë, te koka e Riza Prokshit. Për atë po them qenka i rëndë zjarmi. I kanë thënë mos e fik cigaren menjëherë, por ngadalë.

Duke e fikur dilte tym mbi atë që ju dogj lëkura. Nuk kam dëgjuar të bërtitura nga të rrahurat, të vrrarët, të mbyturit, por kam dëgjuar një britmë se qenka i rëndë zjarmi. Atë e kam parë me sytë e mi.

Na çuan në kryq, aty na zbritën dhe e ndalën kamionin. Na numëruan 10 nga 10. Në grupe thanë me i çu në atë gropën që ishte dhe me i pushkatu. Aty e kam ditë se ishim 32 në kamion. Grupi i parë shkoi, u dëgjuan krismat dhe aty i pushkatuan. Po ashtu edhe grupin e dytë. Ne, grupi i tretë, ishim 12 vetë dhe na nxorën nga kamioni. Hajdeni, tha krejt ju dhe zbritni. Na kanë zbritur me duart mbrapa. Unë e kam pasur këpucën e shkelur se më vriste. Aty vinte një i hollë, i gjatë me një kallash përmbas dhe i vendosa dy duart përmbi kokë dhe u përkula, gjoja se po e mbathi këpucën. Unë nuk doja ta mbathja këpucën se ajo më vriste, por thashë ndoshta më afrohet ai dhe më thotë çohu me grykën e pushkës. Unë mendoja t'ia merrja atë kallash. Mirëpo ai u ndal 10 metra përmbas dhe më shau serbisht.

Është dashur të çohem në këmbë. Përpara e kam pasur Bajram Shabanin dhe grupit i kam thënë kush mundeni ikni. Vetëm Bajram Shabani është ndarë, a më ka dëgjuar apo jo, nuk e di. Ai ndoshta e ka pasur ndër mend që të ikë. Ai përpara, unë mbrapa, shtatë kallasha i kemi pasur mbrapa, tre mitraloza. Ata kanë qenë krejt në gjendje gatishmërie duke na rujatur neve. Krejt janë ndezur përnjëherë.

Nuk ka breshër që bjen ashtu si atëherë. Nga kjo e kam marrë një plumb të një mitralozit në krahun e djathtë dhe më ka shpuar. Pushka më ka rrëzuar dhe më ka kthyer në anën e majtë. Pasi jam plagosur jam çuar në këmbë dhe me dy duart i kam sharë në

gjuhën shqipe, se plumbi juaj nuk më ndalë. Hajt se tani ta tregojmë ne ty, kanë thënë ata dhe kanë shtënë me breshëri. Një më ka marrë këtu përmbi gisht dhe në dymbëdhjetë vende e kam pasur xhemperin e shpuar. I kam dëgjuar që thonin në gjuhën serbe, se ky qenka robot se ja merrte mendja se krejt plumbat po më binin në trup dhe nuk po më rrëzonin. Kemi ecur përpjetë dhe kemi trupuar. Ata e kanë ndezur kamionin dhe janë munduar të na dalin në pritë në atë qoshen ku po shkonim.

Ne hymë në malin e Vllanasellës dhe ata kanë ardhur mbas nesh duke na gjuajtur. Përreth kishte pasur snajperista që na gjuanin. Ata erdhën mbas nesh. Mua nuk më ndalej gjaku dhe duke ikur, gjaku pikonte nëpër dushk. Ata e kishin qëllimin me më kapë mu të plagosur dhe me më marrë, mirëpo ne hymë në malin e Vranasellës, deri përfundi trafove, aty ku ishte trafoja e Feronikelit.

Ata dikur na lanë dhe ne shkuam në një kodër. Aty e gjetëm një burim, ku ishin larë bullicat. Isha i etur dhe për qejf do të kisha pirë ujë aty, por u kujtova se nuk është mirë me pi ujë kur je i plagosur dhe u mundova t'i laj hundët se isha i përgjakur. I thashë atij që ishte para meje ndalu dhe lidhma plagën, se e pashë se jam lodhur shumë dhe kisha gjakderdhje shumë të madhe. E shkyva mëngën e majtë të këmishës sime dhe i bëra disa arna dhe ai më mdihmoi ta lidhi plagën. Nga kodra dukej Qyrezhi. Xhamia shihej prej kodrës së Vranasellës që ishte

afër me kodrën e Lubovcit. Bajrami po më thotë a ecim. Unë i thashë jo nuk po ecim se fëmijët i lamë në xhami dhe më interesonte ku po i çojnë. Deri sa u errësua ndenjëm aty dhe nuk pamë askënd, vetëm një furgon të bardhë, që shkoi po në të njëjtën udhë. Mendoja se të rinjtë do t'i çojnë nëpër familje, sikur i pata dëgjuar ata që thonin se jemi ushtri e rregullt. Në kodër ishin forcat e përqendruara te Prekazit e Qyrezit. Aty na hetuan dhe na gjuajtën. Ne zbritëm në rrafsh, përtej Rukiqve janë disa muhaxher dhe ndenjëm aty, ku i gjetëm disa shqiptarë që ishin të ikur dhe njëri na dha një cigare, tjetri na dha një kulaç të thatë. Kulaçin e ndamë dhe cigaren e pimë bashkë me Bajram Shabanin dhe u nisëm për Goshevc. Kur shkuam në Goshevc ishte një teknik, Avnia që kishte pajisje për pastrimin e plagëve.

Ai ma pastroi plagën dhe ma dha një ilaç. Aty qëndrova dy ditë. Ai tekniku ma pastronte plagën dhe duhej të dilnim në mal se ende ishim të rrethuar, aty kishte ushtri dhe polici. Më 3 maj '99 u detyruam të ikim dhe prej aty shkuam në Lipovec, Nverrnice te Bajram Regjepi. Aty jam shëruar. E kam bërë pastrimin e plagëve për çdo ditë për 11 ditë rresht dhe më është mbyllur plaga. Ai më ka ndenjtur gati, faleminderit prej tij.

Mbas 11 ditësh kam filluar t'i kërkoj familjarët. Kam qenë në Qiqavicë, në Klinë, në Skenderaj ku ishin të përqendruar familjarët dhe i kërkoja ata të mitur. Mendoja se i kanë çuar në ndonjë familje dhe i kam kërkuar

vazhdimisht. Mendoja se mos i kanë çuar në familje serbe, gjithçka mendoja dhe isha në ankth. Mbas 6 vitesh kemi mësuar se edhe ata kishin pësuar po të njëjtin fat si grupet e tjera dhe më erdhën testet e ADN-së. Sipas analizave të ADN-së, më thanë këto janë eshtrat e djalit tënd. I kam rivarrosur dhe jam lehtësuar kur e kam ditur se ku janë eshtrat e tij. Kam punuar vullnetar në shërbim të kërkimit të të zhdukurve dhe e kam regjistruar shoqatën si vullnetar prej vitit '99, pa përkrahjen e askujt. Këto janë tërë ato vuajtjet që i kam parë vetë me sytë e mi.

Ju falenderoj juve që keni gjetur kohë të bëni intervista dhe jam i gatshëm që çdo herë ta nxjerrë në shesh të drejtën. Shpresoj që një ditë të triumfojë drejtësia dhe të gjithë ata që kanë kryer krime të dalin para drejtësisë. Ne si familjarë nuk jemi të kënaqur, derisa Beogradi ta pranojë fajin e vet dhe t'i paguajë të gjitha dëmshpërblimet që i ka bërë: djegiet dhe vrasjet e njerëzve dhe të kafshëve, që nuk kanë lënë gjë pa bërë në popullin shqiptar. Shpresoj që gjithë udhëheqësat t'i nxjerrin para drejtësisë dhe shpresoj që të ndrojnë struktura e tyre e të bëhen më demokrat.

Ju falenderoj shumë.

7

Bisedë me

Adrian Mehmetin

Dëshmitar

A mund të na flisni pak për prejardhjen tuaj, kohën si jeni rritë dhe të na i përmbledhni të gjitha këto?

Unë jam i lindur në Preshevë, siç e dini d.m.th në pjesën Jugore, padrejtësisht në pjesën Jugore të Serbisë ose si e njohim ne Lugina e Preshevës ose Kosova lindore, nëse e marrim gjeografikisht. Kam lindur në vitin 1974 nga babai Mexhidi, ndërsa nënën e kam me prejardhje nga Drenica, më konkretisht nga fshati Obri. Jeta ime pak a shumë ka kaluar në familje e cila i është përkushtuar kryesisht arsimit. Pjesa më e madhe kanë qenë me arsim superior. Gjyshi im mbasi ka dalë prej luftës së dytë botërore ka qenë mësues, një ndër mësuesit e parë në regjion pastaj drejtor shkolle, do të thotë i është përkushtuar tërë jetën e vet arsimit deri në pension. Babi im gazetar me përvojë shumëvjeçare dhe shkrimtar, nënën e kam pasur motër medicinale. Kjo pak a shumë ka qenë sa i përket asaj pjesës së edukimit, ndërsa jeta ime ka qenë një jetë e një rokeri, “Rock’n’Roller” për dallim prej pjesës më të madhe të njerëzve me të cilët jam shoqëruar dhe me të cilët kemi pasur të bëjmë këtu.

**Si e gjen familja jote veten
do të thotë, familja jote edhe jeta
jote në familje përballë konfliktit
ose luftës që ka pasë Kosova duke
filluar prej viteve të 99-ta ose më herët?**

Unë personalisht nuk i jam nënshtruar represalieve ose çka di unë nga pushteti, mu për faktin se thjesht orientimi i familjes tonë nuk ka pasë të bëjë fort me politikë, nuk ka pasë të bëjë fort me çështje të ndjeshme për shtetin. Babai im në vitin '68 p.sh., ka qenë pjesëmarrës i demonstratave dhe ka qenë i arrestuar në atë kohë për pak kohë dhe është liruar pastaj. Ne si familje gjithmonë e kemi mbajtur anën e popullit kur ka pasur demonstrata, kur kanë shprehur njerëzit pakënaqësi edhe ne kemi qenë pjesë e saj.

Po ashtu në vitin '89 kur u suprimua autonomia e Kosovës, edhe në Preshevë ne kemi qenë dhe kemi bërë demonstrata, kemi demonstruar në të njëjtën mënyrë. Kemi vuajtur dhe i kemi shprehur ato pakënaqësitë njësoj sikurse populli i Kosovës këtu, s'kemi pasur dallim pavarësisht pozitës gjeografike. Unë dhe familja ime i kemi konceptuar edhe i konceptojmë të padrejta, pa marrë parasysh se tani ne po shkojmë drejt integriteteve, do të thotë kur kufijtë më nuk do të kenë vlera dhe unë jam i mendimit që kufijtë të mos kenë vlerë. Kemi kaluar nëpër të njëjtat represalievë, nëpër të njëjtat probleme nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar edhe në Preshevë, po edhe këtu. Sidomos ne

në Preshevë e kemi pasur edhe pak më vështirë sepse pozita politike ka qenë më e vështirë edhe sot është shumë më e vështirë sesa ka qenë përpara.

Gjatë kësaj kohe a ka ndodhur që të ketë dhunë, ndoshta jo vetëm në familjen tuaj, por në kohën kur janë bërë demonstrimet dhe pakënaqësitë e ndryshme prej kohës dhe prej fakteve që kanë ndodhur në vend?

Po fakti që kemi pasë familjarë d.m.th shokë, miq, dajallarë, nipa, mbesa të arrestuar, të keqtrajtuar, të persekutuar, nuk i është dhënë rasti që të punojnë, nuk i është dhënë rasti që t'i tregojnë përgatitjet profesionale, nuk kanë pasë bursa, nuk kanë pasë pensione prej shtetit. Krejt ajo është një pjesë e historisë së dhimbshme të familjes time dhe të popullit tonë në përgjithësi.

D.m.th., paska pasur dhunë në atë kohë?

Sigurisht, sigurisht që ka pasur dhunë...

Nuk po flasim për kohën e demonstratave, nuk po flasim për kohën kur njerëzit kanë shprehur pakënaqësi, por ka pasur njerëz që kanë qenë të burgosur për shumë vite, ka njerëz që kanë shkatërruar jetën e vet do të thotë nëpër burgjet serbe.

Ti personalisht si e gjen kohën ose situatën politike të vitit '89, çfarë të ka ndodhur në atë kohë?

Në vitet '89, unë kam qenë 15 vjeçar, por sigurisht kam ndjerë. Ndjenjat e njeriut nuk konceptohen me afat kohor do të thotë nuk ka një, siç thonë ata një "Time Table" ose një orar se kur fillon njeriu ta ndiejë dhunën, represionin etj. Ajo fillon qysh prej lindjes. Në atë kohë unë kam qenë në shkollë të mesme. Shkolla jonë e mesme është quajtur me vite "Skënderbeu". Në atë kohë, i është ndryshuar emri me një vendim politik dhe i është bërë "25 Maji", do të thotë edhe ajo ka qenë një prej fillimeve kur kanë filluar edhe gjërat të shkojnë për së prapi. Sigurisht se nuk kanë qenë mirë edhe përpara, por fakti që ne kemi bashkëndier me bashkëkombësit tanë në Kosovë është momenti kur është suprimuar autonomia e Kosovës, dihet nga pushteti i Millosheviçit në atë kohë kur ai filloi ta marrë fuqinë e vet.

U shprehën pakënaqësitë në Kosovë, filluan demonstratat në Kosovë, iu bashkëngjitëm edhe ne atje, një përkrahje më tepër, më tepër një përkrahje morale popullit të Kosovës dhe cka ndodhi pastaj, njësoj, demonstratat, sollën edhe atje te ne, erdhën shumë fuqi ushtarake d.m.th., u vendosën në lokacione të ndryshme nëpër gjithë territorin, të gatshëm për të hyrë në luftë, të gatshëm për ta sakatuar këtë popull të thjeshtë.

Unë kam qenë ende i ri në vitin '89 mirëpo kam ndier shumë, kam bashkëndier me krejt popullin tonë.

Sa ka qenë e vështirë që në tënjëjtën kohë t'i kryesh studimet dhe në anën tjetër të jesh vazhdimisht nën presionin e pakënaqësive ose konflikteve politike që kanë ekzistuar në atë kohë?

Po në atë kohë unë kam pasë familjarë në Maqedoni të cilëve i është ndaluar me ligj shkollimi në gjuhën amtare edhe ata kanë udhëtuar çdo ditë 30-50 km në dy drejtimet, konkretisht për me ardhë me kry shkollën te ne në gjuhën shqipe edhe pse edhe te ne programi dhe krejt planprogrami kanë qenë direkt prej Serbisë do të thotë një planprogram i cili nuk i është përshtatë dhe nuk do t'i përshtatet kurrë një pakice kombëtare, si na kanë quajtur ata neve në atë kohë.

Ka qenë e vështirë. Kur kaloi viti '89 atëherë është dashur ta kryej shkollën e mesme dhe të përcaktohem se ku do të shkoj t'i vazhdoj studimet. Ka qenë shumë e vështirë për mua. Fitova një bursë nga një fondacion holandez, nuk më kujtohet tani si ka qenë ajo. Kanë qenë 8 vetë të Kosovës edhe unë që e fitova, mirëpo fakti që familja nuk donte të më largonte prej rrethit të vet edhe prej vendit unë e refuzova atë bursë dhe u përcaktova për në Prishtinë, pa marrë parasysh se në çfarë rrethanash kanë qenë studimet këtu. Pak para se të ndodhte kjo, para se të vendosja për të ardhur në studime e patëm edhe procesin e rekrutimit për në ish-APJ. Dihet se në atë kohë APJ-ja u kyç në luftën në Bosnje, në Kroaci.

Armata Popullore e Jugosllavisë?!

PO, Armata Popullore e Jugosllavisë...e Jugosllavisë në thonjëza të themi se në atë kohë nuk kishte më shqiptarë në armatë, nuk kishte as slloven në armatë, as kroatë dhe as boshnjakë. Po flas për eksponentë të veçantë se ka pasë edhe shqiptarë që kanë vazhduar të punojnë dhe të bashkëveprojnë me ushtrinë, siç ka pasë edhe kroatë dhe slloven. Mirëpo pjesa më e madhe e ushtrisë në atë kohë kanë qenë serb, me një pakicë të vogël ndoshta maqedon dhe malazez.

Ne shkuam rekrut dhe ishim gjenerata e fundit kur pranuan të shkojmë rekrut, mirëpo kërkuam prej prindërve dhe profesorëve që ta bëjnë edhe ata një delegacion dhe erdhën edhe profesorët me ne, dy-tre profesor i kemi pasur me vete, kjo ka qenë edhe gjenerata e fundit e shqiptarëve të Luginës që kanë shkuar rekrut në Serbi. Që atëherë nuk ka pasur më thirrje dhe nuk i janë nënshtruar shërbimit ushtarak.

Çfarë qëndrimi kanë pasur shqiptarët përballë APJ-së, a kanë shkuar me vullnet apo kanëqenë të detyruar të shkojnë?

Ne kemi qenë të detyruar se kemi qenë në shkollë të mesme dhe kemi pasur presion që nëse nuk shkojmë ta kryejmë rekrutimin nuk na jepen diplomat e kryerjes së shkollës së mesme dhe na shkon poshtë shkollimi. Për atë u bë edhe një kompromis, do të thotë në skenën politike në atë kohë te ne që ishte me profesor, me drejtorin e shkollës edhe me prind, kemi shkuar me përcjellje të veçantë në qendrën e rekrutimit në Nish. Gjatë luftës që bëhej në ish-Jugosllavi, në Kroaci, në Bosnje etj., në Nish ishin përqëndruar shumica epror serb të cilët i kanë pasur baballarët edhe prindërit e vet me pozita të larta për me i ikë terrenit edhe për me i ikë luftës, thjeshtë rrezikut për vdekje. Atje në terren i kanë sjellë krejt ata, nacionalistat e mëdhenj në Nish.

Edhe ne, më kujtohet si sot, patëm problem se një lojë futboll që e luajtëm u rrahëm atëherë. Kjo ka ndodhur para se unë të vija në studime. Në kohën kur erdha në studime, në vitin '92-'93, aty veç botëkuptimi im u ndryshua, fillova të mendoj ndryshe, fillova t'i shoh gjërat më ndryshe dhe të prekëm më tepër, kur e pashë çfarë vuajtjesh ka pasë në Kosovë më konkretisht. Unë jam nip i Drenicës dhe dihet për Drenicën se gjithnjë ka qenë e shtypur si territor, si popull.

Mirëpo e njëjta ndodhi në krejt Kosovën, thjeshtë nuk mund të bëj dallime të mëdha se ku janë bërë më tepër dëme. Kur erdha në Prishtinë e pashë se me të vërtetë këtu duhet të ndryshohen gjërat.

**Çfarë të shtyri të ndryshoshgjykimin,
d.m.th a e ke parë realitetin, si ke
qëndruar apo ke parë edhe ndonjë fakt
tjetër që është manifestuar dhunshëm,
vrasje apo edhe diçka që është e
ngjashme me këtë?**

Po ato kanë qenë të përditshme, d.m.th., vrasjet ne i dimë. Unë nuk i di me data, por shqiptarë, aktivistë, njerëz që kanë kontribuar për këtë vend vazhdimisht janë vrarë prej pushtetit. Nuk po flasim edhe për luftërat përpara, por po flasim historikisht deri në ditët e sotme. Ka shumë raste ku midis Prishtinës janë vrarë p.sh., ky Fazliu, Afrim Zhitia dhe aktivistë të tjerë janë vrarë para luftës së UÇK-së, luftës së fundit. Janë vrarë aktivistë si Ali Hadria, Isuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla, Kadri Zeka etj. Edhe në Perëndim është zgjatur dora e kriminelëve të regjimit dhe pushtetit serb. Ajo i ka përfshirë edhe trojet shqiptare ku kemi jetuar ne, pa marrë parasysh se ku ka qenë e përqendruar veprimtaria e aktivistëve tanë shqiptarë. Unë kam qenë viktimë e pushtetit sikur gjithë të tjerët.

Erdha në studime dhe e kam pasë banesën në Ulpianë. Aty përballë banesës sime e kam pasë fakultetin teknik, për të cilin isha përcaktuar të studioj. Kam pasë mensën e studentëve dhe konviktet, krejt ajo infrastrukturë e madhe e bërë me djersën e këtij populli. Edhe unë jam detyruar njëkohësisht të eci për çdo ditë për të shkuar në një shkollë fillore në rrugën e proletarit, siç e quanin atëherë, përtej medresës në Prishtinë. Për çdo ditë më është dashur të shkoj në ligjërata në turnin e tretë, mbas turnit të tretë në fakt se tre turne i kanë mbajtur nxënësat e shkollave fillore dhe të mesme. Mandej në orën 7-8 në mbrëmje kanë filluar ligjëratat. Është dashur të kaloj nëpër katër-pesë patrulla, më falni në shprehje, por me indeksin të futur mbrapa jo në xhep por në brekë, që mos me më pa, mos me më dalë, mos me më rrahë, mos me më keqtrajtu policia. Kjo gjendje ka zgjatur afërsisht katër vjet rregullisht. Kemi punuar nëpër shtëpia, kemi mbajtur orë nëpër laboratore private çfarë kanë mundur të adaptojnë edhe profesorët në atë kohë. Në të njejtën kohë i kemi parë konviktet dhe krejt atë infrastrukturë të universitetit që ka ndenjtur e zbrastë ose është keqpërdorur, për shembull është banuar me refugjatë, është banuar me çka po di unë, me gjithçka, me struktura të ndryshme.

A ka ndodhur gjatë kohës së viteve të studimeve tua që dikush prej kolegëve të tu ose shokëve të tu të keqtrajtohet...?

Sigurisht...

Madje kemi dëgjuar edhe për raste vrasjesh?

Sigurisht ka pasur raste që janë bërë kronologjikisht dhe nuk kanë ndodhur vetëm në një periudhë kohore. Ka pasur raste, sidomos ne që kemi qenë studentë të Preshevës na kanë keqtrajtuar dyfish më tepër kinse ne kemi pasur mundësi të kemi shtetin dhe kemi mundur të shkojmë dhe të studiojmë në Nish ose në Beograd, por jemi përcaktuar për Kosovë, për sistem paralel të studimeve.

Për ne ka qenë absurde ta quash sistem paralel një universitet në të cilin ti përcaktohesh për të studiuar pa marrë parasysh kushtet të cilat ja ke diktuar ti si regjim. Po ka pasë shumë keqtrajtme dhe kemi pasë raste konkrete, sidomos mbas vitit '96. Atëherë veç ka qenë problem edhe më i madh se thjeshtë ka mujtë me të shku koka.

Meqënëse e përmendët vitin '96, ne dimë për një lëvizje që ka qenë: LPK-ja. Çfarë qëndrimesh kanë pasur njerëzit ose çfarë reaksionesh ka shfaqur pushteti serb përballë kësaj lëvizjeje, çfarë ka bërë kjo lëvizje?

LPK-ja është një histori e veçantë në vetvete, por edhe për mua është një pjesë e jetës sime, e veprimtarisë sime, do të thotë kur unë kalova në këtë periudhë kohore kaq të zyrtë, kaq të keqe, kaq trishtuese për popullin tonë, unë thjeshtë mendova për një alternativë, e në atë kohë alternativë ka qenë të dalësh jashtë, ta harrosh këtë vend, këtë popull ose të mendosh pak më ndryshe dhe mendimi ndryshe për mua ka qenë të gjej një derë tjetër, një rrugëdalje.

Në atë kohë fillova t'i diskutoj gjërat me disa shokë, dihet se shumica e popullsisë ka qenë e përcaktuar për paqe, unë mendoj se edhe sot, edhe në vazhdimësi d.m.th, ky popull ka qenë i përcaktuar për paqe për vet faktin se ne nuk kemi bërë kurrë zgjerim të territorit, gjithmonë jemi zvogëluar, gjithmonë kemi ikur, gjithmonë kemi qenë të përndjekur. Edhe sot e më tutje vazhdon i njëjti proces pa marrë parasysh se dikush mundohet ta kthejë realitetin ndryshe. Edhe unë pata dëgjuar për LPK-në, për Lëvizjen Popullore të Kosovës, të cilën sot ndoshta shumë njerëz e konceptojnë si Lëvizje Marksiste-Leniniste. Unë me

ideologji të tillë nuk di absolutisht sa i përket asaj periudhe, kësaj ideologjie, unë kam ditë për Marks, Hengelsin edhe Leninin prej librave se kemi qenë të obliguar t'i mësojmë ato, në lëndën e sociologjisë apo historisë etj.

Mirëpo, si ideologji ose si lëvizje me ideologji nuk i isha bashkangjitur kurrë dhe gjithë ata njerëz që i kam gjetë brenda aty asnjë nuk ka qenë i ngarkuar ideologjikisht. Ata e kanë parë si një derë, si diçka e cila do fillojë t'i ndryshojë gjërat. Kur unë fillova të mendoj pak ndryshe dhe të kërkoj rrugëdalje, disa shokë e panë interesimin tim, shokë edhe të babit tim, të mëhershëm, të burgosur politik etj., dhe m'u afruan.

Ishte viti '96 atëherë kur ma dhanë këtë ofertë, unë nuk prita hiç edhe me të parën pranovë dhe fillova aktivitetin me ta. Ka qenë fundi i vitit '96 kur unë u bëra pjesë e tyre. Fillimisht lexonim gazetën "Zëri i Kosovës", në atë kohë është botuar jashtë edicioni dhe kopjet kanë ardhur në adresa të caktuara, kush ka mundur të lexojë pak literaturë etj. Ky ka qenë fillimi dhe pastaj filluam të bënim organizime, organizime në treshë i thonim ne, këshille, këshillet e rrethit të LPK-së p.sh, dhe kemi qenë tre vetë, secili grup nga tre vetë dhe e ka pasë një përgjegjës.

Përgjegjësi na ka njoftë vetëm ne të dyve dhe një epror përmbi që e ka pasë, e kështu ka shkuar në formë piramidale. Më kujtohet njëherë kur përgjegjësi i grupit tim ka qenë i sëmurë dhe më autorizoi mua

që të shkoj në mbledhjen e këshilleve të rrethit. Kur shkova aty i pashë edhe tre shokë me të cilët rrija përditë, por absolutisht nuk e dija dhe as nuk e kisha idenë se mund t'i takojnë të njëjtit organizim. Organizimi ka qenë shumë i përsosur, sidomos në rajonin tonë ku kemi vepruar nuk kemi pasë asnjë gabim dhe nuk kemi pasë asnjë të rënë në burg. Ka qenë një gjë interesante dhe shumë e mirë.

Kjo ka qenë sa i përket LPK-së deri sa na u dha vendimi që nuk ka më LPK dhe LPK-ja dhe krejt pjesëtarët e saj do të kthehen në UÇK. Do të thotë ka qenë fundi i vitit '97 kur ne e kemi ndier veten si pjesëtarë të UÇK-së.

Prej cilit vit ke filluar në UÇK, në cilin vit ke qenë saktësisht pjesë e UÇK-së?

Pjesë e Lëvizjes, vazhdimësi e së cilës për mua ka qenë pastaj edhe UÇK-ja, edhe krejt proceset që po ndodhin edhe sot, se krejt kjo është lëvizje, do të thotë UÇK-ja nuk ka qenë aparat represiv as nuk ka qenë kurgjë tjetër përveçse një pjesë e lëvizjes, pjesë e përpjekjeve të këtij populli për të ardhur deri ku jemi sot dhe për të synuar ato që do t'i shohim sigurisht mbas disa vitesh, integrimin nëpër organizatat ndërkombëtare, Unionin Evropian, në NATO etj. Unë e ndiej veten si pjesëtar të UÇK-së prej momentit kur

kam lindur, ndërsa e ndiej veten pjesëtar të UÇK-së zyrtarisht prej momentit kur UÇK-ja ka dalë në skenë për herë të parë e kjo është fundi i vitit '97, konkretisht kur janë paraqitë për herë të parë tre pjesëtarë të UÇK-së me maska dhe e kanë lexuar deklaratën në varrimin e mësuesit të ndjerë Halil Geci, nga fshati Llaushe. Prej atij momenti, zyrtarisht edhe ne kemi marrë në njëfarë mënyre urdhrin se të gjitha grupet, të gjithë pjesëtarët e LPK-së që kanë qenë, prej atij momenti janë pjesëtarë të UÇK-së.

Cila ka qenë fusha ku ke vepruar ti gjatë kohës kur ke qenë zyrtarisht pjesëtarë i UÇK-së?

Zyrtarisht kur filluam si pjesëtarë, do të thotë fillimisht i vazhduam aktivitetet e njëjta që i kishim pasë në fushën e logjistikës, furnizimit eventual me armatim, andej këndeje, me pajisje komunikimi, me gjëra të tjera, me krijimin e celularëve, me shpërndarjen e njerëzve në terren, me krijimin e bazave etj. Vazhdova aty ku edhe pata filluar, në rajonin tonë atje në Karadak kemi pasë bashkëpunim të natyrshëm me regjionin e Karadakt të Gjilanit do të thotë, me Gjilan me Kamenicë ose me Dardanën e sotme dhe Preshevë, Viti e deri në Ferizaj, d.m.th kjo ka qenë ajo fusha ku ne kemi vepruar fillimisht. Pastaj me krijimin e lidhjeve të reja unë dola dhe iu bashkova një grupi

që kanë vepruar në kuadër të shtabit të përgjithshëm, një grup operativ i quajtur “Feniks”, i koduar “Feniks”, me disa shokë të tjerë me të cilët kishim pak a shumë botëkuptime të njëjta dhe fatmirësisht prej tyre vetëm dy janë vrarë, të tjerët janë ende gjallë dhe kemi vepruar për një kohë në Prishtinë. Do të thotë jemi marrë kryesisht me çështje, informacione, gjëra të tjera, kemi krijuar infrastrukturën për radiostacionin “Kosova e Lirë”.

Ne e kemi marrë radiostacionin si donacion prej Ismet Bexhetit që e ka pasë atëherë “Radio Kumanova”. E kemi marrë donacion, e kemi sjellë, i kemi bërë lidhjet me ekspertët e tjerë, këtu është bërë komponimi i këngës do të thotë si shpica që janë të radios e ato gjërat e tjera, pastaj teknikisht e kemi angazhuar Xhevdet Gashin që është një kompozitor i njohur këtu te ne, për komunikim pastaj Z. Blerim Penin që është një inxhinier shumë i njohur. Ajo ka qenë një prej projekteve madhore që kemi bërë ne si grup, përpos angazhimeve të tjera, kryesisht në koordinim mes shtabit dhe njësive.

Pastaj kah fundi i vitit ‘98 neve këtu na u plagos një shok i grupit dhe ne në atë moment e morëm sinjalin e qartë se jemi të përcjellur dhe vazhdimësia e punës sonë brenda Prishtinës do të ishte shumë e rrezikshme për ne dhe për grupin. I morëm instruksionet, unë kalova në zonë të Llapit pastaj shkova diku për nja një muaj patëm trajnime. U tërhoqa dhe për vit të ri të vitit ‘98 për herë të fundit kam qenë në Preshevë në

vendlindjen time dhe ika për në Maqedoni, Shqipëri ku patëm disa trajnime. U ktheva mbrapa dhe u futa në luftë në zonën e Nerodimes, konkretisht në Petrovë, afër Reçakut të famshëm për masakrat që u bënë atje në vitin '98. Kjo ka qenë do të thotë veprimtaria ime dhe çlirimi i Kosovës më ka gjetur në fshatin Petrovë të Shtimes ku edhe ka qenë shtabi i zonës operative të Nerodimes në atë kohë aty më ka gjetë marrëveshja e Kumanovës, aty e kemi bërë edhe festën kur është nënshkruar marrëveshja. Edhe pas asaj kohe, qyteti i parë të cilin e shkela në çlirim ka qenë Shtimja dhe vazhdova për Ferizaj, Gjilan, e kështu me radhë.

**Përmende që dy prej shokëve
të tu janë vrarë dhe njeri është
plagosur, a keni qenë në ngjarje aty,
në vendin ku ka ndodhur. Si ka ndodhur?**

Fatmirësisht jo. Dy prej shokëve me të cilët kemi qenë në Prishtinë, njeri ka qenë Uran Tinova nga Ferizaji dhe i dyti ka qenë një rast për të cilin trishtohem, një Enver Hoxha ka qenë prej rrethit të Gjakovës, ai ka ardhur në Prishtinë për ta tërhequr të shoqen e vet, familjen e gruas, me e tërheqë prej Prishtinës në kohën kur filloi depërtimi i madh prej Prishtinës edhe e kanë marrë... është futë në kurth dhe thjeshtë e kanë marrë me kolonë e kanë depërtuar në fshatrat Llukar dhe andej që e kanë pasë vijën që i kanë depërtu popullsinë

e Prishtinës. Aty thuhet se i kanë rendit ka katër vetë dhe është shumë e vërtetë në bazë të krejt dëshmive të mundshme që i kanë thënë njerëzit dhe çka i kanë deponuar ato dëshmi në gjykatën ndërkombëtare të Hagës.

Kanë filluar grupe të ndryshme përpos që i kanë plaçkitë, i kanë marrë pare, pasuri dhe çka kanë pasë do të thotë ar, argjend e gjëra të tjera të vlefshme që kanë pasë me vete. Kur nuk kanë pasë pastaj e kanë ndalur dhe dikënd e kanë vrrarë në prani të krejt kolonës. Edhe ky e ka pasë fatin e keq, ky shoku im, që e kanë marrë dhe e kanë prerë me sharrë të druve dhe e kanë ba copa-copa në fshatin Llukare, në masakrën e Llukarit dhe ai aty e ka humbur jetën.

Deri sa keni qenë pjesëtar i UÇK-së keni kaluar me siguri nëpër sfida të ndryshme, a ka pasë momente kur ju është dashur të qëndroni ballë për ballë në vijë të frontit edhe të luftoni?

Unë personalisht nuk kam pasë shumë raste kur kemi bërë luftë frontale për shkak të natyrës, për shkak të detyrave që unë i kam pasur, mirëpo gjithmonë kemi qenë të gatshëm dhe kemi qenë të armatosur pa marrë parasysh çfarë fuqie kemi pasë. E di në vitin '98 dilnim të bënim roje, tre vetë e merrnim një

kallashnikov, dilnim në fshatin Vranidollë këtu ku ka qenë e përqendruar një njësi shumë e madhe tankistësh serbë. I kishim përballë ata me shumë tanke, ne këtu ishim tre vetë me një kallashnikov, diçka që nuk di si ta sqaroj ndryshe përpos një dëshirë shumë e madhe për t'i qëndruar përballë një padrejtësie edhe më të madhe. Kemi pasë raste të ndryshme kur jemi gjendë në situata të palakmueshme edhe këtu në Prishtinë edhe gjithkund ku kemi vepru, po edhe gjatë luftës në terren kur kemi qenë ballë për ballë gjithmonë me forcat e tyre.

Si i ndodhi shokut tënd me u plagosë në atë kohë?

Ah, këtu në Prishtinë, ajo ka qenë shumë interesant, dy prej shokëve të mi, të dy janë gjallë tani, kanë dalë me kry një punë në qytet. Fatmirësisht kanë pasë të veshur maica të gjata edhe të nxjerra përmbi pantolla dhe ata që i kanë përcjellë kanë menduar se kanë edhe armatim se i kishin kapë edhe të gjallë ndoshta.

Njëri prej shokëve më vigjilent e ka parë një tjetër prej andej që po vjen përpara me një çantë në dorë po me kamerë të instaluar brenda, dhe i thotë këtij tjetrit, Toni: “Bastri” i thotë: “Lako”, se na e kemi pasë Lako pseudonimin në mes veti, e i thotë: “Lako, ky djali përpara hiç i mirë.” Ky i thotë: “Po e pashë, hajde të ikim majtas”. Kjo ka ndodhë në Breg të Diellit

edhe ikin majtas. Ky i thotë: “Edhe ky këtu s’qenka bash i mirë” edhe i kanë pa që për momentin diku katër-pesë vetë operativca do të thotë, që kanë qenë sigurisht të shërbimeve të serbëve, i kanë përcjellë tërë kohën me kamera, i kanë inçizuar dhe për një moment këta kanë ikur dhe ai ka gjuajtë me skorpion. E kanë gjuajtë ata me skorpion dhe kanë mbërritur me e plagosë njërin, këta janë futë në një taksi urgjent dhe i kanë thënë taksistit: “Ik gjeje rrugën, UÇK-ja jemi, ik gjeje rrugën, Ik” edhe ai e ka njohë mirë terrenin edhe i ka ikur thjeshtë, ka ikur andej nga mahalla e Muhaxherëve. Kur shkova ta shoh në Llap, për nja dy javë ai u shërua. Edhe aty përfundoi misioni ynë, ikëm, u shpërndamë se nuk guxam më se e pamë se jemi të ndjekur.

**Si është ndjenja tani mbas krejt
kësaj kohe që ka kaluar duke i
përmendur sfidat prej viteve '89
ndoshta edhe më herët e deri në
momentin kur Kosova u çlirua,
ularguan forcat serbe dhe u fut NATO-ja.
Si është kjo ndjenjë për ta përshtuar?**

Kur po e llogariti që shkuan dhjetë vjet prej asaj kohe, po më duket e pamundur dhe nuk jam i kënaqur me shumë gjëra, kisha dashur që shumë gjëra të ishin pak më ndryshe. Mirëpo i dimë rrethanat në të cilat po krijohemi si shtet dhe sidomos vitet e para i kemi përjetuar shumë mirë, një liri totale, diçka që s'kemi mundur ta përjetojmë përpara, një delirium.

Po më kujtohen ditët e para kur erdhëm në Prishtinë e bëmë një paradë si ushtarë, nuk e di sa njerëz, nuk e di sa njerëz kanë qenë që na kanë pritë, ka qenë një përjetim shumë i madh për mua, nuk e harroj kurrë. Pastaj filluan të ndryshojnë gjërat.

Më kujtohet një ngjarje absurde për mendimin tim, ishim në një vend me muzikë, po dëgjoja muzikë rok dhe më tha dikush, si ti i UÇK-së po dëgjon muzikë rok, duke e konceptuar UÇK-në dhe ushtarët e UÇK-së krejt me çiftelia dhe që janë rritë krejt në oda, krejt në kulla.

Aty e pashë se një shtresë e njerëzve thjeshtë e kanë parë UÇK-në si diçka të cilës ndoshta s'kanë

pasur mundësi t'i bashkohen edhe pse ka ekzistuar vullneti. Megjithëse në ato rrethana pyetja m'u duk shumë absurde, unë prapë u ktheva dhe e vazhdova jetën si e kam bërë përpara, përpos angazhimeve të mia në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (TMK) që dihet se është pasardhësi i UÇK-së. Në këtë periudhë ne jemi munduar ta rindërtojmë këtë vend, jemi munduar të punojmë, jemi trajnuar, kemi ndihmuar popullin shumë në të gjitha aspektet deri tani po mendoj si organizatë, si ushtri se neve na kanë quajtur organizatë po ne gjithmonë e kemi konceptuar veten si ushtri, po edhe populli ashtu na ka quajtur.

Një kohë jam marrë edhe me rekrutimin do të thotë të pakicave brenda TMK-së, se ne i kemi pasur prej fillimit të rezervuara vendet për pjesëtarët e pakicave, konkretisht për serbët i kemi pasur vendet e rezervuara. Siç e dimë që me marrëveshje janë edhe në parlament vendet e rezervuara, që është një diskriminim pozitiv për dikë dhe diskriminim negativ për dikë tjetër, pa e marrë atë parasysh, unë kam bërë një punë kolosale bashkë me kolegët e mi në TMK, me eprorët e mi që na kanë përkrahur për të rekrutuar serb dhe kemi mbërritur t'i rekrutojmë rreth 200 serb, të cilët janë bërë pjesë e TMK-së. Mirëpo në periudha të ndryshme kohore të gjithë ata, të gjithë pa përjashtim, i janë nënshtruar represionit ndoshta të njëjtë të cilin e kemi kaluar edhe ne si pjesëtarë ose si qytetarë të Kosovës në periudhën e Millosheviqit në Kosovë dhe më herët.

Po e them këtë se edhe ne nuk kemi mundur t'i ndihmojmë, nuk kemi mundur t'i ofrojmë mbrojtje në shumë raste kur serbët, nën ndikimin e politikës së Beogradit i kanë rrahur, i kanë keqtrajtuar, i kanë shantazhuar dhe i kanë kushtëzuar me dokumentacion, me ndihma dhe me gjëra të tjera që gjithsesi ta lëshojnë TMK-në, të dalin prej TMK-së për faktin se TMK-ja është UÇK, janë terroristë e kështu me rradhë. Ne nuk kemi mundur t'i dalim në ndihmë pa marrë parasysh se edhe sot ata njerëz që i kemi rekrutuar kanë qenë të përkushtuar dhe kanë dashur me të vërtetë t'i ndihmojnë këtij vendi duke e ndier veten se janë qytetarë të Kosovës pa marrë parasysh kombësinë. Për këtë brenda punës TMK-ja e ka ndier veten pak keq për faktin se si shtet nuk kemi mundur t'i bëjmë ballë edhe mbas luftës edhe pas kaq viteve represalieve që i kanë bërë prapë serbët.

Po tani me popullsinë serbe në Kosovë që mos të dalë në pah realiteti që është, do të thotë ajo që edhe serbët, edhe qytetarët e tjerë janë qytetarë të barabartë të Kosovës, i kanë të drejtat e barabarta.

7**UNË DUA TË DËGJOHEM!**

8

Bisedë me

Nexhipe Berishën

Gruan e dëshmorit Ruzhdi Berisha, nga fshati Buqe, Opojë.

Si keni jetuar, ju dhe familja juaj gjatë viteve '98-'99? Si i keni siguruar mjetet ushqimore?

Para se të mbërrij tek këto vite, dua ta përmend një rast, ndoshta viti '85 ka qenë, s'po më kujtohet mirë, isha vet e semurë, ishim në Prishtinë, e pata bërë një ultrazë të veshkave. Atehërë në Prizren nuk kishte dhe duhej të shkonim në Prishtinë. Ishte e premtë dhe po kthehesha me autobusin e orës 3 prej Prishtinës, kur mbërritëm në Prizren, një polic serb me teshë civile na ndali te ura, problemi ishte pse kondukteri i autobusit i kërkoi që ta pagujë rrugën, biletën, e ai nuk donte ta pagujë. Ai polici punonte në Zhur dhe kur mbërritëm në Zhur, ai na ndali neve, krejt autobusin.

Ju me kë keni qenë?

Unë kam qenë me Ruzhdinë (bashkëshortin), veç unë edhe një grua tjetër e Begajve (fshat në Opojë), kemi qëlluar femra në autobus. Ishte tetor, dihet vonë shumë, ora 5 e diçka, e ne 1 orë e diçka u ndalëm në Zhur, ndërkohë krejt udhëtarët dolën jashtë. Ata kundërshtuan, dikush prej tyre. Edhe Ruzhdia ishte njëri prej atyre, që nuk mund t'i duronte fyerjet e policëve serb, edhe aty e burgosën Ruzhdinë, prej autobusit e morën dhe e shtinë në stacion të policisë.

Atëherë ishte në Zhur stacioni i policisë.
Unë mbeta vetë atë natë dhe nuk munda të vij në
Bucë te femijët, mbeta në Zhur.

Tek ndonjë i afërm apo?

Po, tek një djalë i tezes së Ruzhdisë. Të nesërmen shkova në Prizren, e lajmërova familjen time, vëllazninë dhe djemtë e axhës së Ruzhdisë, se si ishte rasti.

Sa kohë e mbajtën në burg?

Këtë rastin e autobusit të Opojës e patën bërë pak të madh dhe shumëkushi doli për t'i ndihmuar Ruzhdisë. Ruzhdinë e mbajtën një javë në burg, por dikur e panë se ishte i pafajshëm dhe e lëshuan. Prej atëherë, Ruzhdia i ra atyre në sy dhe e dinin se kush është Ruzhdia.

Sa i përket rasteve të tjera kam pasur iks, iks raste. Një rast edhe po e përmendi. Me siguri ka qenë viti 1988 dhe atëherë ishim bashkë, nëna e Ruzhdisë ishte në spital dhe ne donim të shkonim ta vizitonim se ajo ishte plakë. Ne shkuam dhe e pamë nënën e Ruzhdisë, u kthyem prej Prizrenit dhe po vinim bashkë, isha vetëm unë femër aty. Na ndalën policia te farmakosi, ku rrinin gjithmonë ushtria serbe edhe policia, krejt

aty rrinin gjithmonë bashkë, ata na ndalën neve dhe Ruzhdinë e morën. Ruzhdinë e morën dhe e çuan në burg dhe i thanë Ruzhdisë, shoqja është e lirë, ku të dojë mund të shkojë, se ne ishim me veturë. Ruzhdia tha: “po ku mundet me shku shoqja kur nuk di ta ngasë veturën, nuk ka as leje as kurrgjë dhe unë nuk mundem ta lë shoqen vetëm.

Ata i thanë ke të drejtë shoqen me e çu deri para policisë, edhe veturën lëre aty. Ti, i thanë, kthehesh në polici në burg e shoqja mundet me shku.

A ju jepnin arsye se pse po e burgosin ose pse po e arrestojnë Ruzhdinë?

Po, Ruzhdi Berishës, i kishte dalë emri në ato fletore, aty ku ata i kishin ato të dhëna. Pse i doli emri Ruzhdi Berisha ata e arrestonin. Aty ne shkuam, unë mbeta prapë në Prizren, ishte situatë shumë e keqe, ishte viti '88, shtator apo tetor nuk e di çka ka qenë, familja ime e kishte shtëpinë te lagjia e trimave, në Tusuz sic i thonin përpara. Edhe ata prej aty gjuanin, sepse ushtria edhe policia serbe rrinin aty në atë lagje. Familja kishte shkuar te një motër e imja, edhe aty unë shkova i gjeta vëllezërit, i lajmërova vëllezërit dhe djemtë e axhës së Ruzhdisë. Ruzhdia i kishte djemtë e axhës në Prizren, ata shkuan dhe e lajmëruan Eqrem Kryeziun, i cili atëherë ishte kryetar i LDK-së në Prizren.

Ruzhdia mbeti i burgosur, menjëherë e kishin pas marrë në pyetje, kjo ishte në pasdite edhe ishte e shtunë apo e diel, atëherë nuk e mbajtën Ruzhdinë në burg. Për fat të Ruzhdisë, ishte një malazez aty dhe i kishin thënë të kanë arrestuar, të kanë sjellë këtu pa nevojë. Ai e ka lëshuar, por e ka lëshuar vonë, ishte ora 10-11, mbrëmje, gati gjysma e natës, kur ne atë natë ndenjëm në Prizren. Të nesërmen dolëm me Ruzhdinë për të shkuar në shtëpi. Atëherë, prej aty, Ruzhdisë i është dashur të lajmërohet dy herë në javë në stacion të policisë në Dragash.

Edhe iks, iks raste ka kur Ruzhdinë e kanë ndjekur edhe kur ka qenë vetëm, se e dini Ruzhdia ka qenë deputet prej vitit '92. Të dy afatet u zgjodh Ruzhdia, atij i ka ra shumë shpesh, çdo ditë ka qenë në lëvizje, këtu nëpër komunën tonë, në Prizren, shkonte edhe në Prishtinë dhe Ruzhdia ka qenë gjithmonë i ndjekur.

D.m.th, arsyeja pse ka qenë i përndjekur nga policia ka qenë sepse ishte deputet?

Po, deputet dhe aktivist politik.

Po gjatë viteve '97, '98, '99, si keni jetuar ju dhe familja juaj, çfarë keni përjetuar?

Po familja jonë, gjithmonë kemi jetuar me frikën se apo vjen Ruzhdia, ku mbeti Ruzhdia, çfarë ndodhi me të. Në vitin '92, kur u zgjodh deputet më 3 tetor e kanë plagosur disa fshatarë. Kjo gjë është më me rëndësi.

Fshatarët e fshatit tuaj e kanë plagosur?

Po e kanë plagosur Ruzhdinë. Ajo dihet, ata kanë qenë tradhëtar, spiuna të vendit tonë, kanë qenë në anën e policisë serbe. Ata kanë bashkëpunuar me policinë serbe dhe policia serbe ka shtënë në Ruzhdinë dhe e kanë plagosur. Më 3 tetor '92, Ruzhdia ka qenë i plagosur. Në atë kohë e kanë pas zgjedhur deputet.

Dhe vazhdimisht ka qenë i përndjekur?

Po po, vazhdimisht ka qenë i përndjekur. Familja ime, unë me vjehrrën me fëmijët, po edhe vëllezërit e Ruzhdisë kemi qenë gjithmonë, si...

Të shqetësuar?

Po. Pyeteshim a po vjen, ku është, çfarë bëri, ku mbeti. Atëherë ka qenë edhe problem se nuk kishim si të merreshim vesh, telefona nuk kishim sikur tani që janë celularët.

Sa ka qenë e vështirë t'i siguronit mjetet ushqimore gjatë asaj kohe?

Po për ushqime e kemi shtyrë disi, si krejt. Unë vet kam qenë në punë, se jam punëtore shëndetësore, motër medicinale. Kam punuar që nga viti '79, nuk kemi pasë shumë të ardhura, por ia kemi dalë disi, si krejt të tjerët në atë kohë.

Po anëtarët e tjerë të familjes ku kanë punuar?

Unë kam jetuar me familjen time të ngushtë. Vëllezërit e Ruzhdisë, njëri me familjen e vet, ka punuar si shofer i autobusit atëherë, njëri në Prishtinë me familjen e vet dhe njëri ka qenë në Gjermani.

Përveç si deputet, bashkëshorti juaj, a ka punuar edhe diçka tjetër?

Po prej fillimit ai ka qenë aktivist politik. Kur u formua LDK-ja, ai ka qenë ndër aktivistët e parë. Atëherë u zgjodh deputet, por ndërkohë kur u shfaq UÇK-ja, ai dy herë ka qenë në Shqipëri, për ta formuar ushtrinë tonë çlirimtare.

Ka qënë në vitin '98, në tetor apo nëntor dhe në vitin '99 në janar. Në vitin '98 ka qenë me një shok, atëherë ka ndenjur 3-4 ditë në Shqipëri, pat shkuar kah Maqedonia. Normalisht që ka pasur edhe probleme gjatë udhëtimit për të formuar ushtrinë tonë çlirimtare. Prej atëherë është betuar atje se është ushtar i UÇK-së.

Ndërkohë, këtu nuk e di si i ka kryer punët, se edhe ka qenë ashtu tipi që nuk i ka treguar krejt ato fshehtësitë e punës së vet. Në janar të vitit '99, ka qëndruar dy javë në Tiranë dhe gjithmonë ka qenë në lëvizje, gjithmonë ka qenë aktiv.

Sa ka qenë e vështirë ndjekja e shkollimit nga ana e fëmijëve tuaj në atë kohë?

Po në atë kohë, si gjithkund nëpër Kosovë edhe këtu tek ne, në komunën tonë, shkollimi bëhej në fshatin më të madh të komunës së Dragashit, në Bresan edhe në Bellobrad. Fëmijët e mi, vajza ka mësuar në Bresan, ndërsa djali në Bellobrad. Si të gjithë që kanë pasur probleme, por fëmijët e mi pak më shumë.

Ku e kanë vazhduar ata mësimin? Nëpër shtëpia private apo diku tjetër?

Po, nëpër shtëpia private.

E nëse ju është dashur juve të udhëtoni në atë kohë, a ju është nevojitur ndonjë dokument i veçantë? Sa e keni pasur të vështirë?

Jo, e di që fëmijët kanë pasë probleme me letërnjoftime, e kështu me moshë kanë qenë të rinjë, se pa i bërë 18 vjet, letërnjoftim nuk kanë pasë të drejtë të kenë, e atyre, fëmijëve iu lypnin letërnjoftimet.

Unë vetë kam udhëtuar prej Fshatit Buqe në Dragash dhe kam qenë e vetmja femër e fshatit që kam qenë në marrëdhënie pune, plus asaj edhe më njihnin të gjithë me ushtri me polici serbe se kush jam. Shumë herë nuk mund t'i duroja sjelljet e tyre. Jo që më kanë keqtrajtuar, por gjithmonë më shihnin me ironi. Se është dashur prej fshatit, prej Buqës, ku jetoj, ku edhe atëherë kam jetuar, e deri te tyrbja, aty te stacioni me udhëtu në këmbë.

Më ka ra 5 km me udhëtu vetëm edhe gjithmonë aty ku ka qenë stacioni, kanë qenë edhe ushtria përmbi, por edhe policinë e kemi pas gjithmonë aty të pranishme. Unë duhej prej autobusit me zbrit dhe udhëtoja në këmbë vetëm, e kam pas shumë të vështirë. Shpeshherë thoja unë më nuk shkoj në punë se e kisha një frikë, thoja veç kur të gjuajnë ose kur të vijnë mbrapa meje, vazhdimisht kam qenë me ngarkesa psikike. Por jo, Ruzhdia thoshte me e vazhdu punën, me i ndihmu popullit dhe gjithmonë më ka dhënë kurajo me vazhdu me punu.

**Sa ka qenë e vështirë, qoftë për ju,
qoftë për popullin e rrethinës tuaj,
kur kanë pasur nevojë për ndonjë
shërbim mjekësor, a i është ndaluar
nga policia ose sa ka qenë e vështirë?**

Po normal që ishte problem se nuk kishte ilaç. Edhe atëherë këtu në qendrën tonë ishte kjo ambulancë, kishim edhe mjek shqiptar, por drejtori dhe shumë mjek ishin goran. Një ilaç nuk mund ta merrnim, pa shkuar te drejtori, ai me na e përshkru, ose një terapi nuk mund t'ia jepnim pacientit, pa u lajmëruar te drejtori. Sepse ata bënin dallime, ka qenë shumë problem. Edhe përpara nuk kishte ambulanca private, me e ble terapinë ose ampulën. Normal që kishim probleme. Kishim edhe shumë probleme kur e shihnim se si po bëhen padrejtësitë.

Është shumë interesant edhe një rast, ku në Buqe, ndërmjet ushtrisë çlirimtare dhe ushtrisë e policisë serbe, nuk e di a ka qenë muaji tetor apo korrik nuk po më kujtohet, po e di që ka qenë viti '98. Ruzhdia kur ishte në shtëpi, më binte me veturë në punë. Kur erdhëm ne në punë, se fillonim punën prej orës 7, kur i shohim disa lëvizje, unë i them Ruzhdisë, se po ndodhë diçka në Buqe, ai thotë jo se nuk ka asgjë, ne sa erdhëm prej shtëpisë, e atëherë ai më la mua e mënjëherë shkoi. E njëmend kishte pas në Buqe shumë probleme, se ushtria jonë, duke i sjellë armët prej kufirit të Shqipërisë, kishin gabuar rrugën dhe

kishin shkuar në një fshat të goranve (boshnjakëve) në Rapqe e një grup kishin ardhë në Buqe dhe ata të lodhur ishin strehuar tek një fshatar aty, tek Islam Berisha, që e ka pasur shtëpinë krejt në krye të fshatit.

E ai i kishte pranuar brenda, i ka dhënë edhe ushqim, e ushtria serbe i ka hetuar, dhe aty kishte lindur njëfarë konflikti. Kur shkon Ruzhdia krejt fshatarët ishin mbyllur brenda, sepse sado kudo secili donte të mbrohej. Ruzhdia ka qenë edhe kokëfortë, nuk frikësohej, ka qenë trim dhe shkon drejt e tek policët. Fshatarët shikojnë, thojnë si po mundet të dalë ai ashtu lirshëm.

Ky (Ruzhdia) u thotë policëve çfarë është bërë, ata i thonë se ju e keni ushtrinë këtu, ai thotë jo nuk e kemi. Ata thonë po e keni e ma mirë për ju është t'i dorëzoni. Ruzhdia fillimisht nuk e ka ditur, por ndërkohë e kupton që ka diçka këtu. Atëherë Adem Berisha ngadalë e thirrë Ruzhdinë, kur e panë këta që Ruzhdia po bisedon me ata lidhur me ushtrinë, për këtë problemin e ushtarëve tanë atëherë filluan me dalë edhe fshatarët e tjerë.

Ademi i thotë, Ruzhdi kështu-kështu i kemi punët, por si t'ia bëjmë, si t'iu ndihmojmë. Ky duke bërë muhabet me ta, me policët serb, se Ruzhdia u bë i njohur me ta, e njihnin me policë e me krejt, u thotë, shikoni unë po i ndal policët këtu e ju shikoni nëse mund t'i largoni ushtarët tanë andej, me i nxjerrë kah mali andej nga kanë ardhë.

Edhe ndërkohë kështu ia bën. Ushtarët nuk i dorëzuam ne, po mendoj fshati dhe ndërkohë ata filluan të gjuajnë, edhe ushtria e Serbisë me policë edhe ushtria jonë çlirimtare. Unë isha në punë, nuk dija asgjë. Ne morëm vesh, e kuptuam se çka po ndodhë atje, se zunë edhe fshati të ikë prej Buqes, e plus edhe fshatrat e tjera afër, Breznja edhe Plava.

Po unë vet, si grua thashë ku e kam familjen kam me shku edhe unë. E dija që Ruzhdia nuk largohet me e lëshu shtëpinë, fshatin. E i hipa autobusit e po shkoj. Kur po shkoj aty, Ruzhdia i kishte marrë leje atyre, i kishte thënë unë e kam gruan në punë nuk mund ta lë vetë rrugës, po më jepni leje të shkoj ta marr gruan e ta sjell në shtëpi. Ata e kishin lëshu e i kishin thënë shko merre. Ruzhdia erdhi me më marr, e shkuam bashkë. Kur shkuam, ushtria, dy tanke të ushtrisë serbe e atëherë ka qenë e vështirë me i pa na tanket, sidomos fëmijët, se ne nuk kemi pas rast me i pa, edhe e kishin pas rrethuar fshatin.

E atëherë aty e vrasin një komandant të ushtrisë serbe dhe i plagosin dy policë serb. Po ndërkohë ushtarët tanë duke u larguar, edhe ata plagosen, njërin e kemi gjet dy javë mbasi ka ndodhë rasti, në një livadh aty te ne, njërin e kanë gjet kah Breznja, ishte nis rrugës me shku për Zhur, ka Breznja kishte kaluar i plagosur edhe atë e kanë gjetur mbas një jave.

E ata dy ushtar kanë mbetur të vdekur prej plagëve, nuk ka pas kush t'i japë ndihmë. Edhe aty ka qenë një, lirisht mund ta quajmë, luftë.

Ndërkohë ushtarët i kemi strehuar ne nëpër shtëpitë tona. Ne dy ushtarë i kemi pasur të strehuar në shtëpinë tonë. Njëri i Vlashnjes, njëri i Prizrenit. Të nesërmen, normalisht iu dhamë ushqim atyre, teshat ia ndërruam, që mos t'i linim me ato tesha të shkyera, kah kanë udhëtuar në këmbë, s'di sa kilometra prej Shqipërisë e nëpër kufi, si ka qenë rruga atëherë.

Të dy ushtarët, njërin e morëm ne me veturë, unë e Ruzhdia dhe e çuam deri në Prizren, njërin e lamë në shtëpi, i thamë po shkojmë në Vlashnje po t'ila jëmërojmë të familjes e ata le të vijnë e të të marrin se krejt bashkë ashtu nuk mujtëm me i marrë dhe me i çu. E morëm atë ditë edhe vjehrrën, edhe unë e Ruzhdia dhe atë ushtarin e çuam në Prizren, deri në hyrje të Prizrenit. E vet ai ushtari kur i pa policët tha unë deri këtu, e tash po hyj këndeje nëpër ara, e po iki po shkoj disi në shtëpi, se rrugës nuk guxua, e ai edhe vet nuk guxoi me shku nëpër polici. Gjatë këtij rasti, e patën marrë njëherë këtë Islam Berishën, ky ka qenë plak dhe pensioner.

A ka qenë ky ai që i ka strehuar ushtarët?

Po ky ka qenë, që i ka strehuar. Edhe djemtë e Islamit i kërkonin, por ata ikën, kah Zaplluxhja, dolën në Maqedoni. Islamin e patën marrë, e patën burgosur dhe e patën rrahur shumë, pastaj e patën dërguar në spital, duke menduar se do të vdesë. Aty ka qenë një mjek i yni opojali dhe nipin e ka pasur në spital.

Ky i ndihmoi, ashtu të sëmure e kapën me autobus dhe e dërguan në Austri, se ky ishte pensioner i Austrisë, i cili shkoi atje dhe u shërua. Ndërkohë policia e patën marrë Ademin dhe Jetonin.

A kanë qenë këta djem të Islamit?

Jo, Ademi ka qenë djali i vëllait të Islamit e Jetoni ka qenë fshatar. Atëherë i burgosën edhe Ademin edhe Jetonin. Ademin e rrahën shumë, aq shumë e rrahën, sa që prej torturave të mëdha, ai vdiq në spital në Prishtinë. Jetoni shpëtoi, ndërsa Ademi vdiq në vitin '98.

Si e keni përjetuar shpërnguljen masive të popullit nga shtëpitë e tyre? A ka qenë edhe familja juaj një ndërata?

Po, shpërngulja ishte katastrofale. Të dielën erdhën djemtë e tezes së Ruzhdisë tek ne. Kemi pasur në atë kohë dy familje të Zhurit.

Që janë strehuar te ju?

Po, janë strehuar tek ne. Nuk donin të dilnin në Shqipëri duke menduar se Opojën po e lënë më të qetë edhe ata erdhën tek ne. Ata ndenjën 4 ditë dhe kur erdhi e mërkurja, neve po na shpërngulnin. Dy ditë pa u shpërngulur, ishte e hënë, Ruzhdia shkoi në Buzes, të bisedonte me shokët e vet se si do t'ia bëjnë që të mos vijë puna deri tek shpërngulja, se ne i shihnim edhe në televizor që i shpërngulnin, si në Prizren dhe Zhur dhe anë e mbanë Kosovës.

E hënë, e martë, e mërkurë, na shpërngulën edhe neve dhe na përzunë prej shtëpisë me dhunë. Krejt filluam të largoheshim, unë i kisha tre fëmijë, e vjehrrën nuk e kisha në shtëpi. Vjehrra ishte në spital, e sëmurë, se vjehrra 93 vjet i ka tani, atëherë i ka pasur 80 e disa vjet.

Vjehrra e sëmurë, si të rrinte në shtëpi, po edhe në Shqipëri si të shkonte, kur Ruzhdia kurrsesi nuk donte ta lëshonte fshatin dhe shtëpinë e vet dhe krejt Kosovën me një fjalë.

Donim edhe ne të rrinim, por ai tha shkoni ju, se për mua nuk është problem, ia bëj disi, dal me shokë, këndeje nga bjeshkët, e ju shkoni kah po shkojnë krejt fshati. Unë për shkak të fëmijëve është dashur të shkoj me fëmijët se ata kanë qenë të rinjë. Vajza i ka pasur 19 vjet, as 19 të plota nuk i ka pasë, djali 18, ky i vogli 10, për 11 vjet ka qenë. Për shkak të fëmijëve shkova edhe unë. Në atë kohë i kemi bërë dy ditë rrugë, ishte e mërkurë, jemi nisur pasdite me traktor të kunatit tim, me djemtë e tij dhe me kunatën. Atë natë kemi shkuar deri diku, natën e kemi kaluar në traktor. Kemi udhëtuar ditën e enjte. Prapë tërë ditën e kemi kaluar në traktor.

Të premtën në mëngjes kemi mbërritur në Kukës, d.m.th., dy ditë e dy net kemi ndenjur në traktor. Kur kemi shkuar në Kukës, rrëmujë e madhe, ishte krejt Kosova aty. Por dikur u strehuam në një katund rreth Kukësit, në Shtiqën. Aty ishim me kushërinjtë, 50 e disa anëtarë kemi jetuar në dy dhoma. E kemi pasur pak problem, jo pak por shumë problem, plus asaj unë si nënë e fëmijëve dhe po ashtu edhe fëmijtë nuk e kanë pasur të lehtë, se kanë qenë të rritur dhe kanë ditur.

D.m.th ju nuk e dinim se ku ndodhej bashkëshorti juaj?

Ai mbeti në shtëpi dhe ne nuk e dinim çka u bë me të, se ku është. Në Shtiqën kemi qëndruar dy muaj e gjysmë. Më 31 mars na kanë larguar prej shtëpisë, më 15 qershor jemi kthyer në shtëpi. Kur jemi kthyer në shtëpi, katastrofë, asgjë nuk e kemi gjetur në shtëpi, plus asaj nuk e dinim se ku është Ruzhdia, se Ruzhdinë nuk e gjetëm në shtëpi.

Gjatë kohës sa keni qëndruar si refugjatë në Shqipëri, sa e keni pasur të vështirë të siguronim mjete ushqimore ose mirëmbajten e higjienës?

Po e kemi pasur të vështirë se njëherë nuk kishim ndihma, krejt duhej t'i siguronim vetë, të hollat që i morëm me vete, duhej t'i shpenzonim, derisa filluan të na jepni ndihma. Po ka qenë e vështirë, si refugjatë, kuptohet. Edhe 50 e kusur anëtarë kemi qenë me dy dhoma.

**Gjatë gjithë kohës sa
keni qëndruar atje nuk
keni marrë asnjëinformacion
se ku ndodhet bashkëshorti juaj?**

Vinin lajme, lajme jo të sakta. Thonin jo e kemi parë këtu, jo ka shkuar në ushtri, jo andej, jo këndej. Ato kishin qenë krejt lajme jo të sakta.

**D.m.th pas dy muaj
e gjysëm jeni kthyer?**

Po jemi kthyer.

Me çfarë jeni kthyer?

Me traktor prapë, atë traktorin që e kishim. U kthyem mirë, u gëzuam që po kthehemi në shtëpi, por kur erdhëm në shtëpi ...

Si e gjetët shtëpinë?

Shtëpinë e gjetëm katastrofë, por... për shtëpi nuk ishte problem, por kur nuk e gjetëm Ruzhdinë...

Kur jeni kthyer...?

Po, kur u kthyem prej Shqipërisë e pamë që Ruzhdia nuk ishte, prisnim hajt se mos është diku, mos po lajmërohet, por ai nuk u lajmërua. Filluam ta kërkonim andej-këndej, mos është i burgosur, por jo. Shkonin, dilnin ta kërkonin mos është i mbytur, shikonin nëpër pusa mos e kanë mbytur dhe mos e kanë gjuajtur, por as aty nuk u gjet. Kaluan dy muaj duke e kërkuar nëpër Buqe, por më kot.

Prisnim se mos po lajmërohet diku vetë, kur më 16 shtator, ish-ushtarët, që kanë qenë ushtar...

Po ushtarët që kanë qenë në UÇK kishin ardhur prej Shqipërisë dhe kishin lajmëruar se e kanë gjetur një kufomë në kufi të Shqipërisë, po ata normal që nuk e kanë njohë dhe nuk e kanë ditë dhe kishin lajmëruar në Brezne. Ata Brezjantë, ushtarët e UÇK-së së Breznes kishin dalur të shohin se kush është dhe e kanë njohur që është Ruzhdia dhe atë ditë, ka qenë 16 shtatori, kanë ardhur te shtëpia ime.

I kishin marrë këpucët dhe teshat e tij për ta identifikuar se a është Ruzhdia apo jo. Ishte pasdite kur i sollën, thanë këto a ta merr mendja, a mundesh me i njohë a janë teshat e Ruzhdisë. Unë normal që i njoha teshat, i njoha edhe këpucët dhe atëherë e gjetëm Ruzhdinë të mbytyr. Më 17 shtator ata shkuan dhe e morën kufomën, e çuan në morg të Prizrenit, atëherë në Rahovec e bënë atë ...

Autopsinë...

Po autopsinë. Pastaj e sollën në kazermën tonë aty te Zymi, ku ka qenë burgu i Dubravës, e mbajtën deri me 19. Më 19 shtator, e sollën kufomën në fshat, në oborr. Aty erdhën të gjithë miqtë dhe më 19 shtator e varrosëm Ruzhdinë, aty në fshat, në Buqe. Ka qenë diçka që nuk mund ta marrë me mend askush. Kemi pasur miq dhe ushtri prej krejt vendit, të Kosovës, Maqedonisë, Shqipërisë. Mund të them që rreth 10.000 vetë kanë marrë pjesë në varrim.

8**UNË DUA TË DËGJOHEM!**

9

Bisedë me

A.S.

I përndjekur nga policia serbe, si intelektual, si profesor dhe si drejtor shkolle gjatë viteve të 90-ta dhe refugjatë në Shqipëri

Na tregoni përjetimet tuaja gjatë viteve të 90-ta?

Po çfarë të them se vitet 90 janë të mbushura me plot përjetime, me plot ngjarje të ndryshme, sidomos me probleme të ndryshme politike, ndërsa siç e dini edhe ju edhe i tërë opinioni ndërkombëtar, Kosova nga vitet e '90-ta u pushtua nga Serbosllavia e asaj kohe dhe normalisht çdo pushtim si i tillë nuk sjell gjëra të mira, por vetëm gjëra të këqija.

Si keni jetuar ju dhe familja juaj gjatë këtyre viteve?

Po si çdo familje shqiptare, po ashtu edhe familja ime. Koha e pushtimit ka qenë një sfidë, përveçse një sfidë për ekzistencë, ta quaj kështu njerëzore, ka qenë edhe ekzistencë politike në plotkuptimin e fjalës dhe kjo ekzistencë politike ka qenë një çikë më e vështirë, se je përballur me një pushtues me të cilin as mendja njerëzore nuk ka mundur ta paramendojë se mund të jetë aq i vrazhdë. Në atë kohë kemi jetuar në një sistem të ish-Jugosllavisë duke aluduar se ligjet nuk thyhen dhe se kushtetuta nuk thyhet, por ja që ndodhën gjëra të cilat më të vërtetë mendja njerëzore nuk ka mundur t'i paramendojë, ku ligji u bë dhunë dhe dhuna u bë ligj dhe në këto rrethana ka qenë shumë e vështirë edhe ekzistenca edhe mbijetesa.

A keni qenë të punësuar gjatë viteve të '90-ta?

Po, unë kam themeluar marrëdhënie pune fillimisht në vitin 1981-1982 dhe faktikisht në vitin '89, në një shkollë speciale. Ajo shkollë e kishte emrin "Spiro Mojsic" dhe ka qenë e vetmja shkollë në ish-Jugosllavi për nxënësit në gjuhën shqipe. Në atë kohë filluan këto ndryshime politike në Serbi për të aneksuar Kosovën dhe në këtë kontekst pra, nëpër të gjitha institucionet e Kosovës, ku ishin drejtorët shqiptar nëpër institucione, tentonin që drejtorët shqiptar t'i shkarkonin në forma të ndryshme dhe në këtë aspekt, aty ku paraqitej rezistenca atëherë me dhunë i largonin dhe në ato rrethana ish-kuvendi i Serbisë e suprimoi kushtetutën e Kosovës dhe e nxorri një ligj mbi masat e posaçme dhe nëpërmjet atij ligji, ta quaj në thojza, i shkarkuan pothuajse të gjitha institucionet e Kosovës.

I shkarkuan njerëzit që i udhëhiqnin këto institucione, duke ia filluar prej televizionit të Kosovës, institucioneve arsimore, shëndetësore etj., në këtë kontekst i erdhi radha edhe shkollës speciale ku isha edhe unë drejtor dhe më 4 Janar të vitit 1991 u aplikuan masat e dhunshme klasike.

Në shumicën e institucioneve u patën fut vetëm masat klasike, u patën fut masat e dhunshme, por ta quaj pak më heshturazi, më qetë. Por në këtë rast gjersa u aplikuan masat e dhunshme, policia shumë

shpesh më bezdiste, madje pothuajse 20 e disa herë më morën në të ashtuquajturat biseda informative që në atë kohë ishin ashtu të përcaktuara nga institucionet e serbosllavisë dhe më 4 Janar kur u aplikuan masat e dhunshme nga kuvendi i Serbisë i asaj kohe, se u suprimua autonomia e Kosovës dhe për çudi, për çudinë time se nuk e besoja se në atë mënyrë të vrazhdë do të silleshin policia, diku rreth 7 policë kanë qenë, kanë qenë dy persona nga personat zyrtarë, avokatë shoqëror, nuk e di si i quanin në atë kohë prej Serbisë dhe e kumtuan vendimin mbi shkarkimin tim.

Normalisht se unë nuk e pranova një gjë të tillë dhe iu thashë atyre se mua ka të drejtë të më shkarkojë vetëm organi i cili më ka zgjedhë dhe organi i Serbisë nuk më ka zgjedhë. Mua më ka zgjedhë Kuvendi i Kosovës dhe në momentin që e dëgjuan ata, ia përkthyen serbve, m'i lidhën duart, më morën 7 policë dhe në një gjendje mizore ku fëmijë, nxënësit dolën duke qarë.

Madje ka qenë një pastruese, ne i thonim halla Kadishe, më krijon një emocion të veçantë dhe kur e shikoj atë duke qarë i them unë me këto fjalë: “halla Kadishe do kthehem unë sërish, do kthehem këtu”. Ishte po them, një trishtim jashtëzakonisht i madh se nuk mund ta mendoja në atë mënyrë, një person, një drejtor i cili me ligjin e asaj kohe ishte person me autorizime të veçanta dhe të ushtronin mbi të një farë dhune, një farë terrori në këtë mënyrë dhe në organet e policisë më mbajtën 8 orë me format më të vrazhda

të ofendimeve, të sharjeve në baza kombëtare dhe njerëzore dhe me fjalë tjera ka qenë një tmerr shumë i madh. Pas aplikimit të masave të dhunshme më 4 Janar, filluan të më orientonin, të më gjenin një vend gjoja pune në thojza të them. Unë me profesion kam qenë profesor i sociologjisë dhe duke pasur ata pretekstin se unë nuk do ta pranoja detyrën e vendit të punës që do të ma caktonin ata, më përcaktuan si profesor të fizikës, që nuk ka të bëjë fare me këtë.

Edhe një person, jo vetëm shqiptar, por një njeri i cili katribute njerëzore nuk mund ta gëlltitë një gjë të tillë, pavarësisht prej çmimit që do të kishte pasur dhe mbas 4 ditësh policia erdhi prapë, më arrestoi në shkollë, se me aplikimin e masave të dhunshme i larguan vetëm 7 punëtorë njëherë, e mua nuk më larguan, por vetëm më shkarkuan dhe mbas 4 ditësh, pasi është dashur të merren instruksionet nga Beogradi, mua prapë edhe do kolege, të cilat kanë qenë të gjinisë femërore dhe sekretarin e shkollës na arrestuan sërish dhe na dërguan në polici dhe për mua ka qenë një trishtim jashtëzakonisht i madh, ka qenë një vrasje dhe nëse mund të shprehem në këtë mënyrë, përveçse e vrasin viktimën, e sakatojnë në atë kuptim, por edhe si të vdekur gjuajnë dhe në atë kuptim nëse mund të them në mënyrë ilustrative.

Aty erdhi një kolege serbe dhe u tha atyre se “ky është ai ish-drejtori të cilin e kanë shkarkuar dhe këto janë kolegët që shkojnë pas këtij lideri, pas këtij separatisti” dhe del polici me një automat më kapë

mua për fyti dhe ato kolegët fillojnë të qajnë dhe me fjalët më banale, që ajo kolegia, njëra ka qenë më e vjetër nga unë, me fjalët më banale, që as kanibalët nuk përdorin ashtu fjalësh. Nuk e di e kam përjetuar shumë keq atë rastin e saj kur e kanë ofenduar me fjalë që nuk mund t'i përdori zhargoni njerëzor.

Kështu që ka qenë një situatë jashtëzakonisht edhe trishtuese edhe shokuese dhe karakteri im nuk ka leju, nuk ka guxu ta dëgjojë një ofendim të tillë, një sharje të tillë ndaj një femre, pavarësisht çfarëdo të ishte ajo, madje le të ishte edhe serbe dhe normalisht pasi ato i ndalën për 2 orë, megjithatë mua edhe 5 orë tjera më mbajtën me sharje, me fyerje dhe bashkëshortja tani e ndjera, kishte marrë informata te shpia dhe e dinte se policia po më bezdisë.

Edhe pasi më lëshuan, kontaktonim ne se në ato rrethana filluam t'i formonim dhe themelonim sindikatat e pavarura për ta mbrojtur jo vetëm çështjen kombëtare, por edhe të punëtorëve të cilët ishin në marrëdhënie pune dhe i patëm marrë disa vendime nga niveli qëndror, pra atëherë ishte kryetar i sindikatave Hajrullah Gorani dhe në këtë kontekst krijuam disa institucione paralele, për të mbijetuar, edhe si shoqëri, por edhe si arsim shqiptar.

Edhe pas këtyre rrethanave unë zakonisht i mbaja konferencat për shtyp se më të vërtetë është dashur ta alarmonim këtë situatë politike dhe këtë terror serb dhe i pata bërë një letër qarkore të gjitha shkollave të ish-Jugosllavisë, terrorin të cilin na e bënë serbët të

instaluar dhe në momente të caktuara kur unë mbaja konferencë për shtyp dhe ata hetonin diçka, sërish nesër më ftonin në biseda informative, diku në ato vite pra '90-91, deri në mars të vitit '91, kam qenë i ftuar në afër 27 biseda informative dhe kisha fatin brenda asaj periudhe kohore, të kontaktoj edhe me kryetaren e federatës së Helsinkit të Austrisë, Kristina Fonkol, madje ma dha edhe vizitkartën e saj dhe bisedën që e kisha unë më të, madje ajo e njihte edhe gjuhën serbo-kroate, e njihte mirë.

Në bisedën që e kisha me të ajo më tha mua që janë të vërteta këto që po i thua ti, por neve na nevojiten fakte, dokumentacione dhe fatmirësisht në dy thirrje të bisedave informative i kisha me vete dhe në momentin që ia dhashë asaj, ajo u shokua me të vërtetë. Në ato rrethana kur e vërejta atë fytyrën e saj të shokuar d.m.th, e pashë që dikush do të na mbrojë dhe mora njëfarë guximi më të madh në atë kuptimin e përhapjes së pikëpamjes politike për të mbrojtur shkollën, për të mbrojtur arsimin, për të mbrojtur Kosovën.

Duke menduar se këta janë ndërkombëtar, se do të kem një masë mbrojtëse, pasuan akoma më tepër bisedat informative, sidomos pas ardhjes, pas kontaktimit me Krisitina Fonkol. Edhe një takim e kishim me shumë zyrtarë të institucioneve të Kosovës, me kryetarë të lartë të nivelit qendror, me Jusuf Dedushajn e shumë të tjerë me një lokal "84" në atë kohë. Erdhën e më kërkuan policia se u larguam

prej atij lokali dhe një profesor i imi i nderuar, Enver Bahtiu më tha: “ik drejtor ik se po të kërkojnë policia” dhe në një farë mënyre u bëra prapë tebdil i mbuluar, i maskuar dhe nuk më arrestuan, nuk ia arritën dot. Pastaj të gjitha shkollat e tjera filluan organizimin se nëpër shkolla të mesme u dëbuan të gjithë nxënësit nga shkollat.

Ndërsa shkollat fillore, meqenëse shkolla fillore ishte e obligueshme, atëherë nuk kishin mundësi tjetër si të veprojnë edhe pse edhe aty bënëin kërdi. Por në shkollat e mesme e kishin pak më lehtë, se nuk ishte e obliguar dhe e domosdoshme me ligje të asaj kohe, atëherë të gjithë nxënësit shqiptar dhe profesorët u dëbuan dhe ne e patëm themeluar këtë, Lidhjen e Arsimitarve Shqiptar, si institucion paralel dhe filluam mësimin nëpër shtëpia private dhe e legalizuar këtë nëpërmjet Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptar dhe aktivitetit të drejtorit të atyre shkollave, ku u mblodhëm 41 drejtorë.

E tani unë ku isha drejtor i asaj shkolle, e cila ishte e vetmja shkollë në ish-Jugosllavi për fëmijë me të meta në të folur dhe të dëgjuar, atëherë është dashur të merren disa hapa se çfarë të bëhet me këta fëmijë. Nëse ata janë të hendikepuar, nuk dëgjojnë dhe nuk flasin, nuk e dëgjojnë gjuhën shqipe dhe tentojmë t’iu mësojmë gjuhën shqipe, atëherë si këta fëmijë të diskriminohen dhë në këtë kuptim ta mësojnë gjuhën serbo-kroate, meqenëse kishin njëfarë të mete të këtyllë, njëfarë hendikepi.

Në kontakt me kryetarin e Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë, të atëhershëm, Rexhep Osmanin, ai më thotë mua me një fjalë: “drejtor ti e din më së miri se si do ta hapësh shkollën”. Kështu që në vitin '92 e hapëm shkollën private në një xhami të lagjes “Kurilla”, e cila është një lagje në periferi dhe fillimisht e hapëm me tre mësonjëtor dhe bëmë njëfarë mësimi rrëshqitës dhe disi e kordinuam punën me shkollat e tjera.

Donim t’iu tregonim që edhe fizikisht edhe psikikisht, shkolla shqipe do të frymojë, do të ekzistojë edhe për këta fëmijë. Të gjithë përfaqësuesit ndërkombëtar të cilët vinin në institucionet tona paralele kontaktonin kryesisht edhe me mua se ishte e vetmja shkollë në gjuhën shqipe ku dhuna dhe terrori përhapej tek nxënësit normal dhe në mesin e tyre terrorizimin e kanë bërë edhe me nxënësit që ishin të hendikepuar.

Kjo tregonte për vetë faktin se çfarë barbarie, me çfarë okupatori kemi pasur të bëjmë. Në ato lëvizjet tona si veprimtar, por edhe si punëtor të arsimit fillor, njerëzit përgatiteshin në një formë ndoshta më radikale të lëvizjes sonë paqësore edhe arsimore edhe edukative edhe politike etj. Në vitin '93 ndodhë edhe një ngjarje e trishtueshme, ku në atë lokalitet policia i bastisë disa familje dhe i burgosë nja 6-7 hoxhallarë, se patën gjetur armë, me pretekstin se do të bëhet kryengritje ndaj pikave serbe, ndaj institucioneve serbe dhe vijnë policia dhe futen në xhami ku e mbanim ne mësimin dhe fëmijët u trishtuan.

Unë kryesisht fëmijët i kisha të regjionit të Prizrenit, se natyra e shkollës ishte e tillë që duhej të ishin të mbuluar edhe me internat. E ne nuk kishim mundësi në ato rrethana, por duhej të frymonte edhe kjo shkollë, për këta nxënës, që i kishin këto të meta dhe unë pa kurrfarë vendimi nga institucionet tona e ndërpreva mësimin për një javë dhe i kemi marrë fëmijët dhe menzi i kemi strehuar nëpër shtëpia tjera aty afër dhe ata filluan të qajnë.

Pastaj ishte një situatë jashtëzakonisht e vështirë, se me prindërit e fëmijëve të cilët ishin të regjionit të Prizrenit, kryesisht nga Suhareka dhe rrethi i Prizrenit, këndeje kishin dëshirë t'i binin fëmijët në shkollë, por këndeje frikësoheshin për shkak të rrethanave të cilat patën ndodhë. Por megjithatë ata prind thanë: “ku janë fëmijët e të gjithë Kosovës edhe fëmijët tanë do të jenë”.

Me këto fjalë, më dhanë mua një kurajo të madhe, me të vërtetë, ishte edhe emocionale kjo. Dhe filluam, kështu që deri në vitin '93-'94 unë isha drejtor i asaj shkolle dhe pastaj u shkarkova vullnetarisht se u lodha, edhe rrethanat ekonomike vinin gjithnjë duke u vështirësuar dhe nëse nuk e ke një mirëqenie të mirë familjare atëherë nuk mund të jesh edhe i denjë, i aftë për t'i menaxhuar 30 e disa punëtor dhe vazhduan peripecitë e tjera.

Si e keni përjetuar shpërnguljen masive të popullit nga shtëpitë e tyre? A ka qenë edhe familja juaj një ndër ato?

Shikoni, populli shqiptar në përgjithësi do të thoja është popull hero botëror, se ka përjetuar një katrahurë jashtëzakonisht të vështirë dhe të rëndë. Mendoj që nuk kanë përjetuar edhe popujt tjerë, pavarësisht hebrenjtë. Po kjo historia moderne e shoqërive tregon se më të vërtetë barbaria nuk ka fund. Të largohesh nga vatrat tua është një tmerr shumë i madh, ku i kemi stërgjyshërit tanë, ku i kemi varret tona, trojet tona.

Policia filloi të bastiste nëpër lagje, kryesisht i ndiqte intelektualët, i ndiqte personat të cilët merreshin me një veprimtari, me një aktivitet politik për çeshtjen kombëtare. Unë banoja në një lagje, ku është lagjia më e madhe e qytetit, i thonë “Ortakoll” dhe ata më kanë kërkuar dy herë rradhazi te shtëpia, nuk kanë mundur të më gjejnë.

Njëherë tjetër i kam pasur fëmijët duke ngrënë mëngjes dhe e ka lajmëruar babëgjyshin disi shoqja dhe kanë ardhë fëmijët, se vetëm patën lajmëru se ata prapë do të vijnë këtu dhe i patën marrë fëmijët ashtu të vegjël dhe i kanë larguar nga shtëpia dhe e kanë thyer derën. Brenda çfarë kanë gjetur e kanë shkapërderdhur, ishin aty edhe disa libra të cilat i kanë shkapërderdhur.

Dhe në mbrëmje, vij unë vetëm tek shtëpia aty, shoh rrëmujë, të gjitha gjërat që i kanë bërë aty, se në shtëpinë time janë mbajtur nja dy-tri mbledhje të Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptar dhe kështu që shtëpia ka qenë pak e fokusuar në atë mënyrë dhe i kanë njohur ata personat që kanë qenë në shërbim të çështjes kombëtare dhe zakonisht i kanë djegur ata në forma të ndryshme, aty ku kanë arritur për t'i zënë.

Dhe në momentin kur ka tejkaluar dhuna, kur marrëveshjet politike nuk sillnin rezultate, Serbia gjithnjë e më shumë bëhej e vrazhdë. Ushtria dhe policia filluan të depërtonin nëpër lagje të Prizrenit, madje në një lagje, pranë rrugës ku isha unë, i dëbuan disa familje dhe atë shtëpinë e një shokut tim, Agron Dakaj e bënë si shtëpi ku e vendosën të gjithë arsenalin ushtarak që e kishin aty, ngase i frikësoheshin situatës se Serbia me arsyetimin se nuk do të bëjë kurrfarë marrëveshje dhe Nato-ja normalisht do të merrte masat e duhura për t'i bombarduar ato caqe.

Dhe kjo ndodhi, filluan sulmet e Nato-s pra, të kësaj Aleancës Veri-Atlantike, nuk po më kujtohet me sa mars, dhe Serbia filloi edhe më me këmbëngulje të përdorë dhunën, pothuajse në të gjitha lagjet e periferisë së qytetit.

Me datën 2 apo 3 prill, pjesa periferike e ish kazermave, kanë qenë nja 12 anëtarë të një familjeje, të cilët i kam strehuar në shtëpinë time, dy net kemi qëndruar aty, se me të vërtetë u bë një dhunë shumë e madhe, se policia vazhdimisht frekuentonte aty

pari e fëmijët ishin të vegjël dhe ata sa herë që i shihnin fëmijtë, i nxirrnin hangjarët e tyre, u thonin se do t'iu prejmë edhe juve kështu etj. U detyruam të largoheshim tek një lagje tek nëna ime andej kah spitali, ku madje kanë qenë edhe celulat e para të UÇK-së në atë lagje aty, dhe njerëzit që më njihnin, se unë kam lindur në atë lagje, për çdo mbrëmje parashtronin pyetje të natyrave të ndryshme, se çfarë do të bëhet, si do të bëhet, dhe në momentin e caktuar nëse unë isha i mërzitur, disi humbte disponimi i gjithë atyre, në momentin që më shihnin se jam pak i disponuar mendonin se kemi informata të mira, pra isha në një farë formë një pikë referuese për krejt atë lokalitet aty.

Dhe për një fat të keq timin edhe të gjithë neve, unë e kam pasur një shok të studimeve, shok të ngushtë, të cilin policia ushtarake e Serbisë, e patën arrestuar, e patën çuar në Dragash, pat hapur istikame dhe pas tri ditësh më vjen lajmi se e patën mbytur atë.

Dhe në momentin që e marr lajmin, axha im, tani prap i ndjeri, se shumë njerëz tani kanë vdekur brenda kësaj periudhe të caktuar, e sheh se ishte plak, e sheh policinë dhe ushtrinë duke më kërkuar, ku është ai drejtori dhe ai vjen e me thotë mua "shiko, largohu, largohu".

Prapa shtëpive ka pasur vreshtë rrushi dhe unë iki dhe largohem në vreshta dhe mendoja tërë natën çfarë veprimi të marr tani e tutje. Se të largohesh nga shtëpia, nga atdheu, nga vatani, madje të marrësh

vendime vendimtare, për të qenë apo mos qenë, është një situatë jashtëzakonisht shumë e vështirë dhe shumë e rëndë, se po vendos për fatin e dikujt dhe nuk e din se çfarë po të pret minutë pas minuti.

Kështu që në mbrëmje i mblodha, e mblodha të gjithë lagjen dhe iu them me këto fjalë: “Shikoni, ju e keni vërejt që edhe policia edhe ushtria më kanë kërkuar, unë iu bëj më dije...

... unë nuk e di a e kam mirë, por mua më duhet të largohem sa më shpejt. Kah Maqedonia asesi, por duhet të largohem kendej kah Vërmica e mënyra e largimit si do të jetë edhe unë vet nuk e di.

Por kam një obligim moral, njerëzor, shoqëror që t’ju lajmëroj juve dhe kjo fjalë e imja i tronditi të gjithë ata dhe nesër në ora 9, ka qenë ditë e enjte dhe datën nuk e mbaj mend saktësisht dhe kur e kam vërejtë unë, kolonat e makinave, diku rreth 36 makina të mbushura e të stërmushura. Vetëm 4 pleq kanë mbetur në lagje atje, krejt me lot në sy kemi shkuar.

Në momentin që vendosëm me shku në Shqipëri, siç e theksova u mbush rruga me vetura dhe njerëzit kishin marrë ato bagazhet e veta, të cilët kanë menduar se mund t’i marrin me vete. Unë e pata lëshuar mjekrën, e pata bërë të madhe dhe e kisha hallin tani tek dogana.

Kur kam ardhur në doganë d.m.th, kolona ka qenë diku rreth 2 km, plus njerëzit të cilët ecnin në këmbë dhe kur kemi arritur tek pjesa e doganës aty, na i kanë kërkuar të gjitha dokumentat, në momentin kur u

afruam afër kufirit dhe filluan të na kërkonin policët dhe ushtria dokumentacionin të cilin e kishin me veti, unë e kisha pasaportën e ish-Jugosllavisë, e dorëzova atë dhe ma shkyen në praninë time dhe të familjes.

Ndërkohë një polic i Prizrenit, me emrin Nebojska, i cili ka pas luajtur futboll me mua në atë kohë të ish-Jugosllavisë së dikurshme, nuk ka mujt fillimisht me më identifiku, mirëpo në momentin që unë e tejkalova kufirin dhe po hyj në zonën neutrale veç ka fillu të shajë, bërtasë “kthehu kënde, kthehu kënde”, duke e përmend emrin tim dhe kur kam dalë në atë anë, disi e krijova njëfarë qetësie shpirtërore.

Dy ditë para se me dalë arritëm në njëfarë ure pranë kufirit, ku kishte plasë një minë, kishin pësuar vdekjen disa njerëz dhe në momentin që kisha njëfarë qetësie shpirtërore, posa u afruam në atë vend të ngjarjes ku kishte pëlcitur mina, njëri ma përkujtoi, tha këtu është ai vendi dhe mu krijua prapë një shqetësim dhe pritnim tani të gjithë matanë, d.m.th, arritëm në tokën shqiptare, në vendin amë dhe i pritëm të gjithë ata të cilët ishin nisur me mua, diku rreth 34 apo 36 vetura.

Natën e parë e kemi kaluar në tenda, në Kukës dhe qëllimi im dhe ideja ime ishte se meqënëse i lëshuam vatrat tona, vështirë se do të kthehemi mbrapa. Shoqja ime e ndjerë, i kishte dy vëllezër në Zvicërr, tentonim të kontaktonim me ta, në njëfarë mënyre me dal në botën perëndimore dhe posa arritëm në Kukës, dhamë informatën, nëpërmjet mjeteve të informimit

të Kukësit, se filan fisteki e kaluan kufirin, se për fat të keq më pat mbetur vetëm vëllau i madh, i cili nuk kishte mundur të dalë. Atë e kishin larguar policia, e ndërprejnë kalimin e njërzëve për në Shqipëri dhe unë mbeta me brengën e vëllait se familja ime dhe të gjithë të lagjes kaluam në atë anë dhe të nesërmen u nisëm për në Elbasan, ku u patëm vendosur në tendat, të cilat i pat organizuar një shoqatë humanitare e Turqisë.

Nëpërmjet shoqatës për refugjatë në Shqipëri, tentonim të dilnim në përfundim, në Zvicërr, por vetëm vjehrra dhe vjehrrri shkuan se ata ishin të moshuar, ndërsa neve të tjerëve nuk na u mundësua. I përcillnim ngjarjet politike të cilat ndodhnin në Kosovë dhe një gazetar, nuk mbaj mend tash prej cilës shtëpi informative ishte, tha: “si është situata në Kosovë? Ju a shpëtua?” Thashë unë: “Po ne shpëtua, por Kosova po digjet”.

Gjithmonë vëmendjen e kishim tek ata që ishin atje, pavarësisht a i kishim të afërt apo jo. Ishte një brengë jashtëzakonisht e madhe se vërehej tymi nëpër fshatra duke shkuar rrugës për në Kukës. Në fshatrat afër Vërmicës, Billush, Lubeqevë, e krejt pjesa e Vrrinit ishte në flakë dhe pjesa e Tusuzit të spitalit.

Vëmendjen gjithmonë e kishim tek tjerët të cilët kishin mbetur aty, në kuptimin tjetër se ne shpëtua. E më rëndësi ishte të shpëtojmë e të ruajmë substancën fizike se do të bëjmë diçka etj. dhe mbetëm të hendikepuar pra, sikur kur e ke gjysmën e zemrës diku tjetër, gjysmën diku tjetër.

Dhe me vendosjen tonë në Elbasan i përcollëm ngjarjet. Unë e kisha edhe një motër timen në Gjakovë. Ju e dini se çfarë kishte ndodhur atje, një katrahurë shumë e madhe dhe 22 ditë rresht kam shkuar për ta kërkuar prej Elbasanit deri në Tiranë, deri sa e kam zbuluar, e kam gjetur atje. Fatmirësisht, edhe pse kam pasur mjaft vuajtje, mjaft peripeci, megjithatë e gjetëm shëndosh e mirë, e kishte edhe plakën me vete.

Është për të theksuar një rast shumë interesant, e kisha me vete gruan e axhës të shoqes time. Ishte një grua 80 vjeçare me 5 fëmijë dhe nusen dhe ata fëmijë zakonisht bërtitnin “loken, loken, merrni me veti” dhe e kam pas edhe një peshë mjaft të rëndë, nuk mund të ecja përpara kur i shihja këto probleme dhe kthehesha rrugës dhe i kam pritur deri në momentin kur kanë ardhë kamionetat e ushtarëve të Shqipërisë, për t'i destinuar në vende të caktuara.

Se fëmijë, djemtë e kësaj lokes nja 10 ditë më përpara i kishin dëbuar atje dhe unë e marrë në grykë këtë loken, akoma sot është gjallë, në skelerozë, e marrë në grykë dhe e vendosi në kamionetë me ata fëmijë e vegjël dhe me nusen.

Dhe i them “ti e ke këtë nusën për hallall”. E vetmja nuse e cila nuk e ka lëshuar plakën nga dora dhe fatmirësisht, mirë është që ka kështu njerëzish. Pasi që e gjetëm motrën time të vendosur diku pranë liqenit të Tiranës, ishte një përqaftim i jashtëzakonshëm se nuk kishim pasur kontakte për pothuajse dy muaj dhe në bisedë me të më pyeti për

të gjithë familjarët a janë gjallë dhe i tregoj se vetëm vëllai i madh ka mbetur në Prizren. Ajo më pyet: “a ke ndonjë informatë?” I them se vetëm një person më ka thënë se janë shëndosh e mirë, informatë tjetër nuk kemi patur.

Prej familjes së ngushtë, vetëm vëllai na kishte mbetur në Prizren dhe na brengoste ajo situatë sidomos mua dhe nënën time, por megjithatë është dashur ta gjejmë forcën, se nuk ishte vetëm vëllai im , aty ka pasur edhe njerëz të tjerë. Serbia proklamonte se Shqiptarët po emigronin në botën ndërkombëtare, gjoja se me vetëdëshirë po shkojnë për jetë më të mirë.

Por i demantoi të gjitha këto, ky popull i mrekullueshëm, i demantoi të gjitha ato pikëpamje të Serbisë se shqipëtarët po emigrojnë me dëshirën e vet dhe në mënyrë biblike u kthyen, akoma pa u pastruar minat, nuk kanë pritur as 24 orë, veç njerëzit filluan të dalin, kështu që pas një jave apo 10 ditësh edhe ne u nisëm nga Elbasani ku patëm qendruar në një familje që e falenderoj shumë, për kujdesin, mikëpritjen, madje edhe të gjithë shqiptarët e Shqipërisë, në forma të ndryshme e kanë ndihmuar këtë popull, se vërtetë jemi popull fisnik dhe u kthjem në Prizren.

Me të arritur këtu, ishte diçka e paparashikueshme, diçka e pamundur madje edhe ta mendoje që një ditë mund të kthehemi këtu.

U takuam pastaj me vëllain dhe me shumë njerëz të tjerë të cilët kishin mbetur këtu.

Edhe vëllai nuk kishte mbetur këtu, por ishte strehuar tek gjyshja e vet, se patëm bredhur si nomadët, poshtë e lartë. Dhe kur kemi shkuar në shtëpi, sidomos në shtëpinë time, e kam gjetur shtëpinë rrëmujë, madje edhe fekalje kishin bërë serbët, ushtria nëpër shtëpi, librat i kishin shkatërruar, i kam pasur diku 200 - 300 libra, por megjithatë, kënaqësia më e madhe ishte që ne të gjithë u kthyem shëndosh e mirë dhe vazhduam jetën.

9

UNË DUA TË DËGJOHEM!

10

Bisedë me

Sadije Ramadanin

Nga fshati Reçak

Prej cilës kohë filloi të keqësohet situata në fshatin tuaj?

Më 5 qershor ka filluar këtu, edhe pse ne i dimë se si kanë qenë masakrat më herët, për të cilat kemi dëgjuar. Kurrë nuk jemi rehatuar, por kur ia nisën këtu te Belici (fshat në Shtime), ka pasur sulm të madh dhe ka pasur shumë krisma saqë nuk kemi mundur të qëndrojmë goftë edhe një natë më shumë.

Të nesërmen më ka marrë djali dhe më ka çuar në Babush, atje kam ndenjur tri javë me vajzën, me renë dhe me motrën e cila ka qenë me fëmijë. Mbas disa ditësh kemi ardhur në shtëpi. Kur erdhëm në shtëpi nuk ka zgjatur as pesë ditë dhe kanë ardhur me tanke dhe me topa këtu në Qest (është një kodër e papyllëzuar në fshatin Reçak dhe nga aty mund të shihet i gjithë fshati).

Kanë gjuajtur me tanke e me topa tek shtëpitë tona dhe plumbat na kanë ardhur rreth kokës, kur po i ngjiteshim malit përpjetë.

Kemi dalur ku kemi mundur nëpër gardhiqe vetëm me u fshehë dikund. Kemi shkuar në male të Petrovës (fshat afër Reçakut) dhe kur kemi mbërritur në Petrovë kemi dëgjuar që na i kanë djegur shtëpitë.

Kush ju tregoi që shtëpitë tuaja po digjeshin?

Njerëzit që i takuam na treguan, por e kemi parë edhe tymin që dilte prej lagjes tonë. Atë ditë është djegur gjysma e shtëpive dhe të nesërmen pjesa tjetër. Me sa më kujtohet ka qenë 23 shtator atë ditë kur janë djegur shtëpitë tona.

Ku jeni vendosur?

Atë ditë kemi ndenjtur në Petrovë, pastaj kanë ardhur miq dhe Ademi (djali i saj) na kanë marrë në male të Petrovës se e ka ditur se ose jemi në male ose na kanë mbytur. Ata na kanë marrë dhe kemi ndenjtur dy ditë në Dremjak (fshat në qytetin e Ferizajit).

Pastaj ka ardhur djali i motrës sime, Avniu dhe na ka çuar në Babush (fshat në qytetin e Ferizajit). Në Babush na kanë mbajtur me çfarë kemi pasur nevojë dhe kemi qëndruar atje deri sa është bërë armëpushimi, përafërsisht tre muaj.

Prej Babushit ka ardhur Rrahmani dhe më ka çuar në shtëpi të babës tim.

Në cilin fshat?

Në fshatin Reçak se shtëpia e babës tim ka qenë pa u djegur sepse edhe unë kam dashur të jem në vendin tim. Prej këtij momenti unë me familjen time kemi ndenjur në Reçak.

Si e keni siguruar ushqimin?

Si kemi mundur, se ne nuk kemi guxuar të dalim në Shtime dhe e kemi shfrytëzuar ndonjë lidhje me njerëzit që kanë siguruar ushqim për vete dhe na kanë blerë edhe neve. Nuk kemi pasur asnjë mundësi të dalim në Shtime se policia kanë qenë të vendosur këtu në Qest.

A keni pasur mjek në fshatin tuaj?

Jo, por kur kemi pasur nevojë për mjek kemi shkuar në Petrovë te doktor Veziri. Më shpesh ka shkuar motra ime se ajo i ka pasur fëmijët më të vegjël.

Si ka qenë situata deri në kohën kur është bërë masakra?

Situata ka qenë katastrofale gjatë tërë kohës. Serbët gjuanin me armë të ndryshme, por ne nuk kishim se ku të shkonim dhe duhej patjetër të qëndronim në fshat. Një javë para se të bëhej masakra serbët janë vendosur me tanke te pishat e Shtimes.

Çfarë ndodhi para masakrës?

Një javë para masakrës serbët janë vendosur te pishat me mjete të rënda dhe gjatë kësaj kohe ka qenë një qetësi e madhe, por menjëherë si kanë ardhur te pishat populli ka filluar të largohet nga fshati. Vëllau im e ka larguar familjen e vet dhe më tha edhe mua, po unë i thashë se nuk po largohem se edhe nëse ndodhë diçka mali është këtu afër dhe mund të ikim më lehtë. Nuk kishe edhe ku të shkoje se vetëm shtëpitë na i kishin djegë dhe vendosa të qëndroj.

Mbas një jave filloi populli të vijë se thanë nuk ka kurrgjë më, kur po atë natë kishin hyrë forcat e ne nuk dinim gjë. unë jam zgjuar në orën shtatë dhe i kam dëgjuar pushkët e para që kanë kërshitur, secilën herë krismat janë shpeshtuar dhe nuk dinim çfarë të bënim vetëm silleshim nëpër oborr. Tërë lagja kanë shkuar dhe janë tubuar te kanali. Aty kemi ndenjmur deri në orën nëntë dhe vëllau me shokët e vetë kanë

shikuar se çfarë po bëhet dhe ku mund të shkonim. Ne u përgatitëm të dalim në mal, kur jemi nisur për të dalë në mal dhe kemi mbërritur kah gjysma e kodrës kanë filluar me e granatu atë shpat dhe jemi detyruar të kthehemi dhe të himë në shtëpi të vëllaut, në shtëpinë e Sadik Osmanit.

Burrat kanë hyrë në ahër, dhe për fat shtëpia e tij ka qenë njëfarë bodrumi dhe para atij bodrumi kanë qenë disa shkallë të betonit, se çfarë krismash ka pasur prej të gjitha anëve, vetëm shkallët na mbronin pak. Për dy orë kanë qitë në shtëpinë tonë ku krejt shtëpinë e kanë bërë vrima-vrima.

Më vonë janë ndalur krismat dhe kanë ardhur serbët nga të gjitha anët dhe kanë filluar të kontrollojnë. Nuk kanë lënë vend pa shikuar, nëpër shtretër, dollapë, gjithçka e kanë bërë lëmsh. Në bodrum kemi qenë rreth 30 vetë, gra dhe fëmijë.

Aty ka qenë vëllau im, Sadik Osmani, Rama dhe Mufaili që është mbytur. Kohë pas kohe bënin pushim, i ndalnin të shtënat. Më vonë ato po bëheshin gati të vinin dhe të hinin te ne. Ata kishin hyrë dhe i kishin marrë ata te ahri. Kur erdhën te ne ka hyrë një njeri i madh me tesha të zeza dhe me maskë.

Ai e ka hapur derën, nuk ka folur asgjë dhe është kthyer. Pastaj kanë ardhur tre vetë më tesha të kaltra dhe kanë qenë të armatosur deri sa edhe në çizme kanë pasur thika. Kur kanë hyrë ata na i kanë mbajtur automatet përmbi kokë duke na sharë dhe thënë se këtu paska edhe burra.

E kanë marrë vëllanë me shkelma dhe e kanë nxjerrë jashtë, Ramën dhe djalin e vëllait dhe atë Mufailin. Vëllanë tim e kishin marrë me automat duke i shkuar mbrapa nëpër krejt vendet e shtëpisë, duke kontrolluar, madje e kishin marrë edhe një shkallë për të shikuar se çfarë ka në tavan.

Kur hyri një serb te ne tha “ko puci na mene” dhe ne iu përgjigjëm se po të ishte ashtu, ne nuk do të ishim mbyllur këtu, por ai donte të bënte hajgare me ne se ne as thikë nuk kishim. Gati tre herë kanë hyrë tek ne duke na sharë dhe duke na i vënë automatet përmbi kokë dhe pastaj na kanë kontrolluar të gjithëve dhe kur e panë që nuk kemi asgjë dolën.

Pastaj e sollën djalin e vëllait, Burimin tek ne dhe na tregoi se i ka dëgjuar duke folur serbët me ata të tjerët që kanë qenë në male se shumica e njerëzve të vrarë janë ata që kanë qenë në atë oborr. Neve na kanë mbyllur me çelës në bodrum dhe e kemi dëgjuar kur e kanë rrahur këtë Mufailin dhe burrat e tjerë. Rreth orës 14.00 i kanë çuar burrat përpjetë, ku kishin qenë grupi tjetër i serbëve dhe i kemi dëgjuar disa krisma.

Neve na lanë të mbyllur në bodrum prej orës 10 deri në orën 16. Bënte shumë ftohtë sa nuk mund të rrinim në një vend. Dikur kam dalur të shoh se dera e kishte një vrimë, por nuk pashë asgjë.

Në anën tjetër të bodrumit ka qenë një dritare e mbuluar me sitë. E kam gjetur një thikë dhe e kam prerë sitën. Kam dalur jashtë nga ajo dritare dhe kam shkuar dhe e kam hapur derën dhe pastaj kemi dalur përjashta.

Kur dolëm jashtë shkuam te shtëpia e Ramës se e kishim afër dhe shtëpia e tij ishte rreth sokakut se mendonim se mund të dilnim më lehtë. Qëndruam në atë shtëpi për pak kohë dhe nuk dinim se ku të shkonim se e pamë që nuk mbetën burra në shtëpi.

Dolëm në sokak dhe e pamë që kishin mbetur ende forca atje dhe më poshtë. Po ashtu e pamë të mbytur atë gruan, Sahiden që edhe sot nuk është gjetur, dhe varrin e ka të çelur. Nuk guxonim t'i afroheshim dhe të shihnim se ende kishte forca. Jemi kthyer dhe kemi hyrë në shtëpi dhe kemi ndenjtur edhe pak.

Pak më vonë kemi dëgjuar se forcat e serbëve janë tubuar dhe janë nisur të shkojnë kah Shtimja duke kënduar. Kemi ndenjtur edhe pak se nuk guxonim të dilnim. Pastaj vendosëm të dalim dhe të shkojmë për Shtime. Kur dolëm nuk e pamë atë gruan, nuk e gjetëm se e kishin marrë.

Më poshtë e kemi parë Nazmi Nuhen në oborrin e vet. Ai e kishte pasë marrë udhën për të dalë në mal, por atë e kishin mbytur. Kokën e kishte pasur të çarë, kapakun e kokës e kishte pasur të hequr. Rrugës ka ardhur një veturë e OSCE-së dhe na ka thënë a jeni ju gjallë. Ne i thamë se jemi, po burrat nuk i kemi se i kanë marrë. Ata i morën shënime. Djali i vëllait, Burimi ja u dha disa shënime se ai e ka ditë se kush ka qenë në oborrin e tij.

Ne i pyetëm ata të OSCE-së se çfarë të bëjmë, ata thanë bëni çfarë të doni se ata e kanë kryer planin e vetë. Nëse doni shkoni te ndonjë i afërm ose kthehuni në shtëpi.

Ne të gjithë u kthyem në shtëpi të vëllait edhe fjetëm aty. Gjithë natën nuk kemi fjetë vetëm kemi qarë se nuk e dinim që burrat nuk janë. Ne mendonim se janë në burg. Nuk kemi menduar që janë përmbi shtëpi të vëllait të mbytur. Nesër në mëngjes djali i vëllait ka dalur në sokak dhe është takuar me shokë dhe fshatarë. Aty e ka marrë vesh se babai i vet dhe burrat e tjerë janë të vrarë përmbi shtëpi të tij.

Kur erdhi Burimi i thashë çfarë po bëjmë moj hallë, ta gjejmë një telefon e me ba diçka dhe ai më tha se nuk kemi çfarë të bëjmë se janë të vrarë këtu përmbi shtëpi. Në atë moment nuk kam ditë se çfarë të bëj dhe çfarë të them. Asnjë pikë loti nuk kam guxuar ta qes se më dhimbsej djali i vëllait se ishte shumë i ri. Atëherë erdhën ata të OSCE- së dhe Walker-i.

A ke qenë në vendin ku është bërë masakra?

Pak më vonë kam shkuar se nuk më linin të shkoja. Në kohën e drekës kam shkuar me djalin e vëllait dhe i kam parë krejt pa sy, kapakun e kokës të hequr, me zorrë të hequra, me gjoks të çarë. Djali i Imerit me sy të hequr.

Çfarë moshe kanë pasur të masakruarit?

Kanë qenë prej moshës 15 vjeç e deri tek pleqtë më të lodhur në moshë.

Pastaj ku ke shkuar?

Prej aty jam kthyer te shtëpia dhe ja kam dhënë disa batanije fshatarëve që i janë dashur për t'i bartur kufomat dhe për t'i çuar në xhami.

Atë natë kam fjetur në shtëpi, kurse të nesërmen në mëngjes kanë ardhur disa fshatarë dhe më kanë thënë se po largohen nga fshati se do të plasë luftë edhe më e madhe se duan të hynë dhe të na i marrin kufomat prej xhamisë e t'i çojnë ku të duan vetë. E kam marrë vajzën dhe nusen dhe kam shkuar në Mullopolc (fshat në Shtime). Prej aty kam shkuar në Dremjan dhe kam ndenjur dy ditë dhe nga aty kam shkuar në Ferizaj.

Gjë më të vështirë nuk kishte se sa atëherë kur i shihja në televizor si i tërhiqnin kufomat prej kamionit. Pas një muaji kam shkuar në Reçak për varrim me vajzën, nusen dhe me motrën. Prej Ferizajit kemi shkuar me një traktor se unë nuk kisha më fuqi të eci, mbas atyre gjërave që kisha parë dhe përjetuar. Mbas varrimit unë bashkë me vajzën, nusen dhe motrën jemi kthyer në Ferizaj dhe kemi ndenjur deri atë ditë

që i ka rënë NATO-ja dhe prej aty kemi shkuar në Gadime (fshat në Lipjan) dhe kemi ndenjur rreth 10 ditë, gjoja më të sigurtë. Prej aty kam shkuar në Bujan (fshat në Lipjan) dhe kemi ndenjur nja dy ditë. Pastaj kemi shkuar në Ribar (fshat në Lipjan) dhe prej aty kemi shkuar në Blinaj (ish Lipovica, një park kombëtar në mes të tri komunave Shtime, Lipjan dhe Kamaran). Aty kemi qëndruar për 6 javë dhe e kemi rregulluar vendin me llastik. Mbas një kohe filloi të na mbarohej ushqimi dhe ka ndodhur që kemi mbetur pa hëngër për tri ditë, pastaj kemi shkuar në Ribar.

Atje i kanë mbytur 6 vetë dhe kemi ikur prej Ribarit në orën 20 e kemi ecur deri në orën 5 të mëgjesit, kur kemi mbëritur në Terrën (fshat në Ferizaj) dhe kemi ndenjur 10 ditë deri sa kanë hyrë trupat e NATO-s.

Prej aty jam kthyer në shtëpinë e vëllaut, pasi që unë nuk kam pasur se ku të kthehem se vetëm shtëpia ime ka qenë e djegur. Kam ndenjur aty deri sa është rregulluar shtëpia ime.

10**UNË DUA TË DËGJOHEM!**